

**Menaxhimi**

Drejtoria e Urbanizmit, Pronës, Kadastrit, Gjeodezisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit

1. Qazime Vata
2. Emin Misini
3. Bashkim Jashari
4. Gafurr Ilazi
5. Mustafë Zariqi

Ekipi Komunal i Planifikimit

1. Dugagjin Etemi
2. Bashkim Jashari
3. Gafurr Ilazi
4. Ismet Mjaku
5. Arsim Sahiti
6. Gani Abazi
7. Ismail Hyseni
8. Ahmet Gajtani
9. Hyzri Hasani
10. Vjollca Krasniqi
11. Avni Shabani

Kshilli i Ekspertëve Komunal të Planifikimit

1. Avni Ibrahim
2. Mehmet Neziri
3. Agim Bytyqi
4. Enver Azemi
5. Xhemajl Fejzullahu
6. Rafete Rexhepi
7. Sabri ramadani
8. Arsim Murseli
9. Selim Hyseni
10. Izet Rushiti
11. Mexhid Regjepi

UN - Habitat

1. Aida Dobruna
2. Masajuki Yakota
3. Shefqet Gjocaj

Grupet tematike punuese komunale**Demografia dhe Çështjet Sociale**

1. Aferdita Bibaj
2. Selvije Ramadani
3. Suzana Mustafa
4. Musli Marevci
5. Ibrahim Musliu
6. Mehmet Murseli
7. Naim Xhokli
8. Naim Misini
9. Hamdi Haliti
10. Izjah Zariqi

Zhvillimi Ekonomik

1. Mustafe Zariqi
2. Ismail Hyseni
3. Lulzim Shabani
4. Elfete Bislimi
5. Nehat Hoxha
6. Resmije Leka
7. Agim Haredini

Mjedisit dhe Shfrytëzimi i Tokës

1. Minir Haxhimusa
2. Enver Sopa
3. Musa Shabani
4. Hazbije Murseli
5. Basri Beqiri
6. Esat Krasniqi
7. Basri Musa

Infrastruktura

1. Emin Misini
2. Muzafer Asllani
3. Gezim Demelezi
4. Nazim Musliu
5. Naim Zeqa
6. Ismail Mehmeti
7. Hajrush Leka



Hartues i projektit - Partneriteti



Instituti i shkencës dhe teknologjisë
Institute of science and technology



HessenAgentur

HA Hessen Agentur GmbH



INSTITUT WOHNEN UND UMWELT GmbH
- Institute for Housing and Environment -



Dreitor i projektit:

Shkëlzen Qorraj

Stafi profesional:

- 1.Fridhelm Flug
- 2.Driton Lleshi
- 3.Paul M. Lösse
- 4.Uwe Wulkopf
- 5.Isuf Krasniqi
- 6.Heinz Sautter
- 7.Reiner Greiff
- 8.Wolf Uwe Rilke
- 9.Bodo Fuhrman
- 10.Bardh Hoxha
- 11.Christopher Borin
- 12.Henning Schäarting
- 13.Nikolaus Dieffenbach





PËRMBAJTJA

0	PARATHËNIE	8
1	PROFILI I SITUATËS DHE ANALIZAT	9
1.1	SFONDI HISTORIK	9
1.2	PLANET EKZISTUESE	10
1.2.1	Plani Gjeneral Urbanistik 1987- 89	10
1.3	SHFRYTËZIMI I TOKËS	11
1.4	PEIZAZHI DHE MJEDISI	15
1.4.1	Karakteristikat gjeofizike dhe klimatike	15
1.5	POPULLSIA	19
1.6	BANIMI	22
1.7	ZHVILLIMI EKONOMIK	24
1.7.1	HYRJA, KOSOVA-GJENDJA	24
1.7.2	Zhvillimi i industrisë dhe biznesit në Ferizaj	25
1.7.3	Industria	29
1.7.4	Tregtia	30
1.7.5	Turizmi	31
1.8	TRAFIKU DHE TRANSPORTI	32
1.8.1	Rrjeti rrugorë	32
1.8.2	Hekurudha	35
1.8.3	Transporti	36
1.9	INFRASTRUKTURA TEKNIKE	38
1.9.1	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizimi	38
1.9.2	Menaxhimi i Mbeturinave	43
1.9.3	Furnizimi me energji elektrike	44
1.9.4	Telekomunikacioni	46
1.10	INFRASTRUKTURA SOCIALE	50
1.10.1	Arsimi	50
1.10.2	Sistemi për përkujdesje shëndetësore	55
1.11	TRASHEGIMIA KULTURORE DHE NATYRORE	59
1.11.1	Trashëgimia Kulturore	59
1.12	TRASHËGIMIA NATYRORE	64
1.13	KATASTROFAT NATYRORE DHE TE SHKAKTUARA	64



1.14	SFIDAT E IDENTIFIKUARA ZHVILLIMORE	67
1.15	VLERËSIMI I KAPACITETEVE INVESTUESE	68
2	VIZIONI, PARIMET DHE CAQET	77
2.1	OBJEKTIVAT ZHVILLIMORE	77
2.2	PARIMET E PËRGJITHSHME PËR ZHVILLIM	84
2.3	CAQET DHE POTENCIALET ZHVILLIMORE AFATGJATE	84
2.4	PRIORITETET STRATEGJIKE	85
3	KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPESINOR URBAN	86
3.1	PLANET E VEPRIMIT PËR ZHVILLIM HAPËSINOR	86
3.1.1	Skenari A	86
3.1.2	Skenari B	87
3.1.3	Skenari C	88
3.2	PLANI I VEPRIMIT PËR TRAFIK DHE TRANSPORT	90
3.2.1	Trafiku Rrugor	90
3.2.2	Transporti hekurudhorë	92
3.3	MODELI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR	94
3.4	STRUKTURA URBANE	97
3.4.1	Zonat banuese	100
3.4.2	Sigurimi i tokës për industri dhe biznes	100
3.4.3	Sigurimi i tokës për përdorim të përzier dhe të përbashkët	101
3.4.4	Politikat e Sigurimit gjeneral të tokës / zhvillimi hap pas hapi	101
3.5	MJEDISI DHE PEIZAZHI	105
3.6	TRAFIKU DHE TRANSPORTI	107
3.6.1	Rrjeti rrugor	107
3.6.2	Rrjeti hekurudhor	110
3.6.3	Transporti publik	112
3.7	INFRASTRUKTURA TEKNIKE	114
3.7.1	Ujërat dhe kanalizimi	114
3.7.2	Energjia elektrike	114
3.7.3	Energjia për Ngrohje	118
3.8	INFRASTRUKTURA SOCIALE	125
3.8.1	Përkujdesja shëndetësor	125
3.11	TRASHËGIMIA KULTURORE DHE NATYRORE	128



3.11.1	Mbrojtja e substancave historike të ndërtimit	128
3.11.2	Objektivat e planifikuara	128
3.12	FAZAT E ZHVILLIMIT	129
4	STRATEGJITE DHE VEPRIMET PER IMPLEMENTIM	132
4.1	STRATEGJITË PËR ZBATIM DHE PLANET E VEPRIMIT TE SHOQËRUARA ME KONCEPTET HAPËSINORE OSE PARIMET	132
4.2	VLERËSIMET E STRATEGJIVE BAZUAR NE KRITERET E PËRCAKTUARA ME PARIME, POLITIKA DHE LIGJE	142
4.3	AFATET KOHORE, IMPLIKIMET FINANCIARE, KORNIZA INSTITUCIONALE	142
5	DISPOZITAT PER ZBATIM	145
5.1	UDHËZIME MBI ÇËSHTJET E INTERPRETIMIT TE PLANIT ZHVILLIMORE URBAN GJATE HARTIMIT TE PLANEVE RREGULLUESE DHE PLANEVE TJERA	145
5.2	KUSHTE TE PËRCAKTUARA NGA QEVERIA LOKALE MBI ÇËSHTJE TE RËNDËSISHME PER ZHVILLIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E TOKËS NE ZONA URBANE	146
5.2.1	Kushtet për përcaktimin dhe përkufizimin e sipërfaqeve publike si dhe atyre me destinime tjera	146
5.2.2	Kushtet për rregullimin e hapësirës për objekte me rendësi për Komunën	146
5.2.3	Kushtet për vendosjen e objekteve të veprimtarive ekonomike	147
5.2.4	Kushtet për vendosjen e objekteve të veprimtarive publike	148
5.2.5	Kushtet dhe mënyra e ndërtimit të objekteve të banimit	148
5.2.6	Kushtet për përcaktimin e rrjetit të sipërfaqeve të korridoreve apo trasave telekomunikuese dhe rrjetit të infrastrukturës urbane	149
5.2.7	Kushtet për rregullimin e zonave dhe tërësive me vlerë të veçante	150
5.2.8	Mënyra e trajtimit të hedhurinave (përpunimi, deponimi dhe bartja)	150
5.2.9	Masat për pengimin e ndikimeve të dëmshme në mjedis	150
5.2.10	Masat për parandalimin e ndikimit negativ social	151
5.2.11	Masat për zbatimin e planit	151
5.3	DISPOZITAT LIDHUR ME KONSULTIMIN, BASHKËPUNIMIN DHE PJESËMARRJEN	152
5.4	DISPOZITAT MBI RENDIN KRONOLOGJIK APO ETAPAT E ZBATIMIT	152
5.5	ELEMENTET DHE UDHËZIMET PËR HULUMTIM TE MËTUTJESHËM	153



LISTA E PLANEVE:

PLANI 1: SITUATA – SHFRYTËZIMI I TOKËS DHE PLANIFIKIMI SIPAS PPU	14
PLANI 2: SITUACIONI – PEIZAZHI DHE MJEDISI	18
PLANI 3: SITUACIONI – INFRASTRUKTURA TEKNIKE DHE TRAFIKU	37
PLANI 4: SITUACIONI: SITUACIONI – ELEKTRIKA	47
PLANI 5: SITUATA – UJËSJELLËSI	48
PLANI 6: SITUACIONI – KANALIZIMI	49
PLANI 7: SITUACIONI – INFRASTRUKTURA SOCIALE	58
PLANI 8: PLANET E VEPRIMIT NË QYTETIN E FERIZAJT	89
PLANI 9: MODELI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR NË QYTETIN E FERIZAJT	96
PLANI 10: NDARJA E ZONAVE URBANE	99
PLANI 11: PLANI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR I QYTETIT TË FERIZAJT	103
PLANI 12: KUFIRI URBAN	104
PLANI 13: KONCEPTI I PEISAZHIT NË QYTETIN E FERIZAJT	106
PLANI 14: KONCEPTI I TRAFIKUT NË QYTETIN E FERIZAJT	113
PLANI 15: INFRASTRUKTURA TEKNIKE – ELEKTRIKA	122
PLANI 16: INFRASTRUKTURA TEKNIKE – UJËSJELLËSI	123
PLANI 17: INFRASTRUKTURA TEKNIKE - NGROHJA	124
PLANI 18: FAZAT E ZHVILLIMIT NË QYTETIN E FERIZAJT	131
PLANI 19: DENDËSIA DHE ETAZHITETI	133
PLANI 20: PROJEKTET KYÇE – QYTETI	141

LISTA E FIGURAVE:

Fig. 1: Plani i Përgjithshëm Urbanistik, 1987	10
Fig. 2: Qyteti i Ferizajt, shikuar nga kazerma	13
Fig. 3: Temperaturat gjatë vitit në Komunë	16
Fig. 4: Zonat e hulumtimit të popullsisë, të kryer nga KK	20
Fig. 5: Kërkesat e vlerësuara për tokë të banimit (në qytet)	23
Fig. 6: Ndërmarrjet në Komunën e Ferizajt	28
Fig. 7: Ndërmarrjet në pjesën urbane të Komunës së Ferizajt	28
Fig. 8: Shtrirja e rrjetit të kanalizimit në qytet	39
Fig. 9: Shtrirja e rrjetit të ujësjellësit në qytet	40
Fig. 10: Deponia transite në Gërlicë	43
Fig. 11: Rrjeti elektrik i Kosovës	45
Fig. 12: Sistemi arsimor në Kosovë	51
Fig. 13: Raporti i arsimit fillor të qytetit me pjesën rurale	53
Fig. 14: Raporti në mes të qytetit dhe pjesës rurale	56
Fig. 15: Një fushatë nga Ministria e Kulturës ka për qëllim ngritjen e vetëdijesimit të	60
Fig. 16: Biblioteka e qytetit	62
Fig. 17: Kisha e Shën Uroshit Xhamia e madhe në qendër të qytetit	62
Fig. 18: Harta e zonave maksimalisht të rrezikuara nga tërmetet në Kosovë	66
Fig. 19: Struktura e burimeve të investimeve në tërë Kosovën	69
Fig. 20: Prerjet e mundshme të rrugëve të qytetit	108
Fig. 21: Korridori i hekurudhës brenda kufirit urban	110
Fig. 22: Linjat e mundshme të transportit publik	112



Fig. 23: Rrjeti elektrik i Kosovës	115
Fig. 24: Nënstacionet e reja	116
Fig. 25: Rëniet e tensionit	117
Fig. 26: Nxehtësia e nevojshme specifike mesatare maksimale për objektet e banimit dhe për objektet afariste për m ² të sipërfaqes e cila shfrytëzohet.	118
Fig. 27: Vlerat orientuese për nxehtësinë specifike të ngrohjes, në varësi nga vjetërsia dhe raporti A/V (sipërfaqja e jashtme përfshirëse ndaj vëllimit).	119
Fig. 28: Nxehtësia e nevojshme specifike mesatare maksimale për objekte të fabrikave për m ³ të hapësirës	120
Fig. 29: Rrjeti primar dhe sekondar i ngrohjes së qytetit	121
Fig. 30: Alternativat e lokacionit të spitalit	127
Fig. 31: Skica për rihvillimin e qendrës së qytetit	135
Fig. 32: Vendbanimet e identifikuara joformale	137
Fig. 33: Profili i mundshëm i rregullimit të lumit	138

LISTA E TABELAVE:

Tab. 1: Shfrytëzimi i tokës	12
Tab. 2 Numri i banorëve në qytetin e Ferizajt - 2006 / 2015 / 2020.....	20
Tab. 3: Potencialet për zhvillimin e turizmit në Komunë	31
Tab. 4: Gjatësia dhe sipërfaqja e rrugëve të komunës.....	34
Tab. 5: Tabela e shërbimeve arsimore fillore dhe parashkollore.....	52
Tab. 6: Mesatarja e nxënësve në klasë në arsimin e obligueshëm, në klasat 1-9, viti shkollor 2005-06.....	52
Tab. 7: Tabela e shërbimeve arsimore fillore dhe parashkollore.....	54
Tab. 8 Inventarizimi i trashëgimisë kulturore të objekteve në territorin e Ferizajt.....	61
Tab. 9 Buxheti sipas programeve 2004-2006(në Euro)	71
Tab. 10 Buxheti sipas kategorive ekonomike 2004-2008	72
Tab. 11 Lista e projekteve kapitale, sipas librit buxhetor 2006-2008.....	73
Tab. 12 Lista e projekteve kapitale sipas raporteve komunale	74
Tab. 13 Lista objektivave të dala nga punëtorja në Ohër	82
Tab. 14 Sigurimi i tokës ndërtimore, i përcaktuar në PZHU.....	102
Tab. 15: Plani i veprimit për prioritetin – Hartimi i planeve përkatëse	143
Tab. 16: Plani i veprimit për prioritetin – Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore (Peizazhi dhe mjedisi).....	144
Tab. 17: Plani i veprimit për prioritetin – Infrastruktura teknike.....	144
Tab. 18: Plani i veprimit për prioritetin – Trafiku dhe transporti	144



0 PARATHËNIE

Ferizaj, si qendër demokratike, ekonomike dhe kulturore, konsiderohet si zemra e komunës. Si pasojë e ndryshimeve dramatike në të kaluarën, qyteti duhet t'u adoptohet kërkesave të së ardhmes. Për ta drejtuar dhe kontrolluar procesin e adoptimit, Komuna ka vendosur ta hartojë Planin e Zhvillimit Urban për qytetin e Ferizajt.

Detyra e planifikimit gjithëpërfshirës kërkon aktivitete në shumë fusha të veprimit dhe në nivele të ndryshme të planifikimit, në të njëjtën kohë. Veçanërisht punët e planifikimit afatgjatë dhe afatmesëm duhet të bazohen në njohuritë e ekspertëve të disiplinave të ndryshme shkencore, sikur që edhe duhet të merret parasysh gjithë kompleksiteti i çështjeve urbane në përgjithësi.

Plani i Zhvillimit Urban i Ferizajt është përgatitur nën udhëheqjen e Drejtorisë për Urbanizëm, Kadaster dhe Mbrojtje të Mjedisit, si dhe dhe të drejtorive të tjera përkatëse komunale. Janë mbajtur një varg seminaresh, ku me ekipin ndër-disiplinor janë diskutuar propozimet e planifikimit. Veç kësaj, ekspertët lokalë kanë pasur konsultime edhe me ekspertët vendorë dhe rajonalë.

Për ta ndihmuar përgatitjen e planit, komuna e Ferizajt ka kontraktuar një partneritet (konsorcium) ekspertësh nga shumë disiplina, i përbërë nga: Instituti i Shkencës dhe Teknologjisë (INTECH), HA Hessen Agentur GmbH (HA), Institut Wohnen und Umwelt GmbH (IWU) dhe Planungsgruppe 4 Berlin GmbH (P4). Partneriteti e mbulon tërë spektrin e punës së planifikimit hapësinor dhe është i angazhuar në mbështetjen e komunës, në hartimin e planit zhvillimor strategjik komunal dhe urban.

Siç është kërkuar me Ligjin për Planifikim Hapësinor të Kosovës, PZHU për qytetin e Ferizajt është i lidhur ngushtë me Planin e Zhvillimit të Komunës së Ferizajt. PZHU është i gatshëm t'i referohet, kur është e nevojshme, dokumentit të PZHK-së.

Në Evropë planifikimi i integruar konsiderohet arritje kulmore - art në planifikim. Ai e përfshin integrimin e fushave relevante zhvillimore dhe bartësit e veprimeve. Për më tepër, ai e përfshin bashkimin e niveleve të ndryshme të planifikimit. Është e pakontestueshme se planifikimi i integruar e rritë dhe përmirëson efikasitetin e planifikimit urban.



1 PROFILI I SITUATËS DHE ANALIZAT

1.1 SFONDI HISTORIK

I krahasuar me rrethinën e tij, Ferizaj është qytet relativisht i ri, pra është njëra prej qendrave më të reja urbane të Kosovës.

Si fshat, ai është formuar në periudhën otomane, përgjatë rrugës kryesore në veri-jug. Pas vitit 1874, ai u zhvillua në një qytet me ndërtimin e linjës hekurudhore Mitrovicë – Shkup dhe me stacionin hekurudhor. Kjo linjë ishte shumë me rëndësi për transportin e udhëtarëve dhe të mallrave.

Emri Ferizaj rrjedh nga z. Feriz Shashivari, i cili e drejtonte një han në fshat.

Ekzistojnë vendbanime në këtë zonë qysh nga kohët e lashta. Vendbanimet e tilla janë identifikuar përmes disa gërmadhve nga disa vende gërmimesh në territorin e komunës.

Hapat e parë të formimit të qytetit janë vitet pas 1900, me fillimin e disa veprimtarive zejtare dhe tregtare. Në atë kohë në qytet dominonte tregtia. Në vitin 1900, prej 400 shtëpive, sa kishte gjithsej Ferizaj, 200 ishin dyqane tregtare dhe zejtare.

Gjatë periudhës së Mbretërisë Jugosllave, qyteti i Ferizajt vazhdon të zhvillohet dhe të ndërtohet. Objektet nga ajo kohë janë: Shtëpia e Kulturës “Hivzi Sylejmani”, e ndërtuar në vitin 1924, dhe libraria e qytetit, e ndërtuar në vitin 1928.

Në vitin 1941 qyteti kishte vetëm 5 000 banorë. Fabrika e tjegullave është e vetmja ndërmarrje ende e mbetur nga ajo periudhë. Ndërmarrjet dhe fabrikat e tjera ekzistuese janë ndërtuar pas Luftës së Dytë Botërore. Në këtë periudhë qyteti zhvillohet hovshëm, bile më vonë arrin të bëhet njëra ndër qendrat më të mëdha industriale dhe tregtare të Kosovës.

Ekonomia e Ferizajt, deri në aplikimin e masave të dhunshme (vitet 1989-1990), ishte mjaft e zhvilluar, sidomos: industria metalike, industria e përpunimit të drurit, industria ushqimore dhe ndërtimtaria. Përveç kësaj, në Ferizaj janë të zhvilluara edhe degët e tjera të ekonomisë, si: tregtia, komunikacioni (transporti), pylltaria, bujqësia etj.

Zhvillimi ekonomik bie në mënyre rapide gjatë viteve të 90-ta dhe gjatë luftës në Kosovë. Shumica e fabrikave nuk janë duke punuar sot e kësaj dite (2006). Janë bërë përpjekje për ta ringjallur industrinë, por pa rezultate domethënëse.


1.2 PLANET EKZISTUESE

Duhet të theksohet se të gjitha planet e hartuara para vitit 1999, janë të tejkaluara si koncept i planifikimit. Këto plane nuk i paraqesin nevojat e qytetit dhe, si të tilla, nuk mund të zbatohen. Zonat e ndërtuara në qytet kanë një sipërfaqe rreth 650 ha.

1.2.1 Plani i Gjeneral Urbanistik 1987-1989

Qyteti i Ferizajt disponon me Planin e Gjeneral Urbanistik, të hartuar në vitet 1987-1989, me afat të vlefshmërisë deri në vitin 2000, plan ky i aprovuar nga Kuvendi i Komunës në vitin 1992. Ky plan përfshin një sipërfaqe prej 2000 ha të shpallura si tokë ndërtimore, së bashku me rezervat strategjike. Pa rezervat strategjike, plani përfshin një sipërfaqe prej 1400 ha.

Fig. 1: Plani i Përgjithshëm Urbanistik, 1987





Pas luftës i është propozuar Kuvendit të Komunës që t'i zgjatet afati i vlefshmërisë këtij plani.

Me nisën e Drejtorisë për Urbanizëm, duke u bazuar edhe në kërkesat e qytetarëve, është hartuar një plan rregullues për zonën qendrore të qytetit. Ky plan u aprovua nga Kuvendi i Komunës në vitin 2002.

Nevojitet hartimi i tërësishëm i planeve të reja për qytetin e Ferizajt

Megë çdo ditë rritet numri i banorëve, bashkë me të rriten edhe kërkesat për hapësira të reja për banim, për punë dhe rekreacion. Ky fakt, prandaj, duhet të merret parasysh me rastin e hartimit të planeve dhe duhet të zgjerohen kufijtë e planit ekzistues.

Për hartimin e planeve të reja, paraqiten shumë pengesa, si mosposedimi i gjendjes faktike në bazat për planifikim, gjegjësisht shtrirja fizike e qytetit dhe mungesa e informacioneve bazë të domosdoshme për nevojat e planifikimit.

1.3 SHFRYTËZIMI I TOKËS

Qyteti i Ferizajt ka strukturë mjaft të koncentruar. Përreth qendrës së qytetit janë zhvilluar zona të ndryshme banimi dhe ato industriale.

Pjesa më e madhe e qendrës së qytetit është e ndërtuar pas Luftës së Dytë Botërore. Në qytet kanë mbetur shumë pak objekte të vjetra. Objektet dominuese në qendër janë ato administrative, shkollat, si dhe spitali i qytetit. Objektet e tjera janë ato të banimit të përzier, të tregtisë, të afarizmit dhe të shërbimeve.

Ferizaj ka strukturë qendrore urbane dhe shumica e ndërtimeve janë bërë përgjatë akseve kryesore rrugore. Në qendër të qytetit ka shumë pak sipërfaqe të gjelbëruara. Ferizajt i mungon parku.

Përqindja e objekteve kolektive të banimit është shumë e vogël në krahasim me atë të shtëpive individuale. Mu për këtë, toka shfrytëzohet në mënyrë joracionale.

Disa fabrika të mëdha (zona industriale) janë të vendosura në veriperëndim të qytetit. Prodhimi në shumicën prej tyre është ndërprerë ose është në nivel të ulët. Edhe në veri, në fshatin Babush, është gjithashtu një zonë e lejuar industriale.



Tregtia është e zhvilluar përgjatë të gjitha rrugëve kryesore, në formë të objekteve tregtare dhe të ndërmarrjeve të vogla.

Pjesa kryesore e qytetit ka strukturë kompakte, por në pjesët dalëse dhe përgjatë rrugëve kryesore zhvillohet një strukturë mjaft e shpërbërë.

Analizat SWOT për shfrytëzimin e tokës

S Përparësitë:

- Struktura kompakte urbane,
- Qendra e fortë e qytetit,
- Lokacione të mjaftueshme për zhvillim.

W Dobësitë:

- Zonat industriale në afërsi të zonave të banimit – shfrytëzim që pengon zhvillimin reciprok,
- Shpërhapja urbane dhe shfrytëzimi joefektiv i tokës,
- Shfrytëzimi joracional i tokës ndërtimore,
- Ndërtimet përgjatë rrugëve kryesore të qytetit është duke e bllokuar zhvillimin e mëtutjeshëm,
- Zonat e pashfrytëzuara në lokacione atraktive mund të ndoten.

O Mundësitë:

- Pjesë atraktive për zhvillim të banimit duke mos i dëmtuar tokat bujqësore.

T Kërcënimet:

- Pronësia e papërcaktuar mund ta ndalë zhvillimin,
- Ndërtimi ilegal përgjatë rrugëve kryesore mund ta ndalë zhvillimin dhe zgjerimin e mëtutjeshëm të rrugëve.

Tab. 1: Shfrytëzimi i tokës

Vendi	Banim		Afarizëm		Industri		Bujqësi	
	Objekt.	Sip.	Objekt.	Sip.	Objekt.	Sip.	Objekt.	Sip.
Ferizaj	7528	1002437	1793	143374	503	167,698	10	168
Ferizaj (banesa)	868	60572	0	0	0	-	0	-



Fig. 2: Qyteti i Ferizajt, shikuar nga kazerma





PLANI 1: SITUATA – SHFRYTËZIMI I TOKËS DHE PLANIFIKIMI SIPAS PPU





1.4 PEIZAZHI DHE MJEDISI

1.4.1 Karakteristikat gjeofizike dhe klimatike

Ferizaj karakterizohet me klimë kontinentale, si edhe pjesa më e madhe e Fushës së Kosovës. Lumi më i madh, i cili kalon nëpër Ferizaj, është lumi Nerodime. Temperatura vjetore mesatare është 9.9°C. Muajt më të ngrohtë janë korriku dhe gushti, me temperaturë mesatare 18.9°C. Muaji më i ftohtë është janari, me temperaturë mesatare -2.6°C. Temperatura maksimale e ajrit është 32.5°C në korrik, ndërsa ajo minimale -14.0°C, në janar.

Insolimi mesatar vjetor në Ferizaj është 2 034 orë me diell. Muaji me më shumë orë me diell është gushti, me 264.6 orë, ndërsa dhjetori karakterizohet me kohën më të shkurtër të insolimit, mesatarisht me 63.8 orë.

Lagështia më e lartë mesatare sillet prej 85.0 % deri 87.0 %, në muajt dhjetor dhe janar, ndërsa ajo më e ulët në muajt korrik dhe gusht, e cila sillet prej 68.2 % deri 68.4 %. Kohë me vranësi më të lartë ka janari, me 7.3/10 ndërsa vranësi më të ultë ka gushti me 3.8/10.


Mesatarisht, në vit ka 73.3 mm të reshura në Ferizaj. Muajt me më së shumti të reshura janë prill – maji, me 105.6 mm, ndërsa me më së paku gushti, me 42.2 mm.

Mesatarisht, toka e Ferizajt është 51.8 ditë e mbuluar me borë. Në janar ka më së shumti borë (17.0 ditë), ndërsa më së paku borë ka prilli (1.0 ditë).

Në Ferizaj fryjnë më së shpeshti erërat veriperëndimore (NW-248), veriore (N-142) dhe erërat juglindore (SE-147). Më së paku fryjnë erërat lindore (E-22).



Fig. 3: Temperaturat gjatë vitit në Komunë



Lufta në Kosovë, si dhe mungesa e mbrojtjes së mjedisit gjatë shumë viteve janë shkaktarët kryesorë të paraqitjes së problemeve të mëdha që kanë të bëjnë me situatën mjedisore në Komunën e Ferizajt.

Sipërfaqet e gjelbëruara publike janë shumë me rëndësi për shëndetin e qytetarëve dhe për rekreacionin e tyre. Edhe shumë peizazhe të bukura në afërsi të qytetit janë tërheqëse për banorët e tij.

Për fat të keq, Ferizaj nuk ka sipërfaqe të gjelbëruara, përveç disa kolonadave përgjatë rrugëve kryesore të Ferizajt, si dhe pjesëve të gjelbëruara përrreth hapësirave të dedikuara për sport dhe rekreacion. Edhe ato nuk janë të lidhura në ndonjë rrjet cilësor planifikues. Në Ferizaj nuk ekzistojnë sipërfaqe të tjera publike të gjelbëruara. Në pjesën qendrore të qytetit nuk ekziston ndonjë park i mirëfilltë.

Lumi i cili rrjedh përmes Ferizajt, për fat të keq, është i mbuluar. Kjo është një pjesë e lumit Nerodime, i cili në hyrje të qytetit nga pjesa perëndimore ndahet për të mos u bashkuar më (bifurkacioni), duke u derdhur në dy dete të ndryshëm. Kjo zonë, pra lugina e lumit Nerodime, në pjesën perëndimore të qytetit, ofron kushte ideale për formimin e hapësirave të gjelbëruara publike (parqeve), për zhvillimin e turizmit, si dhe të rekreacionit.

Edhe pse deponitë legale janë mbyllur dhe është formuar ajo transite, mostrajtimi adekuat i saj paraqet rrezik të përhershëm për ndotjen e mjedisit dhe të ujërave nëntokësore.



Analizat SWOT për peizazhin dhe mjedisin

S Përparësitë:

- Dega e lumit Nerodime hyn në brendi të qytetit,
- Zonë e gjerë rekreative është në dispozicion të banorëve të Ferizajt në zonën e bifurkacionit, të ujëvarës dhe të bashkimit të dy lumenjve.

W Dobësitë:

- Dega e lumit Nerodime, që hyn në brendi të qytetit, është e mbuluar dhe rrjedhja e mëtutjeshme e tij bëhet në tubacione,
- Mungojnë parqet dhe fushat sportive në brendi të qytetit,
- Aktivitetet industriale dhe komerciale afër lumenjve,
- Mbeturinat dhe kanalizimi derdhen direkt në lumenj,
- Deponia e vjetër gjendet pranë zonës së banimit dhe është e patrajtuar.

O Mundësitë:

- Parqet dhe lumenjtë mund të shfrytëzohen që të krijohen ambiente të bukura dhe klimë e shëndoshë,
- Lugina e lumit Nerodime në perëndim mund të formojë një park dhe zonë turistike natyrore të mbrojtur.

T Kërcënimet:

- Degradimi i trashëgimisë natyrore.



PLANI 2: SITUACIONI – PEIZAZHI DHE MJEDISI






1.5 POPULLSIA

Baza e të dhënave mbi popullsinë në Kosovë, si tërësi, si dhe mbi popullsinë e qytetit dhe Komunës së Ferizajt, është relativisht e pasigurt. Regjistrimi i përgjithshëm i fundit në Kosovë është bërë në vitin 1991 dhe të dhënat e prezantuara janë treguar të pasigurta. Regjistrimi i përgjithshëm më i sigurt daton nga vitet 1981 dhe 1971¹. Megjithatë, ato të dhëna nuk mund të shikohen si baza të mjaftueshme për ta vlerësuar zhvillimin e popullsisë mes asaj kohe dhe të tanishmes. Një regjistrim i ri i përgjithshëm mund të pritet më së shpejti në fund të vitit 2007², kështu që çfarëdo prognoze në lidhje me zhvillimin e popullsisë mund të jetë e bazuar vetëm në këto vlerësime dhe llogaritje. Duke qenë plotësisht të vetëdijshëm për mungesën e bazës së të dhënave, megjithatë, prognozat e zhvillimit të popullsisë janë esenciale për çfarëdo planifikimi strategjik

Në vitin 2005 nga OSBE-ja është paraqitur një vlerësim mbi popullsinë bazuar në të dhënat e siguruar nga Komuna dhe të kombinuara nga komuniteti i minoriteteve, të cilat kanë bërë një studim mbi përbërjen etnike në Ferizaj. Shifra prej 143.842 banorësh është relativisht e lartë, në krahasim me 96.967, vlerësuar nga OSBE-ja për vitin 1999, e cila mund të jetë e barabartë me shtimin e popullsisë prej më shumë se 48% vetëm në 6 vite. Për sigurimin e informatave më aktuale dhe të vlefshme mbi zhvillimin e popullsisë, në vitin 2005 është organizuar një hulumtim, me ç'rast pyetjet ishin përpiluar nga Komuna, me qëllim të mbledhjes së të dhënave nga të gjithë banorët. Megjithatë, të dhënat mundën të mbledhen vetëm nga njerëzit, të cilët ishin prezentë në kohën e vizitës në shtëpinë e tyre. Hulumtimi i tillë rezultoi me numrin prej 94.205 banorësh, i cili për shkak të procedurës së mbledhjes së të dhënave sigurisht se paraqet numër shumë më të vogël se numri real i banorëve që ka komuna. Vlerësimi më i ri i prezantuar nga komuna në vitin 2006, shënon rritje krahasuar me vlerësimin e vitit 2005, me numrin e përgjithshëm prej 144.351 banorëve, nga të cilët 70.312 jetojnë në qytetin e Ferizajt dhe 74.039 në fshatra.

1. Për shkak të ngjarjeve të historisë së fundit dhe faktit se nuk ka pasur regjistrim të përgjithshëm të popullsisë që nga viti 1981, sistemi i regjistrimit civil nuk është i freskët, praktikisht është e pamundur të jepen të dhëna absolute të sakta për numrin e popullsisë (të Kosovës), si tërësi, ose për pjesët e saj përbërëse (...). "cit.: Ark. i Statistikave të Kosovës: Statistikat e Tregut të Punës 2004, Seria e 5: statistikave Sociale; p.13
2. Draft-ligji për regjistrimin e përgjithshëm ishte dërguar në Kuvendin e Kosovës në maj të vitit 2003 dhe është aprovuar nga Kuvendi më 11 korrik 2003. Megjithatë, ligji nuk e përcaktoi datën kur do të bëhet regjistrimi i përgjithshëm. Kjo duhet të vendoset nga Kuvendi. Ligji për regjistrimin e përgjithshëm ishte shpallur me disa amendamente më 13 dhjetor të viti 2004 nga PSSP-ja (cf. SOK.org as of 10/02/06). Faza e parë testuese për regjistrimin e përgjithshëm është mbajtur në gjashtë komuna dhe është përfunduar në mes të nëntorit të vitit 2005. Pritej që regjistrimi i përgjithshëm do të mbahej në fund të vitit 2006 ose fillim të vitit 2007.

Fig. 4: Zonat e hulumtimit të popullsisë, të kryer nga KK



Proгноza për popullsinë e qyteti të Ferizajt është e realizueshme vetëm në kontekst të prognozave për tërë komunën. Vlerësimi dhe parashikimi i popullsisë së Ferizajt, komunës dhe qytetit, është trajtuar në detaje në nivel të planifikimit komunal (cf. Plani i Zhvillimit të Komunës së Ferizajt). PZHK disponon me rezultatet si në vijim:

Tab. 2 Numri i banorëve në qytetin e Ferizajt - 2006 / 2015 / 2020

Artikulli	2006	2015	Rritja	2020	Rritja
Numri i banorëve në qytet /1/	71.411	80.719	9.308	85.157	13.746

Vërejtje: /1/ numri i banorëve qytet/fshat, sipas vlerësimit komunal të vitit 2006



Duke marrë parasysh vlerësimin detal të zhvillimit të tanishëm dhe të ardhshëm demografik për qytetin e Ferizajt, të cekur më lart, këto të dhëna janë të pranueshme.

Analizat SWOT për popullsinë

S

Përparësitë:

- Qyteti ka rritje të madhe të popullsisë

W -

Dobësitë:

- Qyteti i Ferizajt disponon me fuqi punëtore relativisht të profesionalizuar, për të cilën momentalisht nuk ka punë. Kjo mund të shkaktojë zvogëlimin e numrit të punëtorëve të profesionalizuar.

O

Mundësitë:

- Në komunën e Ferizajt, qyteti është një qendër unike dhe për këtë ai tërheq shumicën e aktiviteteve ekonomike. Si pasojë qyteti do t'i tërheq banorët nga fshatrat, duke kërkuar punë më të mira ose më mirë të paguara – ose vetëm punë.

T

Kërcënimet:

- Me rritjen e popullsisë, komuna do të ballafaqohet me nevojat e rritjes enorme për investime si në infrastrukturën rrugore, ashtu edhe në atë fizike dhe sociale.

Analizat SWOT për depopullimin

S

Përparësitë:

- Zgjidhja momentale e strehimit,
- Punësimi,
- Emancipimi (shkollimi),
- Gatishmëria e komunave për pranimin e popullatës.

W -

Dobësitë:

- Boshatisja e fshatrave,
- Ngarkimi i qytetit.

O

Mundësitë:

- Investimet e reja,
- Rregullimi i infrastrukturës ligjore.

T

Kërcënimet:

- Koncentrimi i krizës sociale,
- Shfaqja e dukurive negative,
- Ndërtimi i egër.



1.6 BANIMI

Banimi është çështje vendimtare për stabilitetin social, për shëndet, si dhe për ngritjen e cilësisë së jetesës. Në komunën e Ferizajt jetohet kryesisht në shtëpi individuale. Objektet kolektive të banimit janë ndërtuar kryesisht pas Luftës së Dytë Botërore.

Edhe pas konfliktit të vitit 1999, janë ndërtuar banesa kolektive të cilat e kanë zbutur mjaft kërkesën për strehim të popullatës.

Nëse e shikojmë tabelën që vijon, do ta kemi një pasqyrë më të qartë të sipërfaqeve për banim në qytet dhe në komunë.

Bazuar në të dhënat demografike për komunën, një vlerësim i nevojave ekzistuese dhe atyre të ardhshme për banim është bërë në mënyrë të detajuar në PZHK (cf. Plani i Zhvillimit i Komunës së Ferizajt).

Për zonën urbane të Ferizajt, PZHK disponon me rezultate si në vijim:

Artikulli	2006	2015	Rritja	2020	Rritja
Numri i banorëve në qytet /1/	71.411	80.719	9.308	85.157	13.746
Numri i kryefamiljarëve në qytet /2/	10.202	12.813	2.611	14.193	3.991
Personat/kryefamiljarët në qytet /3/	7,0	6,3		6,0	
m ² / për person (Kosovë/Ferizaj) /4/	18,65/14.89			23 /8/	4,35

Legjenda/1/ numri i banorëve qytet/fshat, sipas vlerësimit komunal të vitit 2006

/2/ Kalkulime në bazë të numrit relativ të personave për familje

/3/ Të llogaritura në bazë të hulumtimit komunal të bërë në vitin 2005


/4/ Burimi: MESP 2005, f. 35, bazuar në vlerësime të shumanshme

Bazuar në supozimet e lartpërmendura, kërkesat në vijim për tokën e banimit në qytetin e Ferizajt, të parapara deri në vitin 2015 (llogaritjet e detajuara cf. Plani i Zhvillimit të Komunës së Ferizajt), janë:

- 114 ha në lidhje me një mesatare prej 100 migrimesh jashtë Komunës së Ferizajt në vit, ose
- 117 ha, nëse bilanci i migrimeve jashtë vendit (p.sh. migrimi në Komunën e Ferizajt dhe nga Komuna e Ferizajt) është i barabartë,
- 119 ha në lidhje me një mesatare prej 100 migrimeve në Komunën e Ferizajt në vit.

Përderisa plani i gatshëm ka për qëllim perspektivën përtej vitit 2015, plani i veprimit me plus 100 migrime, gjithashtu është llogaritur deri në vitin 2020. Kërkesat për tokë të banimit deri në vitin 2020 rezultojnë në 177 ha.

Fig. 5:Kërkesat e vlerësuara për tokë të banimit (në qytet)



Duhet të theksohet se vlerësimet e lartpërmendura varen kryesisht nga shtimi aktual i popullsisë në qytet dhe nga supozimet në lidhje me faktorët aktualë për nevojat e së ardhmes. Si rezultat i ndryshimeve potenciale të modelit socio-demografik, këto vlerësime mund të kenë nevojë të adoptohen për zhvillimet e së ardhmes.

Analizat SWOT për banimin

S

Përparësitë:

- Në Ferizaj do të plotësohet një pjesë e madhe e nevojave për banim të ri. Mund të pritët që qyteti të përfitojë nga migrimi brenda komunës, pra të njerëzve që lëvizin nga fshati në qytet.

W

Dobësitë:

- Duhet të përgatitet një tokë e re për banim dhe të sigurohet infrastruktura e duhur, infrastruktura teknike: rrugët, kanalizimi, energjia elektrike, si dhe infrastruktura shoqërore, si p.sh., shkollat dhe objektet për kujdesin mjekësor. Kjo është një sfidë e madhe financiare për komunën, me të cilën ajo do të përballet në vitet ardhshme.

O

Mundësitë:

- Të planifikohen dhe të ndërtohen vendbanimet për zhvillim në të ardhmen. Ky është një shans i rëndësishëm për krijimin e strukturave të mira dhe të përshtatshme të vendbanimit dhe për ta bërë Ferizajn një vend më të vlefshëm për të jetuar aty.

T

Kërcënimet:

- Zhvillimi i pabarabartë i objekteve për banim dhe i infrastrukturës, si i asaj teknike dhe rrugore, ashtu edhe i asaj sociale.



1.7 ZHVILLIMI EKONOMIK

1.7.1 HYRJE, KOSOVA-GJENDJA

Zhvillimet ekonomike dhe transformimi nga ekonomia e një sistemi politik të centralizuar në ekonomi të tregut, janë bazat e planifikimeve zhvillimore të komunave dhe të zhvillimeve urbane të qyteteve, sepse zhvillimet ekonomike janë forcë shtytëse e zhvillimit urban dhe rajonal. Pikërisht për këtë, do t'i bëjmë një vështrim të shkurtër gjendjes aktuale të ekonomisë në Kosovë dhe perspektivave të zhvillimit të saj.

Që nga lufta, Kosova ballafaqohet me ndryshime radikale të zhvillimit ekonomik. Para luftës ekonomia e Kosovës ishte e penguar dhe kufizuar me masa politike dhe administrative. Bujqësia ishte e përhapur dhe popullsia jetonte në fshatra. Ka pasur prodhimtari të industriale, posaçërisht të minierave në zonën e Mitrovicës dhe të eksploatimit të thëngjillit afër Prishtinës. Meqë në kohën e ish Jugosllavisë Kosova ishte e anashkaluar nga disa vendime politike federale, këtu nuk kishte investime të orientuara për zhvillimin industrial, përveç atyre për eksploatimin e burimeve minerale. Përveç kësaj, në zona të caktuara janë zhvilluar edhe disa kombinatë të agrobiznesit.

E shkaktuar nga rënia e sistemit socialist dhe luftës, korniza e aktiviteteve ekonomike është zhdukur gati tërësisht. Pas luftës, nga UNMIK-u janë ngritur struktura të reja, të mbështetura nga BE, USAID dhe nga organizata të ndryshme profesionale ndërkombëtare. Me krijimin e Parlamentit dhe Qeverisë së Kosovës, viti 2003 i gjen qytetarët e Kosovës të përfshirë në zhvillimin e mëtutjeshëm të strukturave të përshtatshme ekonomike, ligjore dhe politike, të bazuara në parimet e ekonomisë së tregut dhe demokracisë.

Ish prona shtetërore, e ashtuquajtur publike dhe shoqërore e ndërmarrjeve, është bartur në kompetencë të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM), që është formuar për ta futur atë në treg dhe për të promovuar privatizimin. Kjo zhvilloi dhe zbatoi strategjitë dhe procedurat e transicionit të ekonomisë së Kosovës nga ekonomia shtetërore në ekonomi tregu. Para shumë vitesh kishte paqartësi në të drejtat pronësore, disa nga të cilat edhe sot e kësaj dite kanë mbetur si të tilla. Këto paqartësi mund të dalin pengesë për investime.

Zhvillimi i mëtejshëm ekonomik

Është më se e evidente se zhvillimi ekonomik në Kosovë nuk fokusohet në aktivitet ekonomik, por në tregti. Përqindja e ndërmarrjeve prodhuese është zvogëluar në 25 për qind. Kjo duhet ndryshuar. Ky ndryshim ka nevojë për



përmirësime në arsimim (kualifikimet e certifikuara profesionale), në taksim (taksa më të larta në prodhimet finale dhe taksa më të ulëta për materialet që përpunohen në Kosovë), dhe në mentalitet (mbështetja në forcat vendore të Kosovës dhe zvogëlimi i varësisë ekonomike nga donatorët e huaj). Mbështetja për ekonominë duhet të jetë mision qendror i të gjitha organeve publike të Kosovës, posaçërisht i AKM-së, aktivitetet e së cilës deri tani janë udhëhequr nga rregulloret burokratike në vend se të udhëhiqeshin nga procedura më elastike, për të pasur një reaksion më të ndjeshëm të kërkesave të biznesit dhe të investimeve.

Për zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë në Kosovë, duhet të eksportohen më shumë prodhime dhe shumë produkte të cilat janë importuar deri tani duhet të zëvendësohen me ato vendore. Parimisht, për të zvogëluar varësinë nga importet, duhet të forcohet prodhimi vendor.

E ardhmja e ndërmarrjeve të mëdha është e paqartë. Parashikohet që energjia elektrike, e prodhuar nga eksploatimi i thëngjillit, në një të ardhme të afërt mund të eksportohet sikurse para luftës. Megjithatë, importet e tjera të energjisë, p.sh. gazi dhe nafta për nxehtë, do të bëhen shumë të rëndësishme për të ardhmen, me qëllim që furnizimi dhe shpenzimi i energjisë të jetë më racional dhe në bazë të standardeve ndërkombëtare.

1.7.2 Zhvillimi i industrisë dhe i biznesit në Ferizaj

Zhvillimi i sektorit të NVM-së (ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme)

Ekzistojnë një sërë ndihmash në dispozicion për NVM-të nga organizatat lokale dhe ndërkombëtare, si OEK, EICC, REA, USAID dhe të tjera. Ato kontribuojnë për stabilitetin dhe për ngritjen e profesionalizmit të këtyre industrive. Organizatat sigurojnë ndihmë për të mundësuar zhvillimin e prodhimeve të reja dhe tregun. Mbështetje ka edhe nga institucionet e caktuara të nivelit shtetëror, me qëllim të krijimit të klimës në favor të zhvillimit ekonomik. Kjo i referohet në veçanti ngritjes së arsimimit profesional, certifikimit të standardeve, cilësisë së menaxhimit, prodhimit, produkteve etj. Të gjitha këto aktivitete mund të kontribuojnë në stabilizimin NVM-ve, si bazë e rëndësishme e ekonomisë së Kosovës dhe e Ferizajt për të sjellë shumë më shumë prodhime në tregun e Kosovës, duke siguruar edhe mundësi punësimi.

Hapja e bizneseve për shumë njerëz është mënyra e vetme për të krijuar të ardhura personale, edhe pse në të shumtën e rasteve ajo është e nivelit të ulët. Tani preferohet të hapen biznese që kuptohen më së lehti, p.sh. që nuk kërkojnë ndonjë përgatitje profesionale thelbësore ose trajnim, si p.sh. pompa benzine, autolarje, restorante etj. Edhe pse shkalla e zhvillimit të këtyre aktiviteteve për një entitet është shumë e vogël, si tërësi nuk duhet



të anashkalohet dhe çdo biznes i vogël mund të jetë një bërthamë nga e cila mund të rrjedhin aktivitetet e tjera.

Për një perspektivë afatshkurtër dhe afatmesme të zhvillimit ekonomik mundësi të caktuara mund të shihen në industrinë e ndërtimtarisë, në industrinë e përpunimit të drurit dhe të agrobiznesit. Edhe pse mendohet se nuk janë degë inovative të ekonomisë, të bazuara kryesisht në fuqinë punëtore të pakualifikuar, ato mund të zëvendësojnë prodhimet e huaja dhe të krijojnë prodhime kosovare për eksport. Siç duket, ndërmarrësit deri tani kanë qenë të suksesshëm në gjetjen e hapësirave të përshtatshme.

Aktualisht, mungesa e zonave ndërtimore nuk mund të jetë pengesë e madhe për zhvillimin e biznesit. Megjithatë, ka pasur kritika të drejtuara për shkak të mungesës së fleksibilitetit të AKM-së për të gjetur mënyrat më pak të ndjeshme për t'i vënë pronat, tokën dhe ndërtesat në dispozicion të ndërmarrjeve lokale, në vend të përjashtimit të tyre nga përdorimi.

Entitetet e NVM-ve janë të vogla, kështu që struktura e zonave që duhet të zhvillohen për qëllime të ndërmarrjeve tregtare do të mund të përputhej me kërkesat e shkallës së tillë. Për të përmbushur kërkesat e nduarnduarshme, sa i përket madhësisë dhe vëllimit të ndërtesave të lejuara, duhet të planifikohen zona tregtare të llojeve të ndryshme. Çdo shërbim urbanistik mund të jetë i dobishëm. Standardet për ruajtjen e mjedisit duhet të aplikohen dhe të fuqizohen përmes ligjit. Duhet të sigurohet qasja e NVM-ve dhe ky sistem i brendshëm i rrugëve të lidhet nëpërmjet sistemit rrugor rajonal.

Autoritetet në komunën e Ferizajt kanë ndërmarrë aktivitete të shumta për zhvillimin e mirëfilltë të bizneseve, duke filluar nga lehtësimi i qasjes në lokacion, dhënia e pëlqimit për plotësimin e kushteve mjedisore, dhënia e lejes së punës, caktimi i tatimeve dhe mallrave, dhënia e pëlqimit për shfrytëzimin e tokës bujqësore, caktimi i qirasë për objektet komunale, përmirësimi i infrastrukturës e të ngjashme. Në përmirësimin e mjedisit për biznes në komunë ka ndikuar edhe kompania amerikane "Brown&Root", në të cilën, sipas disa shënimeve, kishte 4.700 të punësuar. Në komunën e Ferizajt ekzistojnë edhe rrjete mbështetëse për zhvillimin e bizneseve, si Zyra Rajonale për Zhvillimin e Bizneseve, OEK-rajonale dhe shoqata e biznesit. Veprojnë edhe shoqata të tjera profesionale, si ajo e zejtarëve, blegtorëve, ekonomistëve, juristëve etj.



Ndërmarrjet shoqërore

Aktualisht në Kosovë nuk shihet ndonjë perspektivë e qartë për investime në fabrikat industriale që janë të orientuara për eksport. Në konkurrencën globale do të ishte shumë lirë (fuqia punëtore, e kualifikuar), ose qasja shumë e lirë në burimet natyrore dhe minerale që do të mund të joshnin një investim të tillë. Për shkak të kostos shumë të lartë të jetesës në Kosovë, megjithatë, fuqia punëtore nuk mund të jetë më e lirë se në vendet e tjera të rajonit. Mungesa e lidhjeve të mira rrugore mund të shihet si një formë e disavantazhit. Pasi që bie në kundërshtim me objektivat e tjera të zhvillimit, mundësia për të promovuar investimet industriale të standardeve të ulëta për mbrojtje të mjedisit, nuk është përkrahur nga politikanët kosovarë. Një opsion i tillë vështirë se do t'i joshte investimet në Evropën Juglindore, në një ekonomi të globalizuar.

Megjithatë, planifikimin afatgjatë të investimeve industriale të shkallës së mesme nuk duhet përjashtuar kategorikisht. Duke u siguruar se ai do të përputhej me planin e vendbanimit, investimet e tilla janë shumë të dëshirueshme dhe në plan duhet të caktohen hapësirat e përshtatshme, në mënyrë që të sigurohet investim i konsiderueshëm në të ardhmen.

Deri në aplikimin e masave të dhunshme (vitet 1989-1990), ekonomia e Ferizajt ishte mjaft e zhvilluar, sidomos industria metalike, ajo e përpunimit të drurit, industria ushqimore dhe ndërtimtaria. Përveç kësaj, në Ferizaj janë të zhvilluara edhe degët e tjera të ekonomisë, si tregtia, komunikacioni (transporti), pylltaria, bujqësia etj. Aplikimi i masave të dhunshme, largimi masiv i punëtorëve shqiptarë nga ndërmarrjet shoqërore dhe periudha e luftës, lanë pas vetes pasoja të mëdha në ekonominë e Ferizajt. Pas luftës janë bërë përpjekje për konsolidimin e këtyre ndërmarrjeve drejt rivitalizimit dhe aktivizimit të kapaciteteve, mirëpo rezultatet nuk janë inkurajuese. Në komunën e Ferizajt aktivitetin ekonomik e zhvillojnë 25 ndërmarrje shoqërore dhe publike. Shumica e ndërmarrjeve shoqërore janë komercializuar.

Në bazë të shënimeve që ofron Drejtoria për Ekonomi dhe Financa e Komunës së Ferizajt, numri i bizneseve të regjistruara arrin në 4.413 ndërmarrje të vogla dhe të mesme, në të cilat janë të punësuar 9.137 punëtorë. Struktura, sipas veprimtarive të këtyre NVM-ve, duket si në diagramin në vijim.



Fig. 6: Ndërmarrjet në Komunën e Ferizajt





Fig. 7: Ndërmarrjet në pjesën urbane të Komunës së Ferizajt





Problemet dhe sfidat

- Mungesa e buxhetit,
- Infrastruktura,
- Struktura e pavolitshme e bizneseve,
- Shfrytëzimi i vogël i kapaciteteve ekzistuese industriale,
- Predimensionimi i kapaciteteve tregtare,
- Mbrojtja e konsumatorit,
- Mbrojtja dhe stimulimi i prodhimeve,
- Degradimi i resurseve vendore turistike,
- Degradimi i tokës bujqësore dhe humbja e kësaj veprimtarie,
- Format dhe ngastrat e vogla,

1.7.3 Industria

Deri në aplikimin e masave të dhunshme (vitet 1989-1990), ekonomia e Ferizajt ishte mjaft e zhvilluar. Sidomos ishin të zhvilluara industria metalike, industria e përpunimit të drurit, industria ushqimore dhe ndërtimtaria.

Aplikimi i masave të dhunshme dhe largimi masiv i punëtorëve shqiptarë nga ndërmarrjet shoqërore dhe periudha e luftës, lanë pas vetes pasoja të mëdha në ekonominë e Ferizajt. Pas luftës janë bërë përpjekje për konsolidimin e këtyre ndërmarrjeve, për rivitalizimin dhe aktivizimin e kapaciteteve të tyre, mirëpo rezultatet nuk qenë inkurajuese.

Në Komunën e Ferizajt aktivitetin ekonomik e zhvillojnë 25 ndërmarrje shoqërore dhe publike, sipas strukturës që shihet në këtë tabelë:

Përshkrimi	Nr i subjekteve	Nr. i punëtorëve
Ndërmarrje bujqësore	4	152
Pylltaria	1	62
Ndërmarrje tregtare	7	353
Industria përpunuese	8	2443
Shërbimet komunale publike	1	58
Ndërtimtaria	2	208
Riparimet dhe mirëmbajtja	1	235
Hotelet dhe restorantet	2	46
Ndërmarrjet transportuese	2	329
Ndër. Fin. (sigurimet)	1	9
Totali	25	3743

Burimi: Strategjia zhvillimore e Ferizajt

Në Komunën e Ferizajt janë komercializuar gati të gjitha ndërmarrjet shoqërore.



Analizat SWOT për industrinë

S

Përparësitë:

- Tradita industriale,
- Pozita e volitshme gjeografike,
- Ekzistimi i resurseve natyrore,
- Resurset njerëzore,
- Ekzistimi i zonave të veçanta industriale-prodhuese,
- Ekzistimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme prodhuese
- Procesi i privatizimit.

W

Dobësitë:

- Infrastruktura,
- Struktura e pavolitshme e bizneseve,
- Shfrytëzimi i vogël i kapaciteteve industriale,
- Kuadri i pamjaftueshëm profesional,
- Teknologjia e vjetruar,
- Buxheti i pamjaftueshëm,
- Politika fiskale dhe kreditore jo e volitshme,
- Rritja e papunësisë.

O

Mundësitë:

- Riaktivizimi i kapaciteteve ekzistuese,
- Riaftësimi i resurseve njerëzore-profesionale,
- Ristrukturimi i proceseve të prodhimit bazuar në fleksibilitet,
- Shfrytëzimi i kapaciteteve nga diaspora (joshja e investitorëve),
- Krijimi i partneriteteve.

1.7.4 Tregtia

Vetë pozita gjeografike është faktor shumë me rëndësi për zhvillimin e tregtisë në Ferizaj. Duhet të theksohet se tregtia zhvillohet më së paku në qendra të specializuara tregtare, por më tepër është zhvilluar përgjatë rrugëve kryesore të komunës dhe qytetit.

Zhvillimin e tregtisë në Ferizaj, përveç afërsisë me kufirin, e ka ndihmuar edhe prezenca kampeve ushtarake ndërkombëtare.

Analizat SWOT për tregtinë

S

Përparësitë:

- Pozita gjeografike (afërsia me kufirin),
- Tradita (përvoja),
- Resurset natyrore,
- Ekzistimi i prezencës ndërkombëtare,
- Ekzistimi i mekanizmave për mbështetje të tregtisë.

**W**

Dobësitë:

- Infrastruktura,
- Predimensionimi i kapaciteteve tregtare.

O

Mundësitë:

- Stimulimi i shitjes së prodhimeve vendore.

T

Kërcënimet:

- Tregtia e zezë joformale (gri).

1.7.5 Turizmi

Ferizaj, edhe si komunë por edhe si qytet, ka potenciale mjaft të mëdha për zhvillimin e turizmit si të atij kulturor, ashtu edhe të atij natyror dhe rekreativ. Ndër potencialet e zhvillimit të turizmit lokal janë malet e bukura të Sharrit, lugina e lumit Nerodime, bifurkacioni, bashkimi i dy lumenjve etj.

Tab. 3: Potencialet për zhvillimin e turizmit në Komunë

	Vendbanimi	Potencialet natyrore për zhvillimin e turizmit								
		Lloji i turizmit				Niveli			Infrastruktura	
		Ma-lor	Kul-turor	Ve-ror	Tran-zit	Lok-al	Ko-mbëtar	Ndë-rko-mbëtar	Ni-veli i ulët	Me-sa-tare
1	Ferizaj (qyteti)		1		1	1		1	1	1
6	Burrnik	1				1				1
10	Dardani (Tanko-siq)				1	1				1
12	Gërlinë				1	1				1
14	Jezerc	1				1				1
16	Koshare				1	1				1
24	Neredime e E.			1		1				1
29	Prelez i J.				1	1				1
30	Prelez i M.				1	1				1
34	Slivove		1				1			1
36	Sojevë				1	1				1
	Niveli i Komunës	2	2	1	7	10	1	1	1	11

Burimi: Kuvendi i Komunës, Ferizaj



Analizat SWOT për turizëm

S

Përparësitë:

- Pozita e volitshme gjeografike,
- Resurse natyrore në dispozicion,
- Bifurkacioni si fenomen,
- Ekzistimi i zonave të veçanta për turizëm.

W

Dobësitë:

- Mungesa e planifikimit,
- Mungesa e infrastrukturës,
- Buxheti i pamjaftueshëm,
- Mungesa e marketingut turistik.

O

Mundësitë:

- Shfrytëzimi i resurseve natyrore,
- Përmirësimi i infrastrukturës,
- Përkrahja e komunitetit audiencës në ngritjen e kapaciteteve turistike,
- Zhvillimi i turizmit kulturor,
- Zhvillimi i vikend-zonave turistike.

T

Kërcënimet:

- Degradimi i resurseve turistike,
- Migrimet e popullsisë.

1.8 TRAFIKU DHE TRANSPORTI

1.8.1 Rrjeti rrugor

Ferizaj ka lidhje shumë të mira me të gjitha qytetet kryesore të Kosovës. Gjithashtu, ai, përmes Gjilanit, ka edhe lidhje shumë të mirë me rrjetin e transportit evropian.

Nëse e shikojmë hartën e komunës, vërejmë se rrjeti rrugor është i formuar me qendër në Ferizaj, gjë që është pozitive për komunikacionin ndërurban, por negative për komunikacionin në qytet.

Ferizaj ka lidhje shumë të mirë në arterien kryesore të Kosovës, në drejtimin veri-jug, magjistrallja M2/E65, e cila e lidh Prishtinën me Shkupin, si dhe në drejtimin lindje-perëndim, magjistrallja M25-3, e cila lidh Ferizajn me Gjilanin dhe Prizrenin.

Ferizaj ka gjithashtu lidhje të mira me Shtërpcën, Tetovën dhe Shtimen. Kjo e fundit është shumë me rëndësi, meqë nëpërmjet Shtimes bëhet lidhja e Ferizajt me autostradën Nish-Durrës.



Edhe rrugët rajonale dhe ndër-rajonale kanë një shtrirje mjaft të mirë hapësinore, por edhe këto, si ato rajonale, janë të një standardi mjaft të ulët. Të gjitha këto rrugë nuk kanë shtigje për këmbësorë dhe biçikleta, prandaj edhe ekziston rreziku potencial i fatkeqësive në komunikacion.

Shumica e fshatrave janë të lidhura me rrugë rajonale. Një numër i madh i tyre janë të asfaltuara, por janë në gjendje shumë të dobët. Pjesa tjetër e rrjetit rrugor është i paasfaltuar. Një numër i fshatrave janë të paarritshme në dimër, për shkak të borës dhe akullit.

Trafiku

Të dhënat për gjatësinë dhe sipërfaqen e rrugëve të asfaltuara në komunë janë paraqitur në tabelën në vijim.



Tab. 4: Gjatësia dhe sipërfaqja e rrugëve të komunës

Nr.	Emri i rrugës	Gjatësia	Sipërfaqja
		(m')	(m ²)
1	Dëshmorët e Kombit	3000	21 000
2	Rexhep Bislimi	1230	9 470
3	Reçakut	2600	18 720
4	Epopeja e Jezercit	2500	12 500
5	Pleshinës	1200	4 800
6	H. Sulejmani	376	1 692
7	Gjergj Kastrioti	365	1 585
8	Astrit Bytyçi	643	5 039
9	Lidhja e Prizrenit	1330	7 007
10	Hasan Prishtina	1150	5 700
11	Njazi Bajraktari	439	2 392
12	Lubotenit	680	2 720
13	Janinës	306	1 224
14	M. Shemsedini	308	2 163
15	E. Topalli	670	3 685
16	K. Hetem	272	1 496
17	Beteja e Kaçanikut	210	735
18	M. Bakija	540	3 240
19	Tiranës	430	1 720
20	Besim Rexhepi	500	2 500
21	Kërçovës	163	685
22	Shën Jeronimi	290	1 450
23	E. Duraku	442	2 973
24	Dukagjinit	516	2 064
25	Isa Boletini	583	2 332
26	Shkumbinit	199	826
27	G. Tërbeshi	1229	5 970
28	M. Shemsedini	637	2 548
29	Dardania	410	2 225
30	Riza Matoshi	1605	6 670
31	Sh. Polluzha	398	1 950
32	Mgjenit	200	800
33	A. Kaçiku	1175	10 575
34	V. Gërvalla	1280	11 520
Totali :		27 876	33 926

Burimi: Kuvendi i Komunës - Ferizaj



Analizat SWOT për trafikun

S

Përparësitë:

- Lidhje e mirë me Prishtinën dhe Shkupin përmes M2/E65,
- Lidhje e mirë me Gjilanin përmes M25-3,
- Lidhje të mira me Tetovën, Shtërpçën dhe Shtimen,
- Standard relativisht i mirë i rrugëve kryesore,
- Lidhje të mira të trafikut publik.

W

Dobësitë:

- Disa pjesë të vendbanimeve arrihen shumë vështirë, ndërsa dimrit një pjesë e tyre nuk arrihen fare,
- Nuk ka shtigje për këmbësorë dhe çiklistë.

O

Mundësitë:

- Rrjeti më i mirë rrugor.

T

Kërcënimet:

- Ndërtimet e mëtutjeshme skaj rrugëve dhe pamundësimi i zgjerimit të tyre

1.8.2 Hekurudha

Hekurudha, e cila pati ndikim të madh në formimin e Ferizajt si qytet, njëherësh luan rol të rëndësishëm për jetën e ferizajasve. Përveç vlerës historike, ajo ka rëndësi të madhe për transportin e udhëtarëve, e posaçërisht për transportin e mallrave pasi që Ferizaj gjendet në udhëkryq të rrugëve më kryesore të Kosovës.

Për fat të keq, për shkak të gjendjes së keqe në të cilën ndodhet, ajo tani përdoret vetëm simbolikisht.

Analizat SWOT për hekurudhën

S

Përparësitë:

- Bartja më e shpejtë e mallrave dhe personave,
- Përcaktimi i Ferizajt si port i Kosovës, pasi që mallrat kalojnë nëpërmes Ferizajt në Maqedoni dhe anasjelltas.

W

Dobësitë:

- Cilësia e dobët e hekurudhës, si dhe funksionimi i dobët i trenave,
- Teknika e vjetruar,
- Mungesa e kalimeve të sigurta për këmbësorë dhe automjete përtej hekurudhës.

O

Mundësitë:

- Krijimi i kushteve më të volitshme për funksionim.

T

Kërcënimet:

- Mospërfillja e nevojës së një hekurudhe të mirëfilltë.



1.8.3 Transporti

Transporti publik në qytet është mjaft i organizuar, duke marrë parasysh mosfunksionimin unik të objekteve të stacionit hekurudhor dhe të atij të autobusëve. Transporti i mallrave është faktor kryesor i tejngarkimit të rrugëve, meqë ai nuk zhvillohet normalisht me hekurudhë, që do të ndihmonte në shkarkimin e rrugëve dhe në funksionimin më normal të trafikut automobilistik.

Analizat SWOT për transportin

S

Përparësitë:

- Mbulimi i territoreve të vendbanimeve me transport publik,
- Ekzistimi i konkurrencës,
- Pozita e volitshme gjeografike,
- Ekzistimi i hekurudhës.

W

Dobësitë:

- Struktura ligjore për transportin rrugor,
- Mungesa e transportit publik urban,
- Kualiteti i dobët i infrastrukturës për shfrytëzimin e biçikletave,
- Mungesa e vendqëndrimeve të transportit publik,
- Mosshfrytëzimi i kapaciteteve të hekurudhës
- Infrastruktura e dobët rrugore,
- Mungesa e bashkëpunimit ndërinstitucional,
- Edukimi joadekuat në lëmin e komunikacionit,
- Urat joadekuate,
- Mungesa e unazës rrugore,
- Mjetet e vjetruara të transportit (amortizimi i madh i tyre).

O

Mundësitë:

- Organizimi i transportit publik
- Decentralizimi i kompetencave , bashkëpunimi,
- Integrimi i stacioneve,
- Përmirësimi i sistemit të rrugëve.

T

Kërcënimet:

- Kaosi në komunikacion,
- Numri i lartë i aksidenteve.



PLANI 3: SITUACIONI – INFRASTRUKTURA TEKNIKE DHE TRAFIKU



1.9 INFRASTRUKTURA TEKNIKE

Në përgjithësi, infrastruktura në qytet është në nivel jo të kënaqshëm dhe nuk i plotëson nevojat për banorët e qytetit, duke filluar nga sasia jo e mjaftueshme e ujit të pijes, mungesa e kanalizimit në 20 për qind të territorit të qytetit, si dhe rrjeti i vjetruar i PTT-së. Prandaj është nevojë e domosdoshme investimi për evitimin e problemeve të cilat janë si pasojë e mosfunksionimit të infrastrukturës në qytet. Të mos flitet për infrastrukturën teknike nëpër fshatra. Ajo jo që është e dobët, por mungon fare.

Parakusht për zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik është edhe modernizimi i infrastrukturës energjetike dhe të trafikut, që nënkupton modernizimin e trafikut rrugor dhe hekurudhor, modernizimin e rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit, të rrjetit energjetik dhe racionalizimin e komunikacionit dhe lidhjeve.

Problemet dhe sfidat

- Mosmbulimi i tërë territorit me shërbime të telekomunikimit,
- Infrastruktura e dobët rrugore dhe e sistemit të transportit,
- Infrastruktura e vjetruar energjetike,
- Mosqasja e mjaftueshme në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit,
- Mostrajtimi i ujërave të zeza,
- Mosekzistimi i deponive për mbeturina industriale, ndërtimore, mjekësore.

1.9.1 Furnizimi me ujë dhe Kanalizimi

Edhe gjendja e ujësjellësit dhe e kanalizimit nuk është e kënaqshme, qoftë në aspektin sasior, qoftë në atë përmbajtjesor. Kjo gjendje shihet më së miri në ilustrimet në vijim.



Fig. 8: Shtirja e rjetit të kanalizimit në qytet







Fig. 9: Shtrirja e rrjetit të ujësjellësit në qytet



Në muajin prill të vitit 2006 kanë filluar hulumtimet gjeofizike të ujërave të pijshëm në Komunën e Ferizajt dhe të Gjilanit. Ky projekt është financuar nga Qeveria Zvicerane (7,5 milion euro) dhe zbatimi i është besuar Kompanisë EBP (Ernst Basler+Partner Ltd).

Hulumtimet ishin të drejtuara kryesisht në përcaktimin e karakteristikave të sakta të puseve, në hapësirat e identifikuara më parë në studimin e fizibilitetit të ZhRUKJ (Elektrowatt)

Në kuadër të projektit për zhvillimin e resurseve ujore në Kosovën Juglindore, hulumtimet gjeofizike me mjete bashkëkohore do të bëjnë identifikimin e ujërave nëntokësore që do të mund të shfrytëzoheshin për pije, në mënyrë që të shtohen kapacitetet e ujërave për komunat Ferizaj dhe Gjilan, ku tani ka mungesë të ndjeshme të ujit të pijes.



Këto hulumtime përfunduan në janar të vitit 2007, ndërsa raporti është bërë më 28 shkurt 2007. Në vazhdim po i shkëpusim konkluzionet dhe rekomandimet nga ky raport.

Hapësira e Nerodimes

Duke pasur parasysh lidhjet hidraulike të identifikuara brenda aquiferit në gëlqerorët e Triasikut në mes të piezometrave LM5, LV1 dhe burimit, nuk rekomandohet të ndërtohet asnjë pus prodhues në këtë lokacion. Kjo, gjithashtu, përfshin edhe lokacionin e identifikuar paraprakisht për pusin afër LM2, e që ndodhet pikërisht në kufirin e trupit gëlqeror.

LM1 ndodhet në mes të dy trupave gëlqerorë të lidhur (në njërin anë LM5/2, dhe në anën tjetër burimi). Megjithëse gjatë testeve të pompimit në LM1 nuk është vërejtur një ndikim i qartë në prurjen e burimit, nuk mund të garantohet se pompimi afatgjatë nuk do të ndikojë në burim. Sasia e prodhueshmërisë së rekomanduar 3.5 l/s nuk e justifikon rrezikun e mundësisë së ndikimit në burim.

Pusi i propozuar afër piezometrit të Elektrowattit TW100 mund të operojë me një prodhueshmëri 9 l/s (rrezja e pusit 0.2 m). Për shkak të përbërjes gjeologjike (gëlqeroret e kretakut të shpërndara nëpërmes të rreshpeve të papërshtueshme të Paleozoikut nga gëlqeroret e Triasikut) është shumë pak e pritshme lidhja hidraulike mes burimit dhe këtij lokacioni.

Për shkak të burimeve të kufizuara në disponim (12.5 l/s), zhvillimi i burimeve të ujërave nëntokësore nuk prezanton një opsion ekonomik të arsyeshëm në hapësirën e Nerodimes. Këto rekomandime janë pranuar nga të gjitha palët, në mbledhjen e Komitetit Drejtues, më 31 janar 2007. Megjithatë, duke qenë një burim i rëndësishëm për ujë të pijshëm, rekomandohet të mbrohet burimi i Nerodimes. Edhe ashtu, sistemi ekzistues nuk është nën mbikëqyrje. Në pusetën dhe rezervuarin e burimit qasja është e lirë, kështu që ato lehtë mund të dëmtohen dhe ndoten. Burimi duhet të rrethohet në mënyrë të përshtatshme dhe rrethina e ujëmbledhësit të shënohet me shenja.

Pellgu i Ferizajt

Depozitimet e rërës aluviale përgjatë Lumit Nerodime (piezometrat F1 dhe F2) treguan se kanë një prodhueshmëri shumë të ulët të ujit, kështu që ato nuk janë një opsion për shfrytëzimin e ujit nëntokësor në të ardhmen. Burime potenciale të ujërave nëntokësore për këto vende duket se mund të jenë aquiferët e mbyllur brenda depozitimeve terciare në pellg. Këta aquiferë, së fundi, kanë filluar të shfrytëzohen në disa lokacione të ndryshme të Ferizajt (shiko tabelën në vijim).



Fshati	Nr. i Pusev	Prodhueshmeria	Gjendja
Varosh	2	30	Funksional qysh nga fundi 2006
Muhovc	1	12	Funksional qysh nga fundi 2006
Mirash	3	11-12	Eshte planifikuar fillimi i funksionimit ne 2007
Pojat/ Softoj	1	8	Eshte planifikuar fillimi i funksionimit ne 2007
Kosine	2	20	Eshte planifikuar fillimi i funksionimit ne 2007
Cernille	1	8	Funksionon qe nga 2003
Bablak	1	5	Funksional qysh nga fundi 2006
Syrqine	1	7	Funksional qysh nga fundi 2006
Babush	1	5	Funksional qysh nga fundi 2006

Te dhënat për gjendjen e puseve, të marra nga hulumtimi i financuar nga Qeveria Zvicerane dhe i implementuar nga Kompania EBP, prill 2006-janar 2007

Me piezometrin F3 (Talinovc) dhe F4 (Nekodin) u synua hulumtimi i rrethinës së afërme të hapësirës urbane të Ferizajt. Pavarësisht depozitimeve të gjetura shumë premtuese në piezometrin F4 (kryesisht rërë dhe zhavorr), çuditërisht u dëshmuar një prodhueshmëri shumë e ulët, veçanërisht në krahasim me pusin e afërm në Varosh (në distancë 900 m; ulja 13.19m me 20l/s).

Piezometri në Talinovc ka prekur tri shtresa të mbyllura të rërës dhe të zhavorrit në thellësinë 151-168m, e që ofron një opsion me interes për një pus prodhues ($Q_{max} = 18.5$ l/s). Sidoqoftë, uji nuk ishte i pastruar prej rërës, një fenomen që është parë edhe në pusët e tjera në këtë hapësirë (p.sh. në Softaj).

Për shkak të vendosjes së gypave me hapje edhe në 49 shtresat me përshkueshmëri më të vogël (me përmbajtje më të lartë të materialit të imët), nuk mund të përcaktohet origjina e rërës së imët. Në rast të ndërtimit të pusit të mundshëm prodhues, rekomandohet që gypat me hapje të vendosen vetëm në shtresat e thella e të vrazhda (kokërrmëdha).

Analizat SWOT për ujë & kanalizimin

S Përparësitë:

- Hidrografia e pasur,
- Ekzistimi i rrjetit të ujit industrial.

W Dobësitë:

- Degradimi i shtretërve të lumenjve,
- Mosqasja e mjaftueshme në rrjetin e ujësjellësit,
- Mostrajtimi i ujërave të zeza,
- Shfrytëzimi joracional i ujit të pijshëm,
- Mosqasja e mjaftueshme në rrjetin e kanalizimit,
- Centralizimi i menaxhimit të ujërave,
- Mosmirëmbajtja e kanaleve atmosferike.

O Mundësitë:

- Mundësia e rritjes së sasisë së ujit të pijes,

- Mundësia e trajtimit të ujërave të zeza,
- Aktualizimi i Sistemit Ibër -Lepenc,
- Hapja e kanaleve atmosferike.

T

Kërcënimet:

- Shfaqja e epidemive,
- Pamundësia e shfrytëzimit të ujit për ujitje,
- Vërshimet.

Duke pasur parasysh nevojat për ujë të pijshëm, që janë rreth 500 l/s, pastaj konkluzionet nga ky hulumtim, është e qartë nevoja e gjetjes së mundësisë për plotësimin e kërkesave për ujë. Aktualisht Fabrika e Ujit në Ferizaj, me kapacitet 220l/s, prodhon rreth 140 l/s. Nga Jezerci pritet se mund të merren edhe rreth 100 l/s, që do të plotësojë 100% kapacitetin e fabrikës, por nuk do ta zgjidhë nevojën për ujë të pijshëm, e cila është së paku dyfish më e madhe se ky kapacitet.

Duke pasur parasysh rëndësinë e ujit të pijshëm, një nga projektet kyçe dhe më me prioritet është gjetja e mundësisë së sigurimit të kapaciteteve të mjaftueshme për ujë të pijes.

1.9.2 Menaxhimi i mbeturinave

Mbeturinat transportohen në deponinë transite ditore dhe pastaj përcillen në deponinë rajonale të Komunës së Gjilanit. Të gjitha deponitë janë të mbyllura, mirëpo janë të patrajtuara, prandaj ekziston rreziku i ndotjes së mjedisit. Ndotja bëhet edhe nga deponitë ilegale.

Fig. 10: Deponia transite në Gërlicë





Analizat SWOT për menaxhimin e mbeturinave

- S** Përparësitë:
- Infrastruktura ligjore,
 - Ekzistimi i ndërmarrjes publike për menaxhimin e mbeturinave,
 - Ekzistimi i deponisë transite.
- W** Dobësitë:
- Nuk ka deponi lokale,
 - Nuk ka deponi të ndara për mbeturina industriale, mjekësore dhe ndërtimore,
 - Mostrajtimi i deponive të mbyllura ekzistuese,
 - Deponitë ilegale.
- O** Mundësitë:
- Përcaktimi i kompetencave në menaxhim,
 - Vetëdijesimi i popullatës për problemet e mjedisit,
 - Shpërndarja e shërbimit për mbledhjen e mbeturinave në zonat rurale,
 - Ndërrimi i mënyrës së mbledhjes së mbeturinave.
- T** Kërcënimet:
- Ekzistenca e deponive ilegale,
 - Degradimi i mjedisit nga deponitë e derivateve të naftës,
 - Rreziqet nga deponitë e mbyllura të patrajtuara.


1.9.3 Furnizimi me energji elektrike

Komuna e Ferizajt furnizohet me energji elektrike nga Trafo-stacioni TS Prishtina 4, 220/110 kV, fuqie 2x150 MVA, përmes largpërçuesit LP 110kV të shënuar si 118/5, Al-Çe 3x150mm², -30.23- deri te TS 110/35kV, Ferizaj, të fuqisë (20+31.5) MVA, përmes së cilit bëhet shpërndarja për furnizimin e trafo-stacioneve TS 35/10(20)kV dhe atë:

- TS 35/10kV të shënuar si Ferizaj II, me fuqi (2x8)MVA;
- TS 35/10 (20)kV të shënuar si Ferizaj I, me fuqi (2x8)MVA dhe
- TS 35/10kV të shënuar si Ferizaj III, me fuqi (2x8)MVA;
- Nga zbarrat e TS 110kV Ferizaj, e përmes LP 110kV, nr.118/3, Al-Çe 3x150mm² – 28,66 furnizohet TS 110/6 kV Sharr, dhe nga këto zbarra TS110kV Ferizaj, përmes LP179/2 Al-Çe 3x150mm² – 39,4, furnizohet TS 110/35kV Theranda (2x31,5 MVA).

Kjo lidhje unazore i mundëson Komunës së Ferizajt dhe vetë qytetit furnizim me energji elektrike nga Rrafshi i Kosovës dhe Rrafshi i Dukagjinit. Ferizaj ka pozitë shumë të volitshme për faktin se përmes territorit të tij kalojnë LP të nivelit 400, 220 dhe 110 kV.

Fig. 11: Rrjeti elektrik i Kosovës



Burimi: KEK

Analizat SWOT për energjetikën

- S** Përparësitë:
- Mbulimi i tërë territorit me rrjet energjetik,
 - Pozita e mirë gjeografike dhe afërsia me burime termoenergjetike
 - Ekzistimi i pasurisë pyjore,
 - Ekzistimi i rrjetit energjetik rajonal.
- W** Dobësitë:
- Infrastruktura energjetike e vjetruar,
 - Mosshfrytëzimi i mundësive alternative,
 - Menaxhimi i dobët,
 - Format joadekuate të shfrytëzimit të energjisë elektrike.
- O** Mundësitë:
- Ndërtimi i sistemit të ngrohjes qendrore,
 - Ndërtimi i rrjetit nëntokësor elektro-energjetik,
 - Privatizimi,
 - Organizimi i partneriteteve publike-private.
- T** Kërcënimet:
- Stagnimi i zhvillimit,
 - Degradimi i mjedisit dhe i cilësisë së jetës.



1.9.4 Telekomunikacioni

Shërbimet e telekomunikacionit në Ferizaj i ofron PTK-ja.

Analizat SWOT për telekomunikacionin

S Përparësitë:

- Kalimi i fibrit optik nëpër territor të komunës,
- Teknologjia e avancuar,
- Pozita strategjike e (volitshme) komunës.

W Dobësitë:

- Rrjeti i pavolitshëm i zyrave postare,
- Rrjeti i zgjatur telekomunikues,
- Përfshirja e pamjaftueshme e tërë territorit me rrjet të telefonisë,
- Rrjeti kabllor i vjetruar,
- Nuk ka shërbime në brezin e gjerë.

O Mundësitë:

- Vendosja e centraleve periferike,
- Ofrimi i shërbimeve të brezit të gjerë dhe cilësor.

T Kërcënimet:

- Monopoli në shërbime,
- Mungesa e kadastrës nëntokësore,
- Zhvillimi i paplanifikuar.



PLANI 4: SITUACIONI: SITUACIONI – ELEKTRIKA





PLANI 5: SITUATA – UJËSJELLËSI



PLANI 6: SITUACIONI – KANALIZIMI



1.10 INFRASTRUKTURA SOCIALE

1.10.1 Arsimi

Detyrat institucionale

Roli i komunave në sistemin edukativ është përgatitja dhe mirëmbajtja e infrastrukturës arsimore, e përbërë, përveç tjerash, nga objektet dhe pajisjet e tjera për shkollë, transporti dhe stafi arsimor. Drejtoria Komunale e Arsimit është përgjegjëse për ushtrimin e të gjitha detyrave dhe përgjegjësi komonale për arsimin. Nga janari 2002, të gjitha komunat marrin përgjegjësitë për shpenzimet në këtë veprimtari, duke përfshirë mbështetjen e stafit administrativ, mallrat dhe shërbimet, riparimet dhe mirëmbajtjen. Të ardhurat mujore të stafit mësimor ende janë nën përgjegjësinë e Qeverisë së Kosovës.


Deri në fund të vitit 2002 të gjitha objektet e shkollave fillore dhe të mesme në Kosovë janë transferuar në pronësinë e komunave. Komunat tani janë përgjegjëse për riparimin dhe mirëmbajtjen e objekteve shkollore.

Shtrirja e rrjetit të objekteve të shkollave fillore në Komunën e Ferizajt është e mirë, mirëpo qyteti ka numër të pamjaftueshëm të objekteve shkollore. Këtu duhet të theksohet se, për shkak të depopullimit, disa shkolla nuk kanë nxënës të mjaftueshëm.

Në komunë pothuajse nuk ka fare objekte të arsimit të mesëm, ndërsa në qytet është një mungesë e madhe e tyre. Gjendja e objekteve shkollore si në qytet, ashtu edhe në komunë nuk është e mirë, përveç disa objekteve shkollore që janë ndërtuar dhe riparuar falë donacioneve dhe financimit nga ane komunës.



Fig. 12: Sistemi arsimor në Kosovë



**ARSIMI FILLOR**

Shkollat fillore në qytet nuk i përmbushin as përfaqësimet nevojat elementare të arsimit si sa i përket numrit të tyre, lokacioneve numrit të klasave dhe sipërfaqes së nevojshme për një nxënës, e të mos flasim për kthinat e tjera përcjellëse të domosdoshme për mbarëvajtjen e mësimit. Shkollat ekzistuese, gjithashtu, ndodhen në gjendje mjaft të dobët fizike. Në këto shkolla punohet në 3, 4 dhe në mes-ndërrime. Në disa shkolla mjetet e konkretizimit mungojnë pjesërisht, e në disa të tjera tërësisht. Mungojnë kabinetet e informatikës dhe kabinetet e mjetet e tjera për mësim-nxënien cilësore. Për një nxënës në shkollat e Ferizajt shfrytëzohen 1,8m² sipërfaqe shkollore, përderisa me standard parashihet një sipërfaqe 3-4m²/nxënës.

Tab. 5: Tabela e shërbimeve arsimore fillore dhe parashkollore

Nr.	Vendi	Emri i shkollës	Numri i nxënësve	Personeli	Sipërfaqja e objektit në m ²	m ² /nxënës
1	Ferizaj (qyteti)	Ardhmëria jonë	260	38	3344	1,30
	Gjithsej parashkollor		260	38	1344	5,17
1	Ferizaj (qyteti)	Gjon Sereçi	3986	184	8550	2,15
2	-----	Tefik Çanga	1987	102	1564	0,79
3	-----	Ahmet Hoxha	2022	88	3763,28	1,86
4	-----	Jeronim De Rada	1307	66	2728	2,09
5	-----	G. Tërbeshi	1006	52	1944	1,93
	Gjithsej në Ferizaj		10308	492	18549,28	1,80
	Gjithsej në komunë		23009	1243	45047,28	1,96

Burimi: Kuvendi i Komunës - Ferizaj


Tab. 6: Mesatarja e nxënësve në klasë në arsimin e obligueshëm, në klasat 1-9, viti shkollor 2005-06

Numri i shkollave	Numri i nxënësve	M ² /nxënës
6	10 308	1,8

Burimi:DKA (2005)



Fig. 13: Raporti i arsimit fillor të qytetit me pjesën rurale



ARSIMI PARASHKOLLOR

Në nivelin komunal vetëm dy objekte shkollore iu dedikohen fëmijëve parashkollorë: Çerdhja e fëmijëve "Ardhmëria jonë" dhe Çerdhja e fëmijëve në Lagjen e Re. Në objektin e Çerdhes së fëmijëve "Ardhmëria jonë" procesin edukativ-arsimor e ndjek vetëm një grup i fëmijëve parashkollorë, sepse në të janë të sistemuar edhe grupmosha të tjera të fëmijëve, 12 sish, ndërsa në Çerdhen e fëmijëve në Lagjen e Re veprojnë vetëm 8 grupe të fëmijëve në dy ndërtesa, sepse në të mësimet i zhvillojnë edhe nxënësit e Shkollës së mesme të muzikës "Ç.Zadeja".

Çerdhja e fëmijëve "Ardhmëria jonë" i ka 13 dhoma mësimi dhe sipërfaqe prej 1.344m², ndërsa Çerdhja e fëmijëve në Lagjen e Re i ka 9 dhoma mësimi.

ARSIMI I MESËM

Edhe për këtë nivel shkollor ndihet mungesa e hapësirave shkollore, si dhe e një shpërndarjeje më të mirë hapësinore. Ky nivel disponon me 14.943 m²

- Shkolla e mesme ekonomike, hapur në vitin 1956;
- Shkolla e mesme normale, hapur në vitin 1960;
- Shkolla e mesme gjimnazi, hapur në vitin 1963;
- Shkolla e mesme e bujqësisë, hapur në vitin 1990;
- Shkolla e mesme e mjekësisë "Elena Gjika", hapur në viti shkollor 1992/93; dhe
- Shkolla e mesme e muzikës "Çesk Zadeja", hapur në vitin 2000.

Në vitin shkollor 2004-2005 klasën e 9-të të arsimit të mesëm të ulët e përfunduan 1994 nxënës. Prej tyre klasën e 10-të e regjistruan 1925 nxënës, shifër kjo që flet për motivimin e dobët të nxënësve për shkollim të mëtutjeshëm.



Tab. 7: Tabela e shërbimeve arsimore fillore dhe parashkollore

Nr.	Emri i shkollës	Numri i nxënësve	Personeli	Sipërfaqja e objektit	m2/nxënës
1	Kuvendi i Arbërit	1915	93	3850	2.010443864
2	Faik Konica	1594	72	2024	1.269761606
3	Pjetër Bogdani	1019	68	3715	3.645731109
4	Elena Gjika	615	33	800	1.300813008
5	Zenel Hajdini	1235	78	3704	2.999190283
6	Çesk Zadeja	71	24	850	11.97183099
Gjithsej		6449	368	14943	2.317103427

ARSIMI I LARTË

Në Ferizaj, në vitin shkollor 1975/76, hapet Shkolla e Lartë Teknike me disa degë. Kjo shkollë vepron deri në vitin 2004/05. Në këtë vit ajo shndërrohet në degë të Fakultetit Teknik të Makinerisë.

Analizat SWOT për arsimin

S

Përparësitë:

- Arsimi gjithëpërfshirës,
- Arsimi privat,
- Aplikimi i reformave,
- Numri i madh i nxënësve,
- Trajnimi i kuadrit arsimor,
- Numri i madh i profileve (shkollat e mesme),
- Ekzistimi i këshillave të prindërve,
- Ligji mbi arsimin.

W

Dobësitë:

- Hapësira e pamjaftueshme në shkolla,
- Infrastruktura teknike e dobët,
- Kuadri arsimor joadekuat,
- Stimulimi i dobët i arsimit,
- Mungesa e buxhetit,
- Shtrirja e pavolitshme hapësinore e shkollave,
- Zbatimi i teorive në praktikë,
- Kapaciteti i vogël i arsimit parashkollor,
- Orari i shkurtër i enteve parashkollore.

O

Mundësitë:

- Mbrojtja dhe sigurimi i lokacioneve për shkollë,
- Trajnimi i kuadrit arsimor,
- Mundësia e financimit përmes pjesëmarrjes,
- Riaktivizimi i bibliotekës në shkolla,
- Kthimi i pedagogëve nëpër shkolla.

T

Kërcënimet:



- Mospërfshirja e të gjithë nxënësve nëpër shkolla,
- Prezenca e dukurive negative nëpër shkolla.

1.10.2 Sistemi për përkujdesje shëndetësore

Detyrat institucionale

Rregulloret e përgjithshme të përkujdesjes shëndetësore në Kosovë janë përgjegjësi e Ministrisë së Shëndetësisë, ndërkaq në nivelin komunal përgjegjëse për to është Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Sa i përket sigurimit të shërbimeve dhe pajisjeve të programuara nga shteti dhe zyrtarët komunalë, kërkesat që kanë të bëjnë me nevojën e hapësirës dhe përzgjedhja e lokacioneve duhet të koordinohen me Drejtorinë për Planifikim dhe Urbanizim, në bazë të dispozitave të Planit Zhvillimor.

Problemet Ekzistuese

Spektori i shëndetësisë në Kosovë ka pësuar shkatërrimin fizik jo vetëm nga konfliktet e dhunshme, por edhe nga mosinvestimet afatgjate në zhvillimin e stafit dhe në mirëmbajtjen e infrastrukturës fizike dhe të pajisjeve.

Aktualisht, çdo komunë ka një qendër të shëndetësisë familjare (QSHF apo shtëpi shëndeti) për të mbikëqyrur rrjetin e ambulancave dhe barnatoreve (pajisjet primare të përkujdesjes shëndetësore dhe shërbimet në fshatra).

Megjithatë, mundësitë diagnostikuese të secilës qendër janë të kufizuara dhe shumë raste referohen nëpër spitale. Infrastruktura fizike e përkujdesjes shëndetësore në Kosovë, edhe pse nuk ka pësuar nga lufta, ka shumë nevojë për rinovim.

Çështja e dytë brengosëse në strategjinë për rehabilitimin e sektorit të shëndetësisë është mungesa e personelit të kualifikuar shëndetësor në kuadër të sistemit publik.

Në dhjetë vitet e fundit, profesionistët shëndetësorë kanë pasur mundësi të vogla për përtëritjen e njohurive apo për avancimet në teknologjinë mjekësore dhe në punët praktike.

Struktura e sistemit shëndetësor

Sistemi i reformuar shëndetësor në Kosovë është projektuar të bazohet në "praktikën familjare", me qasje në mjekë, në motra mjekësore dhe në ekspertë të tjerë shëndetësorë që punojnë si grup.


- Përkujdesja primare shëndetësore: Pajisje primare për përkujdesje shëndetësore janë ambulanca dhe punktet më të vogla të përfshira në këtë model të përkujdesjes shëndetësore.
- Përkujdesja sekondare shëndetësore: Si spitale të përgjithshme korrespondojnë në nivelin sekondar të përkujdesjes shëndetësore, përfshirë Spitalin Universitar të Prishtinës.
- Përkujdesja terciare shëndetësore: Spitali Universitar i Prishtinës është spitali i vetëm, i cili siguron përkujdesje terciare shëndetësore.

Institucionet e sistemit shëndetësorë

Në Ferizaj janë këto institucione shëndetësore:

- QKMF, Qendra 1 e Mjekësisë Familjare dhe Qendra 2 e Mjekësisë Familjare, ka gjithsej 322 punëtorë, prej të cilëve 30 janë mjekë familjarë, 11 stomatologë, 28 mjekë të tjerë, stafi i administratës 65 veta, stafi ndihmës 188. Prej tyre 211 janë të gjinisë femërore dhe 111 të asaj mashkullore.
- Spitali, me repartet e Kirurgjisë, Gjinekologjisë, Emergjencës, Pediatriisë dhe Interno. Spitali ka të punësuar 229 punëtorë, prej të cilëve mjekë specialistë janë 22. Prej tyre, 160 janë femra dhe 69 meshkuj. Spitali ka 73 shtretër dhe sipërfaqe prej 3.400 m².
- Qendra e Shëndetit Mendor ka të punësuar 24 punëtorë, 9 femra e 15 meshkuj. Këtu gjejnë qëndrim ditor 50 pacientë dhe objekti ka 870 m².
- Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike ka të punësuar 23 punëtorë, prej të cilëve 13 femra dhe 10 meshkuj. Objekti ka një sipërfaqe prej 400 m².

Fig. 14: Raporti në mes të qytetit dhe pjesës rurale





Analizat SWOT për kujdesin shëndetësorë

S

Përparësitë:

- Kuadri i mjaftueshëm mjekësor,
- Nuk ka sëmundje epidemike,
- Mjekësia familjare,
- Spitali rajonal,
- Instituti kombëtarë publik,
- Dispanseri antiturbekular,
- Ekzistimi i ordinancave private.

W

Dobësitë:

- Mossigurimi shëndetësor,
- Buxheti i pamjaftueshëm,
- Hapësira e pamjaftueshme,
- Mungesa e reparteve,
- Mungesa e pajisjeve teknike,
- Shërbimet emergjente.

O

Mundësitë:

- Trajnimi i vazhdueshëm profesional,
- Sigurimi shëndetësor,
- Riimplementimi i Mjekësisë Familjare,
- Specializimi i kuadrit,
- Hapja e ambulancave të reja.

T

Kërcënimet:

- Rritja e sëmundjeve transmissive,
- Rritja e sëmundjes së varësisë,
- Largimi i kuadrit profesional nga instituti – komuna.

Q

Qëllimet:

- Ndërtimi i objekteve shëndetësore në harmoni me shtrirjen e popullatës,
- Ndërtimi i qendrës së katërt të MF në qytet,
- Ngritja (mbindërtimi) i objekteve Qendra II,
- Implementimi i standardeve të Mjekësisë Familjare.



PLANI 7: SITUACIONI – INFRASTRUKTURA SOCIALE





1.11 TRASHËGIMIA KULTURORE DHE NATYRORE

1.11.1 Trashëgimia Kulturore

Detyrat institucionale

Mbrojtja e monumenteve historike në Kosovë është përgjegjësi e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Detyra lidhur me identifikimin, dokumentimin, shqyrtimin, arkivimin dhe kujdesin për mbrojtjen e monumenteve historike në Kosovë i është besuar Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës (IMMK) në Prishtinë. Puna e Institutit është penguar nga fakti që i gjithë dokumentacioni që ka pasur para luftës është transferuar në Beograd, ku edhe gjendet momentalisht.

Baza ligjore

Deri në vitin 1949 në Kosovë, si pjesë e ish Jugosllavisë, ishin identifikuar dhe klasifikuar ndërtesat me vlera historike si monumente historike. Gjithsej 426 objekte në Kosovë janë mbrojtur sipas Ligjit ende të aplikueshëm të Kosovës mbi Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore, të vitit 1977³. Në vitin 1992 dhe 1996 ishin miratuar ligje të reja në Serbi, por të cilat nuk janë pranuar dhe shpallur në Kosovë. Kështu, ligji i vitit 1977 është ende në fuqi. Pas vitit 1968, megjithatë, asnjë ndërtesë më shumë nuk është atribuuar për mbrojtje formale me ligj në Kosovë. Ka pasur vetëm sugjerime të objekteve relevante, të cilat janë rreshtuar përkohësisht. Për shkak të kushteve politike para luftës, është e dyshimtë nëse zgjedhja e objekteve që duhej të mbroheshin ishte bërë duke u nisur nga rëndësia shkencore e tyre. Preferencat kulturore dhe vlerësimet nga pikëpamja e kulturës mbizotëruese do t'i kenë influencuar funksionet. Në të ardhmen është e nevojshme të sigurohet një qasje e arsyeshme dhe e drejtë, në mënyrë që të mënjanohen prirjet e tilla të përzgjedhjes dhe të ruhen të gjitha llojet e jetës kulturore dhe shenjat e historisë lokale, të cilat e përbëjnë kulturën specifike të Kosovës, e gjithashtu, edhe të Ferizajt.

Rëndësia e mbrojtjes së monumenteve historike për zhvillimin e komunës
Nuk është vetëm prosperiteti ekonomik ai që qytetin e bën tërheqës dhe modern, por edhe bukuria e peizazhit të tij, e peizazhit përreth, llojllojshmëria e tij kulturore, rrënja dhe "shpirti" i lokacionit, si dhe tipari i tij i veçantë (i paraqitur së paku jo vetëm nga ndërtesat e tij historike). Në këtë aspekt, vetëdija e historisë lokale, shkon larg, përtej kohës së mesjetës, te origjina romane, ilirike, e madje parahistorike. Kështu, brenda një strategjie gjithëpërfshirëse për zhvillimin e komunës, ruajtja e vendqëndrimit të

³ "Zakon o zaštiti spomenika culture"; Kosovo Law nr. 19/77. in: Zbirka Zakona: 1977



ndërtesave historike është më shumë se një çështje thjesht kulturore, dhe ka kontributin e vet, gjithashtu, në faktorët e rëndësishëm të zhvillimit brenda një shoqërie moderne. "Trashëgimia kulturore dhe natyrore siguron ndjenjën e identitetit dhe ndihmon dallimin e komuniteteve në atmosferën e globalizimit" (MESP 2005, 14). Rëndësia e mbrojtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore në Kosovë është e nënvizuar me notifikimin e saj në dokumentin zyrtar "Standardet për Kosovën", të cilat duhet të arrihen: "Trashëgimia kulturore e Kosovës është respektuar si pronë e përbashkët e të gjitha etnive, rajoneve dhe komuniteteve gjuhësore të Kosovës."⁴. Ky qëllim duhet të realizohet sipas standardeve të BE-së.



Fig. 15: Një fushatë nga Ministria e Kulturës ka për qëllim ngritjen e vetëdijesimit të publikut për trashëgiminë kulturore.

Ferizaj e ka një histori të rritjes së shpejtë, të ndikuar nga përparësia që ka hekurudha. Ai nuk ka shumë ndërtesa historike, së paku jo të tilla që kapërcejnë rëndësinë lokale. Ende ekzistojnë disa ndërtesa historike, të cilat kanë mbijetuar rrjedhën e kohës, periudhat e vlerësimit të lartë të këtyre ndërtesave, si dhe periudhat e neglizhencës dhe të shkatërrimit të tyre. Edhe pse qyteti i Ferizajt nuk daton larg në shekuj, ato ndërtesa janë shenja kulturore vendore dhe rajonale, të cilat janë zhvilluar në kushte të veçanta historike, socio-ekonomike, etnike dhe religjioze. Asgjë nuk është ndërtuar përjetësisht, megjithatë duhet të pranohen edhe substancat me të vogla historike.

Për Planin e Zhvillimit, mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore duhet të përcaktohet nëpërmjet veprimeve konkrete dhe duhet të definohet si të garantohet menaxhimi i duhur. Prioritet duhet të jetë strategjia e ngritjes së vlerave të objekteve të ndryshme, si dhe shfrytëzimi i tyre, p.sh.:

⁴ Standard 6 in "Plani implementues i Kosovës për standarde", mars 2004, Kosovë (MESP 2005, 14)



- Zgjerimin e mundësive lokale për shfrytëzimin e kohës së lirë,
- Prezantimi i atraksioneve për turizëm,
- Rritja e mirëkuptimit të ndërsjellë të komuniteteve të ndryshme,
- Tërheqja e investitorëve, sigurimi i punës etj.
(MMPH 2005, 15).

Gjendja ekzistuese e ndërtesave historike dhe mjedisi urban në Ferizaj, të llogaritura si trashëgimi kulturore

Vlerësimi i objekteve historike mund të ndryshojë gjatë kohëve. Edhe ndërtesat religjioze ose ato me origjinë qeveritare, të cilat kanë qenë të planifikuara dhe të dekoruara në mënyrë më të veçantë, sot duhet parë si trashëgimi kulturore. Shenja të traditës kulturore të teknologjisë së ndërtimit të mëparshëm janë, gjithashtu, edhe arkitektura autoktone dhe ndërtesat mëdha industriale. Prandaj është me interes të definohet dhe të shqyrtohet në mënyrë sa më thelbësore se cilat mund të konsiderohen objekte të trashëgimisë kulturore në Ferizaj.

Me qëllim që të freskohet dhe të kompletohet lista e monumenteve historike, në periudhën 2002-2004, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore ka punuar në një inventarizim, duke i grumbulluar të dhënat mbi objektet me rëndësi kulturore në Kosovë, i cili mund të jetë një burim tjetër i informatave mbi ndërtesat që do të radhiten në trashëgiminë kulturore të vendit. Për më tepër, ekzistojnë ndërtesa dhe vendqëndrime ose grupe ndërtesash, të cilat ende nuk janë përfshirë në asnjë listë, por që për nga vlera kulturore dhe historike tanimë janë të përcaktuara si ndërtesa historike që kërkojnë një përkujdesje të veçantë.

Tab. 8 Inventarizimi i trashëgimisë kulturore të objekteve në territorin e Ferizajt

Nr	Komuna dhe vendi	Objekti	Periudha, shekull, viti
	Ferizaj	Kisha e Shën Uroshit	
	Ferizaj	Faltorja e varrezave ortodokse	
750	Ferizaj	Biblioteka e qytetit	1908
747	Ferizaj	Kisha Engjëlli i Rojës	1929
701	Ferizaj	Xhamia e Madhe	Shekull
702	Ferizaj	Xhamia e Boshnjakëve	Shekull XIX

Burimet: Inventarizimi i trashëgimisë kulturore të objekteve në territorin e Kosovës (02); IKMMK 2006

Struktura e vendbanime historike në qendrën urbane të Ferizajt

Qendra e Ferizajt është e shtrirë përreth linjës hekurudhore. Ajo është zemra e qytetit. Në qendër gjenden ndërtesat më të rëndësishme historike. Ansambli i kishës Shën Uroshi dhe Xhamia e Madhe janë shenja të bashkëjetesës kulturore, që kanë koekzistuar me shekuj.



Fig. 16: Biblioteka e qytetit



Fig. 17: Kisha e Shën Uroshit Xhamia e madhe në qendër të qytetit

Ndërtesat moderne me arkitekturë të shkëlqyeshme

Në dekadat e fundit janë ndërtuar objekte me arkitekturë të shkëlqyeshme. Ato janë dëshmi të mirëkuptimit të përbashkët të arkitekturës dhe në harmoni me kohën. Me rëndësi është që këto objekte të ndërtuara luajnë funksionin e tyre dhe kontribuojnë për një ekonomi të qëndrueshme në qytetin e Ferizajt.

Objektet Kulturore

Në Ferizaj ekzistojnë këto objekte kulturore:

- Shtëpia e Kulturës "Hivzi Sulejmani",
- Teatri i Qytetit "Ardiana Abdullahu",
- Biblioteka Publike,
- Biblioteka në Talinoc të Muhaxhirëve,
- Biblioteka në Nerodime,
- Biblioteka në Komogllavë
- Biblioteka në Dardani,
- Galeria e Arteve,
- Muzeu Etnografik,
- Arkivi Historik.



Qyteti i Ferizajt ka traditë në aktivitete kulturore. Aktivitetet e tilla kanë filluar gjatë Luftës së Dytë Botërore, me ardhjen e mësuesve të parë nga Shqipëria, kur edhe u zbuluan aktorët e parë që bënë emër, si: Katarina Josipi, Shaban Gashi, Matej Sereçi, Shemsi Zherka, Ismail Rama, Ardiana Abdullahu etj.

Në vitin 1970 është themeluar Ansambli i Këngëve dhe Valleve "Kastriotët", njëri ndër ansamblet më të njohura në hapësirat mbarëkombëtare.

Në këtë qytet ekziston një traditë e rok-ut, e cila filloi me "AVI Trix", Rok "Gjinisë", "7 me 7", "Kthjellu". Grupi "Kthjellu", së fundi, fitoi shumë shpërblime dhe mori pjesë në Festivalin e MTV - EXIT në Vlorë, ku përfaqësoi Kosovën.

Prej vitit 1970 në Ferizaj mbahen dy festivale "Kosovarja Këndon" dhe Festivali i teatrove. Në këto festivale janë zbuluar shumë talente të muzikës dhe të teatrit. Përveç tyre, këtu mbahen edhe festivalet: "Fëmijët e gëzuar", që mbahet çdo vit duke filluar nga viti 1986. Prej vitit 2001 mbahet "Java e kulturës", ndërsa prej vitit 2003 "Muaji i Kulturës", si dhe manifestimi tradicional "Nikë Prela". Prej vitit 2005, në Ferizaj mbahet edhe Festivali i rokut, i quajtur "Ferfest".

Objektet Sportive

Në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport janë të regjistruara 33 klube sportive, të cilat veprimtaritë e tyre i zhvillojnë në këto objekte sportive:

Pallati i Sportit "Bill Klinton" me terrenet sportive,

Stadiumi i Qytetit "Ismet Shabani",

Fushat e futbollit në fshatrat Tërë e Varosh.

Analizat SWOT për trashëgiminë kulturore

S Përparësitë:

- Ekzistimi i ligjit për trashëgimi kulturore,
- Prania e objekteve dhe rrënojave historike.

W Dobësitë:

- Mosekzistimi i entit për mbrojtje të objekteve të kulturës,
- Vetëdija e ulët e popullsisë.

O Mundësitë:

- Ngritja e vetëdijes së popullsisë.

T Kërcënimet:

- Humbja e objekteve të vlefshme të trashëgimisë.
-
-



1.12 Trashëgimia natyrore

Mbrojtja e objekteve dhe e zonave të trashëgimisë natyrore është obligim i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH-së).

Për Ferizajn një pasuri e veçantë është bifurkacioni, si fenomen i rrallë natyror, i dyti në botë, ku lumi, nga një burim në Nerodime, rrjedh dy drejtimeve, ndahet në dy lumenj dhe derdhet në dy dete.

Analizat SWOT për trashëgiminë natyrore në qytetin e Ferizajt

S Përparësitë:

- Bashkimi i dy lumenjve,
- Zona e bifurkacionit si zonë e posaçme,
- Ekzistimi i lokacioneve arkeologjike.

W Dobësitë:

- Mungesa e entit për mbrojtjen e monumenteve natyrore,
- Mosshpallja të mbrojtura e këtyre lokacioneve.

O Mundësitë:

- Krijimi i një institucioni për mbrojtjen e tyre,
- Hulumtimet e reja.

T Kërcënimet:

- Degradimi i tyre, nëse nuk arrihet diç nga organet kompetente.
-

1.13 KATASTROFAT NATYRORE DHE TË SHKAKTUARA

Territori i Komunës së Ferizajt vazhdimisht është ballafaquar me fatkeqësi natyrore dhe me aksidente të ndryshme, të cilat në masë të madhe kanë shkaktuar dëme materiale në pjesën urbane dhe në atë rurale. Shpeshherë nga fatkeqësitë aksidentale, pos dëmeve materiale kemi edhe humbjen e jetës së njerëzve. Kështu, Drejtoria e MC dhe e Emergjencës ka përgjegjësi për menaxhimin e emergjencave, siç janë :

- Zjarret,
- Vërshimet,
- Përmbytjet,
- Eksplozimet,
- Aksidentet në komunikacion,
- Aksidentet nga mbeturinat e luftës,
- Tërmetet si dhe fatkeqësitë e tjera.



Zjarret

Në territorin e komunës zjarret kanë qenë dhe janë gjithnjë prezente, si në sektorin shoqëror, ashtu edhe në atë privat.

Sipas vlerësimeve të bëra, shkaktarët kryesorë të zjarreve janë: energjia elektrike dhe pakujdesia e faktorit njeri.

Kompetente për intervenime në shuarjen e zjarrit, pranë Drejtorisë së MC dhe Emergjencës, është Brigada Zjarrfikëse dhe e Shpëtimit, e cila me mjaft sukses ka kryer intervenimet në shuarjen e tyre. Gjatë vitit 2005 kjo brigadë ka pasur gjithsej 276 intervenime për shuarjen e zjarreve dhe intervenime në aksidente të ndryshme.

Rrënimet

Në komunën e Ferizajt, rrënimet ka pasur gjatë kohës së luftës së fundit dhe gjatë trazirave të marsit 2004.

Në kohën e fundit ka objekte të cilave u kanoset rreziku i rrënimëve nga vërshimet, sepse janë të ndërtuara me material të dobët, janë të vjetruara dhe janë të ndërtuara pranë rrjedhës së lumenjve.

Eksplodimet

Megjenëse në Komunën e Ferizajt ekziston një numër i madh i objekteve industriale, shpërndarës të karburanteve (pompave të benzinës), si dhe shpërndarës të gazrave të butonit, për shkak të menaxhimit joadekuat ekziston rreziku i shpërthimit të tyre. Eksplodimet mund të shkaktojnë pasoja të mëdha në njerëz dhe në mjete materiale. Vlen të theksohet se eksplodimet tilla ka pasur, madje edhe me dëme të mëdha materiale, por fatmirësisht pa viktima në njerëz.

Aksidentet në komunikacion

Në territorin e Komunës së Ferizajt janë prezente aksidentet në komunikacion, kryesisht për shkak të komunikacionit të dendur dhe të gjendjes jo të mirë të rrugëve. Nga këto shkaqe shpesh po ndodhin aksidente me pasoja të mëdha në humbjen e jetëve të njerëzve dhe me dëme të mëdha materiale.

Përmes qytetit të Ferizajt kalon hekurudha, ku nga pakujdesia dhe për mungesë të mbikalimeve për udhëtarë, shpesh ndodhin edhe aksidente të cilat mbarojnë me viktima në njerëz dhe me dëme materiale.

Tërmetet

Dridhje të tokës, tërmete me intensitet të lartë nuk ka pasur. Këtu ka pasur vetëm lëkundje nga dridhjet e tokës në Shkup dhe në Gjilan, por pa pasoja në njerëz dhe pa dëme materiale, vetëm me shqetësime dhe panik.

Dukuritë e tjera që shpesh ndodhin në territorin e Komunës së Ferizajt janë:

Rrëshqitja e dheut, akullnajat, ortekët e borës, breshëri, si dhe dukuri të tjera, që shkaktojnë dëme në pasuri bujqësore dhe në infrastrukturë.

Fig. 18: Harta e zonave maksimalisht të rrezikuara nga tërmetet në Kosovë



Burimi: Plani Hapësinor i Kosovës

Analizat SWOT për katastrofat natyrore

- S** Përparësitë:
- Nuk ka zona të rrezikuara nga erozioni dhe tërmeti.
- W** Dobësitë:
- Mungesa e infrastrukturës ligjore,
 - Mosqasja e zjarrfikësve në zona të caktuara,
 - Mosmirëmbajtja e shtretërve të lumenjve.
- O** Mundësitë:
- Organizimi më i mirë i organeve kompetente në mbylljen e pikave të karburanteve,
 - Hapja e kanaleve dhe mirëmbajtja e tyre.

**Kërcënimet:**

- Zhvillimi i pakontrolluar i pikave të karburanteve në vendbanime,
- Krijimi i zonave moçalore.

1.14 SFIDAT E IDENTIFIKUARA ZHVILLIMORE**Zhvillimi i paplanifikuar dhe shkalla e lartë e papunësisë**

- I tërë zhvillimi në komunë është bërë pa planifikim institucional, është bërë dyfishimi i kapaciteteve dhe nuk janë shfrytëzuar resurset lokale dhe potencialet për zhvillim të qëndrueshëm të bujqësisë.
- Gjatë planifikimit duhet të përcaktohen mënyrat për institucionalizimin (vënien nën kontroll) e këtij zhvillimi dhe të planifikohet zhvillimi i ardhshëm, duke u bazuar në potencialet lokale.

Shfrytëzimi ioracional i hapësirës

- shumica e ndërtimeve janë bërë në tokë bujqësore (humbje e pakthyeshme e tokës bujqësore) dhe përgjatë korridorit të rrugëve (pamundësi e zgjerimit të rrugëve ekzistuese).
- si mund t'i ndalojmë këto ndërtime dhe si të veprojmë me ato ekzistuese?

Mjedisi

- mjedisi jetësor në zonën urbane dhe atë rurale është i cilësisë së dobët (shërbime të pamjaftueshme për mbledhjen e mbeturinave dhe mostrajtimi i ujërave te zeza).
- gjatë planifikimit duhet të përcaktohen mënyrat se si t'i përparojmë këto shërbime që ta shtojmë cilësinë e mjedisit jetësor.

Infrastruktura e dobët teknike

- infrastruktura teknike, në përgjithësi, si në zonën urbane, ashtu edhe në atë rurale është e dobët si në aspektin kualitativ, ashtu edhe në atë kuantitativ.
- duhet përshtatur korridoreve ekzistuese dhe zhvillimeve aktuale dhe t'i planifikojmë korridoret e reja në harmoni me nevojat për zhvillimin e ardhshëm.

Trashëgimia natyrore

- trashëgimia natyrore është në shkatërrim e sipër (zona e bifurkacionit, pellgu i lumit Nerodime, prerja e pakontrolluar e pyjeve).
- gjatë planifikimit duhet të kemi parasysh shfrytëzimin e këtyre vlerave dhe mbrojtjen e tyre për brezat e ardhshëm.

Niveli i ulët i shërbimeve shëndetësore dhe sociale



- shërbimet shëndetësore dhe sociale, në përgjithësi, janë jo të kënaqshme në zonën urbane e sidomos në atë rurale.
- Këto shërbime duhet t'i përmirësojmë, që të jenë më afër banorëve.

Standardet, normat dhe parimet


- pjesa dërmuese e zhvillimeve janë bërë jashtë standardeve, normave dhe parimeve të aplikueshme, të cilat janë obliguese edhe për ne.
- Duhet planifikuar zhvillimin për të ardhmen, në mënyrë që të arrihen standardet ndërkombëtare, transparenca, si dhe pjesëmarrja në vendimmarrje.

1.15 VLERËSIMI I KAPACITETEVE INVESTUESE

Kapacitetet investuese janë potencial i financimit të projekteve ekonomike etj., që ndikojnë në vlerësimet brenda projekteve të natyrës zhvillimore. Në këtë grup bëjnë pjesë edhe investimet për projekte kapitale publike dhe private.

Në rrethanat aktuale në Kosovë, duke pasur parasysh mundësitë e kufizuara financiare, rëndësi të veçantë ka vlerësimi i kapaciteteve investuese publike (sektorët dhe burimet).

Fig. 19: Struktura e burimeve të investimeve në tërë Kosovën



Burimi: Plani Hapësinor i Kosovës (Vlerësimet e Institutit Riinvest)

Nga grafiku mund të shihet se sektori privat dominon me rreth 70%, ndërsa buxheti me rreth 25% të investimeve të gjithmbarshme.

Kapacitetet investuese ndahen në ato ekzistuese dhe të mundshme.

1. Kapacitetet ekzistuese përfshijnë:

- Buxhetin komunal,
- Sektorin privat,
- Sektorin publik,
- Burimet natyrore,
- Kapacitetet e infrastrukturës fizike (ndërtesat),
- Potenciali njerëzor (rinia).

2. Ndërsa kapacitet e mundshme përfshijnë:

- investimet e mundshme të qeverisë,
- Investimet private nga jashtë,
- Fondet ndërkombëtare,
- Pakti i Stabilitetit,
- BE dhe donacionet e tjera,
- Kreditë dhe dhëniet (grandet),



Komuniteti i biznesit

Komuniteti i biznesit përbëhet nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, ekonomitë familjare kryesisht në lëmin e tregtisë, hotelerisë, zejtarisë, bujqësisë, ndërtimtarisë dhe të zejeve të tjera. Numri i bizneseve të vogla dhe të mesme të regjistruara në MTI arrin në 4.500, prej tyre aktive janë 3.427, që punësojnë 2 - 3 punëtorë.

Struktura e bizneseve është si vijon:

- Biznese prodhuese 11 %
- Biznese tregtare 45 %
- Biznese shërbyese 44 %

Një numër i konsiderueshëm i këtyre bizneseve, që në fillim të punës, përballen me mungesën e mjeteve qarkulluese, për çka detyrohen ta ndërprejnë veprimtarinë. Gjithashtu, edhe politika fiskale, edhe ajo kreditore, nuk janë në funksion të stimulimit të tyre.

Struktura e këtyre bizneseve nuk është e volitshme, ngase vetëm 11 % të tyre janë biznese prodhuese. Për ta mbështetur zhvillimin e komunitetit të biznesit dhe për krijimin e kushteve të qëndrueshme, Kuvendi i Komunës ka përcaktuar zonat industriale në Babush dhe në Komogllavë. Me këtë u mundësua rritja e kapaciteteve prodhuese dhe hapja e vendeve të reja të punës. Në zonën industriale në Babush janë vendosur 13 kompani prodhuese dhe janë punësuar 160 punëtorë. Njëherësh, Kuvendi i Komunës ka liruar nga pagesa për taksa komunale, tarifa dhe mallra të tjera 276 biznese prodhuese.

Ndërmarrjet shoqërore të privatizuara me njëri nga metodat e njohura të privatizimit, janë një potencial i çmueshëm për ngritjen e kapaciteteve Investuese, të punësimit, të përmirësimit të infrastrukturës urbane dhe të mirëqenies në përgjithësi, sidomos nga ndërmarrjet që kanë qenë gjigantë të vërtetë, si KD "Tefik Çanga", Fabrika e Tubave Spirale, Fabrika e Vajit Ushqimor, Ndërtimtaria, Fabrika e Veglave dhe Aparateve Elektrike, Eurometali etj. Edhe në të ardhmen mund të pritët kontribut i konsiderueshëm në punësim dhe zhvillim ekonomik. Përveç këtyre, Ferizaj ka traditë edhe në degët e tjera të ekonomisë, si:

- bujqësi,
- tregti,
- komunikacion (transporti) dhe
- turizëm.



Në Master Planin për zhvillimin rural- agro-rural për periudhën 2007-2013 janë përcaktuar dhe identifikuar projektet parësore. Janë hartuar edhe projekte për stimulimin e fermerëve për ngritjen e serave në sipërfaqe mbi 5 ari, për ngritjen e pemishteve në sipërfaqe mbi 50 ari, për mbjelljen e kulturave industriale (luledielli, kolzë, sojë) etj.

Buxheti komunal

Në situatën aktuale, vetëm buxheti komunal është i mundshëm të vlerësohet, ndërsa sektori privat, publik apo donacionet mund të vlerësohen duke u bazuar në përqindjen e pjesëmarrjes së tyre mesatare në Kosovë (25%, 75%, 5%).

Për vitin 2006 komuna ka aprovuar buxhetin prej 9,131,765€. Dhënia (grandi) qeveritar merr pjesë me 7,031,765€, ndërsa të hyrat vetjake janë të vlerësuara prej 2,100,000€.

Komuna ka aprovuar stafin maksimal prej 2.231 punëtorëve, për të gjitha programet.

Komuna mbledh dhe merr të hyrat vetjake, përfshirë gjobat në trafik, tarifatat administrative, licencat dhe tatimin në pronë. Normat e mbledhjes kanë qenë të ulëta deri tash. Ka pasur vetëm rritje të kufizuar në të hyrat vetjake, krahasuar me llojet e tjera të të hyrave, kështu që komuna është shumë e varur nga dhënit (grandet) e qeverisë qendrore. Punë substanciale është bërë për zbatimin e një sistemi të tatimit në pronë në komunë dhe kjo ka ofruar fushëveprimin më të madh të rritjes së të hyrave vetjake komunale. Komuna në mënyrë aktive ka kërkuar mënyra për të zgjeruar bazën e të hyrave vetjake dhe për të përmirësuar mbledhjet. Burimi kryesor i të hyrave vetjake të komunës është tatimi në pronë.

Tab. 9 Buxheti sipas programeve 2004-2006 (në Euro)

Buxheti 2004			
Programet –Dhënit (Grandet)	Dhënia(Granti) qeveritar	Të hyrat vetjake	Totali
Administrata e përgjithshme*	2.450.406	2.428.921	4.879.240
Arsimi	4.451.048	35.000	4.486.048
Shëndetësia	815.240	238.577	1.053.817
Totali	7.716.694	2.702.498	10.419.105
Buxheti 2005			
Administrata e përgjithshme*	1.868.684	2.270.884	4.139.568
Arsimi	4.266.970	64.042	4.331.012
Shëndetësia	845.461	283.897	1.129.358
Totali	6.981.115	2.618.823	9.599.938





Buxheti 2006			
Administrata e përgjithshme*	1.803.085	1.790.000	3.593.085
Arsimi	4.335.120	60.000	4.395.120
Shëndetësia	893.560	250.000	1.143.560
Totali	7.031.765	2.100.000	9.131.765

Koment : * Administratë komunale, ZLK, zjarrfiksat dhe zyrtarët për kthim.

Tab. 10 Buxheti sipas kategorive ekonomike 2004-2008

	Buxheti 2004	Buxheti 2005	Buxheti 2006	Buxheti i vlerësuar 2007	Buxheti i vlerësuar 2008
Shpenzimet operative	7.444.341	7.010.469	7.130.268	7.130.268	7.130.268
Shpenzimet kapitale	2.974.764	2.589.469	2.001.497	2.147.488	2.306.324
Totali	10.419.105	9.599.938	9.131.765	9.277.756	9.436.592
Në përqindje (%)					
Shpenzimet operative	71%	73%	78%	77%	76%
Shpenzimet kapitale	29%	27%	22%	23%	24%
Totali	100%	100%	100%	100%	100%





Tab. 11 Lista e projekteve kapitale, sipas librit buxhetor 2006-2008

	Emri i projektit	Shuma (€)	Dhënia qeveritare	Të hyrat vetjake
		2.001.497	506.114	1.495.383
1	Plani gjeneral urbanistik i qytetit	100.000		100.000
2	Mirëmbajtja e rrugëve	52.683		52.683
3	Mirëmbajtja e ndriçimit publik	25.000		25.000
4	Hartimi i projekteve të detajizuara	50.000		50.000
5	Pjesëmarrja në projekte e donatorëve	100.000		100.000
6	Rindërtimi i shtëpive për raste sociale	100.000		100.000
7	Ujësullësi në fshatin Mirash	53.500		53.500
8	Ujësullësi në fshatin Muhovc	33.250		33.250
9	Ujësullësi për fshatin Pojat - Softaj	54.000		54.000
10	Kanalizimi në lagjen II dhe IV	92.450		92.450
11	Ujësullësi dhe kanalizimi në Rrugën "Azem Shkreli"	5.264		5.264
12	Kanalizimi dhe ujësullësi në Rrugën "Abdullah Shabani"	3.486		3.486
13	Kanalizimi në fshatin Balaj	80.000		80.000
14	Rregullimi i Varrezave të Dëshmorëve	70.000		70.000
15	Asfaltimi i Rrugës "Ali Hadri" – "Vezir Jashari"	51.000		51.000
16	Asfaltimi i rrugës Lepenci	6.000		6.000
17	Asfaltimi i Rrugës "Gëzim Sahiti", "Isamil Emali"	29.050		29.050
18	Asfaltimi i rrugëve në lagjen e Gogëve	28.000		28.000
19	Asfaltimi i rrugës "Iliria"	43.000		43.000
20	Ndërtimi i punëtorive punuese në shkolla	50.000		50.000



21	Meremetimi i shk. në lagjen e Grajqesve, Prelez i Jerlive	59.000		59.000
22	Shkolla fillore në qytet	302.700		302.700
23	Shk. fill. në qytet, participimi nga grandi qeveritar	80.120	80.120	
24	Ndërtimi i aneksit njëdhomësh në Shk.fill."Ali Hadri"	11.000	11.000	
25	Ndërtimi i njeve higjienike në shkollën fillore "Halit Ibishi"	12.000		12.000
26	Instalimi i ngrohjes qendrore në SH.M.Teknike	44.000	44.000	
27	Rryma në fshatin Balaj	35.000		35.000
28	Projekti i Hendikosit	18.000		18.000
29	Aneksi i rjetit elektrik në Dubravë	10.000		10.000
30	Aneksi i rjetit elektrik në Sallahane	10.000		10.000
31	Ndërtimi i rjetit elektrik në Rrugën "Halit Ibishi"	22.000		22.000
32	Asfaltimi i rrugës Ferizaj - Nikadin	95.994	95.994	
33	Vazhdimi i gypsellësit Pleshin - Ferizaj	170.000	170.000	
34	Trotuari në fshatin Bibaj	105.000	105.000	

Tab. 12 Lista e projekteve kapitale sipas raporteve komunale

	Emri i projektit	Vlera	Komuna		Donatorët		Komuniteti i biznesit	
			%	Vlera	%	Vlera	%	Vlera
1	Plani Gjeneral Urbanistik	350.000	80	280.000	20	70.000		
2	Trajnimi i grupit për planifikim urban	10.000	80	8.000	20	2.000		
3	Themelimi i zyrës për shërbime të shpejta dhe zyrës për përkrahjen e bizneseve	20.000	85	17.000			15	3.000
4	Themelimi i fondit të ZHEL	180.000	80	144.000	20	36.000		
5	Trajnimi i stafit komunal për menaxhimin e projekteve	10.000	100	10.000				
6	Trajnimi i stafit komunal për menaxhimin e buxhetit	8.000	100	8.000				
7	Trajnimi i stafit në teknologjinë informative dhe në lëmitë e tjera	20.000	80	16.000	20	4.000		
8	Krijimi i WEB sajtit lokal	20.000	90	18.000			10	2.000



9	Anketimi i komunitetit të biznesit	3.000	90	2.700			10	300
10	Aftësimi i asociacioneve të biznesit	10.000	90	9.000			10	1.000
11	Buletini i informativ i biznesit	8.000	90	7.200			10	800
12	Binjakëzimi i Komunave	30.000	50	15.000	50	15.000		
13	Formimi i Klubit të Ambasadorëve	25.000	70	17.500	20	5.000	10	2.500
14	Inkubatori i biznesit	350.000	90	315.000			10	35.000
15	Pjesëmarrja në projekte e donatorëve	300.000	100	300.000				
16	Ndarja e bursave për kuadro	400.000	60	240.000	40	160.000		
17	Organizimi i punëtorive punuese nëpër shkolla	80.000	100	80.000				
18	Investimet në rregullimin e bifurkacionit të Lumit Nerodimja	28.000	100	28.000				
19	Hapja e shtratit të Lumit Sazlija	50.000	100	50.000				
20	Ndërtimi i parqeve (zonave) të gjelbra në qytet	180.000	70	126.000	30	54.000		
21	Trajnimi dhe stimulimi i prodhuesve bujqësorë	50.000	80	40.000	20	10.000		
22	Kanalizimi në Lagjen e III dhe IV	350.000	75	262.500			25	87.500
23	Mbulimi me sistem të kanalizimit i tërë territorit të qytetit	400.000	75	300.000			25	100.000
24	Asfaltimi i rrugëve të qytetit	320.000	70	224.000			30	96.000
25	Asfaltimi i rrugëve lokale	320.000	70	224.000			30	96.000
26	Asfaltimi i rrugëve në vendbanimet rurale	140.000	80	112.000			20	28.000
27	Ndërtimi i deponisë së mbeturinave	730.000	50	365.000			50	365.000
28	Zona industriale	150.000	20	30.000			80	120.000
29	Mbështetja e bizneseve prodhuese	100.000	80	80.000			20	20.000
30	Përmirësimi i furnizimit me energji elektrike	180.000	80	144.000	20	36.000		
31	Rregullimi i rrugëve për sipërfaqet bujqësore	50.000	70	35.000	30	15.000		



32	Ndërtimi i sistemit të ujësjes në gjashtë fshatra	670.000	100	670.000				
33	Hulumtimi i resurseve natyrore (ujit)	90.000	80	72.000	20	18.000		
34	Gjithsej:	5.632.000	75	4.249.900	8	425.000	17	957.100



2 VIZIONI, PARIMET DHE CAQET

Kuvendi i Komunë së Ferizajt, bashkë me UN-Habitatin, kanë organizuar në Ohër prej 22-25 shkurt 2007 një punëtori "Ferizaj 2015+" së bashku me përfaqësues të shoqërive të ndryshme civile, me qëllim të gjetjes së vizionit, synimeve dhe objektivave të zhvillimit të komunës.

Nga kjo punëtori ka dalë motoja dhe deklarata e vizionit, si në vijim:

MOTO: Urë në mes detesh, port për vargmalet, terminal në mes kryeqytetesh

Deklarata e Vizionit

Ferizaj, vend atraktiv, me zhvillim dinamik, terminal rajonal. Qytet i hapur, perspektiv. Urë e komunikimeve ekonomike, tregtare dhe kulturore. Portë për vargmalet, aty ku bifurkacioni fton për rekreacion.

Qytet integrues në mes kryeqytetesh. Vend ku promovohet potenciali investues i qytetarëve, ku jetohet denjësisht në mjedis ekologjik.

2.1 OBJEKTIVAT ZHVILLIMORE

Të dala nga punëtorja e vizionit në Ohër "Ferizaj 2015+"

Grupi 1 - "Qyteti me lumë" (Uji, natyra dhe mjedisi)

Objektivat afatshkurtra (2010)

- Shpallja e bifurkacionit si zonë e mbrojtur,
- Ndërlidhja më e mirë e kësaj zone me qytetin,
- Shpallja e vargmaleve të Sharrit si Park Nacional,
- Përpilimi i hartave hidrografike,
- Identifikimi i ndotësve të ujit,
- Identifikimi i prodhimeve karakteristike bujqësore,
- Kultivimi i frutave të imëta,
- Reduktimi i shfrytëzimit joracional të ujit.



Objektivat afatmesme (2015)

- Deminimi dhe pyllëzimi i zonave të dëmtuara në vargmalet e Sharrit,
- Pastrimi dhe rregullimi i shtratit të Lumit Nerodimja,
- Edukimi permanent rreth florës dhe faunës,
- Riparimi i sistemit të kanalizimit,
- Afirmimi i bifurkacionit.

Objektivat afatgjata (2025)

- Përmirësimi i edukimit për natyrën dhe mjedisin (Krijimi i infrastrukturës së duhur për edukim),
- Rritja e kapaciteteve të furnizimit me ujë,
- Ndërtimi i fabrikës së ujit,
- Krijimi i Liqenit artificial në Lumin Nerodime.

Grupi 2 – “Qyteti Mobil” (Infrastruktura, transporti dhe lëvizshmëria)

Objektivat afatshkurtra (2010)

- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore për këmbësorë dhe automjete në qytet dhe fshatra dhe emërtimi i rrugëve,
- Vendosja e shenjave të komunikacionit dhe e semaforëve, si dhe ndriçimi i të gjitha rrugëve dhe shesheve,
- Zhvendosja e stacionit hekurudhor për mallra, jashtë qytetit,
- Ndërtimi i tri nënkalimeve për automjete dhe i dy kalimeve për këmbësorë në segmentin hekurudhor brenda qytetit (për këmbësorë mund të jenë edhe mbikalime). Kjo është çështje urgjente.
- Organizimi i linjës së autobusit urban dhe përmirësimi (apo ndërtimi i ri) i kalimeve për këmbësorë, çiklistë dhe i kalimeve të veçanta për karrocë invalidësh,
- Zgjerimi i rrugëve ekzistuese dhe ndërtimi i lidhjeve të reja brenda në qytet dhe jashtë tij për të pasur qarkullim të rrjedhshëm.



Objektivat afatmesme (2015)

- Ndërtimi i rrugës unazore (transitit) jashtë qytetit dhe përmirësimi i rrugëve që ndërlidhen me të,
- Mbulimi i pjesshëm i hekurudhës (brenda në qytet) dhe menaxhimi i mirë me hapësirën përreth, duke e shfrytëzuar për gjelbërim, biznes apo për vendparkim.

Objektivat afatgjata (2025)

- Ndërtimi i rrugës afër maleve të Jezercit që lidhet me Budakovën (komunën e Therandës).

Grupi 3 – “Qyteti Produktiv” (Ekonomia Urbane dhe Rurale - Turizmi & Rekreacioni)

Objektivat afatshkurtra (2010)

- Ridefinimi dhe krijimi i Zonës industriale jashtë tokës bujqësore,
- Rivitalizimi i bazës industriale,
- Rehabilitimi dhe krijimi i bazës ligjore për mbrojtjen e fushës së Kosovës,
- Krijimi i plantacioneve të pemëve,
- Krijimi i terminalit tregtar në pjesën jugore të qytetit.

Objektivat afatmesme (2015)

- Krijimi i Institutit të Zhvillimit Industrial,
- Përpunimi i frutave,
- Lobimi për infrastrukturë të avancuar ligjore,
- Promovimi i fuqisë investuese nga të ardhurat vetanake të ferizajasve,
- Definimi dhe mbrojtja e zonave turistike

Objektivat afatgjata (2025)

- Krijimi i strategjisë për zhvillimin agroindustrial,
- Ndërtimi i qendrës rekreative rreth Lumit Nerodimja,
- Lobimi dhe krijimi i urave të partneritetit për integrim rajonal dhe evropian.



- Krijimi i infrastrukturës fizike dhe ligjore në përputhshmëri me standardet e UE.

Grupi 4/5 – “Qyteti publik” (Banimi dhe shërbimet sociale - Kultura, identiteti dhe trashëgimia arkeologjike)

Objektivat afatshkurtra (2010)

- Respektimi i pakompromis i rregullave të ndërtimit (banimit) në pjesën e vjetër të qytetit (qendrën e qytetit) në aspektin e lartësisë, etazhitetit dhe të sipërfaqeve përcjellëse (gjelbërimit, vendparkimeve, këndeve për lojëra...)
- Shqyrtimi (analiza) e kushteve aktuale të banimit dhe të mjedisit jetësor,
- Identifikimi i zonave arkeologjike.

Objektivat afatmesme (2015)

- Ndërtimi i objekteve të reja shkollore për arsimin fillor në harmoni me zhvillimin e zonave të banimit,
- Krijimi i Qendrës Kulturore (teatri, kinemaja, biblioteka...) në lokacion të përshtatshëm.

Objektivat afatgjata (2025)

- Zhvillimi i planifikuar i zonës së re të banimit në lokacionin të “Parku i Lirisë”, në drejtim të plantacioneve të pemëve (i emëruar si “Margaritari i gjelbër”). Ky model mund të shërbejë gjithashtu edhe për ndërtimin e zonave sekondare në pjesë të tjera të territorit komunal.

Grupi Planerëve Komunalë- “Qytet për të gjithë”

Objektivat afatshkurtra (2010)

- Furnizimi me ujë për të gjithë qytetarët,
- Krijimi i linjës së autobusit urban,
- Krijimi i agjencisë zhvillimore,
- Planifikimi dhe kontrollimi i të gjitha aktiviteteve zhvillimore.



Objektivat afatmesme (2015)

- Mbulimi i terë territorit komunal me infrastrukturë fizike dhe sociale,
- Ndërtimi i kapaciteteve investuese dhe integrimi rajonal, si dhe ai ndërkombëtar,
- Rindërtimi dhe dendësimi i zonave të banimit në qytet,
- Organizimi i sistemit të integruar të transportit - Qendra e mobilitetit.

Objektivat afatgjata (2025)

- Rritja e sasisë dhe cilësisë së sipërfaqeve të ujit dhe të gjelbërimit
- Përshtatja e standardeve ekonomike me UE
- Arritja e kohezionit social dhe përgjegjësitë



Tab. 13 Lista objektivave të dala nga punëtorja në Ohër

Tema	Fusha e fokusimit	Objektivi	I referohet	Afati i paraparë	GP	Financet Komuna+UNHABITAT	
						Prioriteti	arsyeja për prioritet te ulët
Turizmi	Në të gjithë zonën	Identifikimi dhe definimi i zonave turistike dhe mbrojtja e tyre	Politika turistike	-2015	3	Urgjent	
	Zona e Bifurkacionit	Definimi i Bifurkacionit si "Zonë e Mbrojtur"	Politika e shfrytëzimit të tokës	-2010	1	Urgjent	
	Lumi Nerodimja	Afërsimi i Bifurkacionit	Politika e shfrytëzimit të tokës	-2015	1	Urgjent	
		Pastrimi i shpatit të lumit	Minëmbajtja e Ujtit	-2010	1	Urgjent	
	vargmalet e shanit	Ndërtimi i qendres së rekreacionit dhe Lloetit Artificial	Minëmbajtja e Ujtit	-2025	1,3	I mesëm	
		Malet e Jezercit të vihen nën mbrojtje institucionale	Planifikim në bashkëpunim (koheziv)	-2010	1	I mesëm	
		Hajra dhe ndërtimi i rrugës Ferizaj- Jezerc- Llanishët- Therandë	Planifikim në bashkëpunim (koheziv)	-2010	2	I mesëm	
Trashëgimia Kulturore	Zonat Arkeologjike	Identifikimi dhe shpallja e zonave arkeologjike & identifikimi dhe ruajtja e objekteve të vjetra të qytetit	Politika kulturore	-2010	4	I lartë	
Mjedisi (Ambienti)	Në të gjithë zonën	Identifikimi i burimeve të ujit dhe krijimi i hartave hidrografike	Politika e shfrytëzimit të tokës	-2010	1	I mesëm	
	Në të gjithë zonën	Identifikimi i ndotësve të ujit	Minëmbajtja e Ujtit	-2010	1	Urgjent	
	Në të gjithë zonën	Parandajimi i shfrytëzimit joracional të ujit	Minëmbajtja e Ujtit	-2010	1	Urgjent	
	Në të gjithë zonën	Ndërtimi dhe Riconstruimi i Sistemit të Kanalizimit	Infrastrukturë	-2015	1	Urgjent	
	Në të gjithë zonën	Gazja në shfrytëzimin e ujit për të gjithë	Infrastrukturë	-2015	1,PK	Urgjent	
	Në të gjithë zonën	Rritja e cilësisë dhe sasisë së sferfaqeve të ujit dhe sferfaqeve të gjeibërta	Infrastrukturë	-2025	PK	I lartë	
	Në të gjithë zonën	Sensibilizimi i qytetarëve në mbrojtjen e natyrës dhe mjedisit	Sistemi i Edukimit	-2025	1	I mesëm	
	Zona Industriale	Ridefinimi dhe krijimi i zonave industriale jashtë tokës bujqësore	Politika e shfrytëzimit të tokës	-2010	3	I lartë	
Bujqësia	Toka Bujqësore	Identifikimi i kulturave bujqësore në territorin komunal	Bujqësi	-2010	1	I lartë	
	Toka Bujqësore	Shfrytëzim racional i tokës bujqësore (krijimi i plantacioneve të pemëve dhe kultivimi i frutave të imëta)	Tokë bujqësore	-2010	1,3	Urgjent	
Siguria	Vargmalet e shanit	Deminiimi i terrë territorit të komunës	Siguri	-2015	1	-	Edukuesi është qytetari dhe shpeshherë, duhet të shqyrtohet nga një tërësi dokument.
	Në fshat dhe qytet	Përmirësimi i rrugëve për makina dhe këmbësor	Infrastruktura	-2010	2	Urgjent	
Rrugët	Në fshat dhe qytet	Vendosja e shenjave të komunikacionit dhe semaforëve si dhe ndërtimi i të gjitha rrugëve dhe shesheve	Infrastruktura	-2010	2	I lartë	
	Në fshat dhe qytet	Ndërtimi i kalimeve për këmbësorë, ciklist dhe persona me nevojë të veçanta	Infrastruktura	-2010	2	I lartë	
	Ndërlidhja në mes qytetit dhe fshatrave	Përmirësimi i rrjetit të rrugëve në qytet dhe fshatra	Infrastruktura	-2010	2	I mesëm	
	Lagjet jashtë zonës urbane	Ndërtimi i rrugës qarkore (tranzit) jashtë qytetit dhe përmirësimi i rrugëve që ndërlidhën më të	Infrastruktura	-2015	2	Urgjent	
Transporti Publik	Stacioni i Trenit	Vendosja e stacionit të mallrave jashtë qytetit	Infrastruktura	-2010	2	I lartë	
	Linja hekurudhore	Ndërtimi i nënkallimeve dhe mbikallimeve në linjën hekurudhore për këmbësorë dhe automjete	Infrastruktura	-2010	2	Urgjent	
	Stacioni i trenit	Organizimi i sistemit të integruar të transportit (Qendra e Mobilitetit)	Infrastruktura & Transporti publik	-2015	PK	Urgjent	
	Në të gjithë zonën	Organizimi i Linjës Urbane të Autobusit	Transporti Publik	-2010	2,PK	I lartë	
Hapësira Publike	Linja hekurudhore	Mblidhje e pjesës së hekurudhës (nëpër qytet) dhe menagjim i mirë me hapësirën për më shumë duke e shfrytëzuar atë që gjeibërim, parkim dhe hapësirë biznesi.	Infrastruktura	-2015	2	I lartë	
Ekonomia & Industria	Zona Industriale	Revitalizimi i bazës industriale	Politika ekonomike	-2015	3	Urgjent	
	Zhvillim i RI	Krijimi i Terminalit Tregtar në pjesën jugore jashtë qytetit	Politika ekonomike	-2010	3	I mesëm	
	Në të gjithë zonën	Promovimi i potencialëve investues të qytetarëve	Politika ekonomike	-2015	3	Urgjent	
	Zona Industriale	Zhvillimi i Agrobiznesit	Politika ekonomike	-2025	3	I lartë	
	Zhvillim i RI	Themelimi i Agjencionit Zhvillimor	qetër	-2010	3,PK	I lartë	
	Në të gjithë zonën	Ngritja e kapaciteteve investuese dhe integrimi rajonal & europian	qetër	-2015	PK	I mesëm	
UE	Në të gjithë zonën	Lobimi dhe krijimi i urave të partneritetit për integrim rajonal dhe Europian	qetër	-2025	3	I mesëm	
	Në të gjithë zonën	Krijimi i infrastrukturës ligjore dhe fizike konform standardeve të UE	qetër	-2015	3	I mesëm	
	Në të gjithë zonën	Perzhtatja e standardeve ekonomike me UE	qetër	-2025	PK	I mesëm	
Ndërtimi	Qendra e vjetër e qytetit	Ridefinimi i qendres së qytetit dhe ndërtimi i rrugëve të veçanta për trajtim të gjithmbarshëm edhe në lëmin e ndërtimit	Kontrola e Zhvillimit	-2010	4	Urgjent	
	Në të gjithë zonën	Planifikimi dhe kontrolli i të gjitha aktiviteteve zhvillimore	Kontrola e Zhvillimit	-2010	PK	Urgjent	



	Zhvillim i RI	Zhvillim i ri në lokacionin "Parku i Lirisë". Ky mund të shërbejë si model për zhvillim kompakt ku përfshihen të gjitha shërbimet për banim (spitali, shkolle, tregu etj)	Modeli i zhvillimit kompakt	-2025	4	-	Kerkohej më tepër diskutim dhe vizion për të
Banimi	Zona e Banimit	Krijimi i politikës së ndërtimit për banimin kolektiv	Politika e Banimit	-2010	4	I lartë	
	Zona e Banimit	Shqyrtimi (analiza) e kushteve aktuale të banimit dhe mjedisit jetësor	Politika e Banimit				
	Zona e Banimit	Rindërtimi dhe Intensifikimi (dendësimi) i zonave aktuale të banimit mbrenda në qytet	Politika e Banimit	-2015	PK	I lartë	
Objektet shkollore/kulturore	Në të gjithë zonën	Ndërtimi i objekteve të reja për shkolimin filior në përputhshmëri me zhvillimin e zonave të banimit	Edukimi	-2015	4	I lartë	
	Në të gjithë zonën	Krijimi i qendrës kulturore (Teatri, Salla e Filmit, Biblioteka...) & Rekreativo-sportive, në lokacion të përkatshëm	Kultura	-2015	4	I mesëm	



2.2 PARIMET E PËRGJITHSHME PËR ZHVILLIM

Në pajtim me PZHK vizioni pasqyrohet rreth parimeve dhe qëllimeve si në vijim:

- Sigurimi i infrastrukturës teknike dhe sociale që kujdeset për nevojat e qytetareve,
- Promovimi i ekonomisë së qëndrueshme të komunës, duke krijuar punë të mjaftueshme për banorët e qytetit,
- Ngritja e kushteve të shëndetshme, të banueshme dhe atraktive në zonat urbane dhe në fshatra,
- Sigurimi urban i qëndrueshëm dhe sigurimi i mjedisit për fshatra që kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës,
- Zhvillimi i sistemit të lëvizshëm të transportit dhe trafikut (duke siguruar qasje të mirë urbane),
- Decentralizimi i vendimmarrjes në nivel lokal,
- Stimulimi i sinergjive dhe shmangia nga konfliktet potenciale.
-

2.3 CAQET DHE POTENCIALET ZHVILLIMORE AFATGJATE

Qëllimi i analizës së gjendjes nuk është vetëm gjetja e problemeve për ta përmirësuar atë, por më shumë gjetja e aftësisë financiare të komunës për realizimin e projekteve përkatëse. Komuna ka burime të limituara në dispozicion. Megjithatë, është e rëndësishme që këto burime të përqendrohen në sektorët të cilët po e bëjnë Ferizajn të dallueshëm nga pjesët e tjera të Kosovës dhe të cilat kanë potencial që ta zhvillojnë qytetin më tutje.

Lëmenjtë e identifikuar me potenciale për zhvillim janë:

- Industria,
- Kultura dhe sporti,
- Bukuritë natyrore,
- Bujqësia,
- Transporti,
- Tregtia.



Synimet dhe caqet

- Zhvillimi hapësinor i planifikuar dhe i kontrolluar,
- Përmirësimi i rrjetit të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore,
- Përmirësimi i rrjetit të infrastrukturës sociale dhe teknike, si dhe ofrimi sa më i mirë i shërbimeve publike,
- Rregullimi dhe formalizmi i vendbanimeve joformale,
- Sigurimi i qasjes në hapësira adekuate për banim për secilin qytetar,
- Aplikimi i politikave që stimulojnë zhvillimin e zonave rurale,
- Mbrojtja e tokës bujqësore,
- Ruajtja e trashëgimisë kulturore,
- Shfrytëzimi sa më racional i resurseve,
- Ulja e shkallës së papunësisë dhe e varfërisë,
- Kontrollimi më i sigurt i zonave të rrezikuara nga katastrofat natyrore dhe ato të shkaktuara.

2.4 PRIORITETET STRATEGJIKE

- Hartimi i planeve rregulluese urbane,
- Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore,
- Mbrojtja e mjedisit,
- Ofrimi i infrastrukturës së domosdoshme për krijimin e kushteve, për investime në zhvillimin ekonomik,
- Shfrytëzimi racional i territorit,
- Hartimi i programit për trajtimin e vendbanimeve joformale,
- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore
- Përmirësimi i infrastrukturës sociale dhe teknike
- Furnizimi me ujë



3 KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPESINOR URBAN

3.1 Planet e veprimit për zhvillimin hapësinor

3.1.1 Skenari A

Zhvillimi i pjesës lindore

- Zhvillimi i vendbanimeve është i përqendruar në pjesën lindore,
- Pjesa perëndimore e qytetit përdoret për parqe dhe rekreacion,
- Trafiku për mesë është i drejtuar përreth qendrës së qytetit, në rrugën anësore që është e vendosur në rrugët ekzistuese. Këto rrugë janë riparuar sikurse rrugët brenda qytetit, me kapacitet të lartë,
- Hekurudha është larguar në lindje të qytetit, me stacionin e ri të hekurudhës jashtë qendrës së qytetit,
- Stacioni i mallrave është ndërtuar afër zonës industriale, në veri, ndërmjet hekurudhës dhe rrugës magjistrale,

Analizat për Skenarin A



Përparësitë:

- Nuk ka barrierë në qendër të qytetit,
- Nuk ka trafik përmes qendrës së qytetit,
- Zonat e mëdha gjelbëruese në perëndim,
- Qasje e mirë për vendbanimet e reja.



Mangësitë

- Plani i veprimit, bazuar në linjën e re hekurudhore, i kushtueshëm,
- Nuk ka qasje në zonat e gjelbëruara në lindje,
- Qendra e qytetit e dobësuar pa stacionin hekurudhor,
- Qasje më e dobët për zonat banuese në perëndim.



Konkluzionet

- Ky plan i veprimit nuk do të zhvillohet më.



3.1.2 Skenari B

- Zhvillimi i vendbanimeve në të gjitha drejtimet,
- Korridoret e gjelbëruara përgjatë lumenjve dhe përrenjve në perëndim,
- Rruga magjistrale e rëndësishme M2/E65 është larguar në një rrugë në pjesën lindore të rrugës ekzistuese,
- Një rrugë anësore është ndërtuar në pjesën perëndimore të qytetit,
- Një linjë e re hekurudhore për trafikun e mallrave është ndërtuar në pjesën lindore të qytetit, me stacionin e mallrave ndërmjet hekurudhës dhe rrugës së re magjistrale M2/E65,
- Linja ekzistuese hekurudhore është përdorur vetëm për trafikun e njerëzve, me stacionin hekurudhor në qendër të qytetit.

Analizat për Skenarin B

+

Përparësitë:

- Nuk ka trafik përmes brendisë së qytetit,
- Stacioni hekurudhor në qendër të qytetit,
- Nuk ka trafik për mallra nëpër brendinë e qytetit,
- Qasje e mirë për të gjitha pjesët e qytetit.

-

Mangësitë

- Nuk ka qasje në zonat e gjelbëruara në lindje,
- Hekurudha është duke krijuar barrierë përmes brendisë së qytetit.

à

Konkluzionet

- Plani i veprimit do të zhvillohet në kombinim me planet e tjera të veprimit.



3.1.3 Skenari C

- Zhvillimi i vendbanimeve në të gjitha drejtimet,
- Korridoret e gjelbëruara rrjedhin nga peizazhet e hapura në brendinë e qytetit,
- Një rrugë unazore është ndërtuar jashtë qytetit,
- Një linjë e re hekurudhore për trafikun e mallrave është ndërtuar në pjesën lindore të qytetit,
- Linja ekzistuese hekurudhore është përdorur vetëm për trafikun e njerëzve, me stacionin hekurudhor në qendër të qytetit,
- Një stacion i mallrave është ndërtuar afër Zonës industriale, në pjesën veriore, ndërmjet hekurudhës dhe rrugës unazore.
-

Analiza për Skenarin C

+

Përparësitë:

- Nuk ka trafik përmes brendisë së qytetit,
- Stacioni hekurudhor në qendër të qytetit,
- Korridoret e gjelbëruara kanë krijuar klimë të favorshme në qytet,
- Qasje e mirë në të gjitha pjesët e qytetit.

-

Mangësitë

- Zhvillimi i zonave të mëdha krijon rrezik për shtrirje urbane,
- Përdorimi jo i efektshëm i rrugës unazore me zhvillim vetëm në një pjesë,
- Hekurudha po krijon barrierë përmes brendisë së qytetit.

à

Konkluzionet

- Plani i veprimit do të zhvillohet në kombinim me planin tjetër të zhvillimit.



PLANI 8: PLANET E VEPRIMIT NË QYTETITN E FERIZAJT



3.2 PLANI I VEPRIMIT PËR TRAFIK DHE TRANSPORT

Në Planin e Zhvillimit të Komunës (PZHK) janë analizuar zgjidhje të ndryshme thelbësore për trafikun në komunë. Në Planin e Zhvillimit Urban (PZHU), duhet të gjenden zgjidhje më të detajuara. Zgjidhjet e ndryshme në PZHK dhe pasojat që ato mund t'i kenë për qytetin, janë diskutuar edhe njëherë më shumë dhe janë krahasuar zgjidhjet e ndryshme.


3.2.1 Trafiku rrugor

Trafiku rrugor vjen nga katër drejtime kryesore: Prishtina, Gjilani, Shkupi dhe Prizreni. Trafiku në drejtimet e Prishtinës, Gjilanit dhe Shkupit duhet të kalojë vetëm përmes periferisë së qytetit. Të gjitha trafiqet në drejtim të Prizrenit dhe Kosovës Perëndimore, si dhe ato nga pjesa komunale, duhet të kalojnë përmes Ferizajt. Janë diskutuar katër zgjidhje të ndryshme.



A. Në përdorim janë rrugët ekzistuese përmes qytetit. Rrugët janë zgjeruar dhe udhëkryqet janë përmirësuar.


Kjo është zgjedhja më e shtrenjtë. Rrugët përmes qytetit vetëm pjesërisht mund të zgjerohen dhe kapaciteti i tyre është përmirësuar vetëm pak. Problemi me trafikun nëpër brendinë e qyteti do të mbetet.



B. Në veri të qytetit është ndërtuar një rrugë e re anësore. Rrugët e tjera ende janë në përdorim. Rruga magjistrale M2 dhe M25-3 janë kombinuar në lindje të qytetit.

Pjesa më e madhe e trafikut përmes qytetit do të largohet nga qendra e tij. Sidoqoftë, trafiku përmes zonave komerciale në lindje të qytetit do të rritet dhe trafiku nga perëndimi i qytetit do të kalojë përmes qendrës. Është e paqartë nëse dendësia e trafikut në drejtim të Prizrenit është aq e lartë, sa të jetë e nevojshme të


ndërtohet një rrugë e re.



C. Një rrugë me kapacitet të lartë është paraparë paralelisht me rrugën magjistrale ekzistuese M2, përmes komunës. Një rrugë unazore është ndërtuar përreth qyteti të Ferizajt.

Kjo rrugë alternative zgjidh shumicën e problemeve të trafikut që kalon përmes komunës dhe përreth qytetit, edhe pse është një alternativë shumë e shtrenjtë. Shumica e rrugëve kryesore në komunë duhet të rindërtohen dhe është e pasigurt nëse

dendësia e trafikut është mjaft e lartë për t'i arsyetuar investimet aq të mëdha.



D. Një pjesë e re e rrugës magjistrale M2 është ndërtuar në pjesën që kalon në qytetin e Ferizajt, ndërkaq pjesët e tjera të rrugës magjistrale janë mbajtur. Rrugët ekzistuese dhe një numër i rrugëve të reja përreth qytetit janë kombinuar në një rrugë unazore.

Është rindërtuar vetëm pjesa e rrugëve magjistrale me trafik më të ngarkuar. Nga të gjitha drejtimet trafiku është orientuar përreth qytetit dhe është mbajtur jashtë qendrës së tij.

Konkluzion: Alternativa D është zgjidhja më e përshtatshme.

3.2.2 Transporti hekurudhor


Linja kryesore e hekurudhës në Kosovë kalon nga Shkupi për në Mitrovicë, përmes qytetit të Ferizajt. Në njërin anë, hekurudha dhe stacioni kryesor në qendër të qytetit janë parë si lidhje me pjesën më të madhe të Kosovës dhe si veçori karakteristike për Ferizajn. Në anën tjetër, hekurudha është një barrierë përmes qytetit, e cila po shkakton probleme për sigurinë. Janë propozuar mënyra të ndryshme për zgjidhjen e këtij problemi.



A. Linja hekurudhore ekzistuese përmes qytetit është riparuar, udhëkryqet janë përmirësuar. Stacioni kryesor është përmirësuar dhe është rihapur stacioni për mallra në pjesën veriore të qytetit.


Stacioni kryesor është ende në qendër të qytetit të Ferizajt, por gjithashtu edhe problemet me sigurinë, zhurmën dhe barrierat mbesin. Është vlerësuar më me leverdi restaurimi i binarët hekurudhorë sesa

ndërtimi i një linje të re.




B. Hekurudha është larguar jashtë brendisë së qyteti, në një rrugën magjistrale M2/E65, në lindje të qytetit. Linja e re hekurudhore drejt Gjilanit është e lidhur me linjën ekzistuese në Ferizaj. Në udhëkryqin ndërmjet linjave hekurudhore është paraparë një stacion kryesor.

Kjo alternativë mund t'i zgjidhë problemet e zhurmës dhe të sigurisë në qytet dhe mund ta zhvendosë trafikun nga qendra e qytetit. Kjo alternativë, e cila i cakton kufijtë e udhëkryqit të rrugëve magjistrale në lokacione të ndryshme dhe e zhvendos Stacionin hekurudhor nga qendra e qytetit, është njëra nga pasuritë kryesore të Ferizajt. Megjithatë, është shumë e kushtueshme.



C. Hekurudha është larguar jashtë brendisë së qytetit, në një rrugë në perëndim të tij. Një linjë e re hekurudhore është propozuar në rrugën e fshatit Pleshinë.

Kjo alternativë gjithashtu mund ta lehtësojë brendinë e qytetit nga shumica e problemeve lidhur me trafikun e veturave dhe hekurudhën. Stacioni kryesor mund të arrihet lehtë. Edhe pse linja e re hekurudhore në perëndim të qytetit nuk do të kryqëzohet me rrugën M2, kjo ende mund të jetë një zgjidhje e kushtueshme.



D. Linja hekurudhore për udhëtarë dhe transport të mallrave mbetet ekzistuesja, ndërsa në planin afatgjatë (zgjidhje alternative), për trafikun e mallrave në pjesën lindore të qytetit ndërtohet një linjë e re hekurudhore, paralele me rrugën M2. Linja hekurudhore ekzistuese është përdorur vetëm për udhëtarë.

Stacioni kryesor është mbajtur në qendër të qytetit. Problemet për sigurinë dhe zhurmën janë reduktuar. Mirëpo barriera ende është aty. Linja e re hekurudhore është edhe e kushtueshme, edhe duhet të kalojë rrugët magjistrale në disa pjesë.

Konkluzion: Alternativa D do të zhvillohet më tej.



3.3 Modeli i zhvillimit hapësinor

Modeli i zhvillimit hapësinor është i bazuar në konkluzionet nga analiza e gjendjes, si dhe në planin e veprimit hapësinor. Ai i shfaq kualitetet bazike në lidhje me zhvillimin hapësinor të komunës. Ky plan do të përfshijë një sipërfaqe prej 1700 ha.

Pikat kryesore nga bazat e modelit të zhvillimit hapësinor, janë:

Një qendër e fortë e qytetit

Për ta përkrahur identitetin urban të Ferizajt, është përforcuar qendra e qytetit. Të gjitha funksionet e rëndësishme publike dhe kulturore janë përqendruar këtu. Dendësitë dhe lartësitë e ndërtesave janë më të mëdha sesa në zonat përreth qendrave dytësore.

Pjesa qendrore e qytetit është bulevardi qendror, që kalon paralel me hekurudhën. Tërësia me xhaminë dhe kishën ortodokse e formojnë një nga pikat fillestare. Sheshi qendror me stacionin e trenit është një pikë tjetër me rëndësi në këtë bulevard.

Industria dhe zonat komerciale përgjatë rrugës magjistrale

Disa prej kërkesave të rëndësishme nga industria dhe tregtia janë: komunikimi i mirë dhe mundësia për të punuar pa i penguar zonat banuese përreth. Prandaj, të gjitha zonat industriale dhe tregtare janë ndërtuar jashtë brendisë së qytetit, përgjatë rrugës magjistrale dhe linjës hekurudhore për mallra.

Zonat për përdorim të përzier përgjatë rrugëve kryesore

Për ta përforcuar karakterin kumbues urban të rrugëve kryesore jashtë qendrës së qytetit, për ta zgjeruar tregtinë me pakicë dhe shërbimet e tjera në të gjitha pjesët e qytetit dhe për t'i ndihmuar zonat e varfra të banimit nga shqetësimet, zonat për përdorim të përzier i kufizojnë rrugët kryesore të cilat e lidhin qendrën e qytetit me periferitë.

Zhvillimi dhe dendësia e fushës bojëkafe

Toka e mirë bujqësore është një nga pasuritë më të rëndësishme të Kosovës. Pjesa më e madhe e tokës në Ferizaj është e cilësisë së lartë dhe vetëm në raste të veçanta mund të përdoret për ndërtim.

Prioriteti i parë për zhvillimin urban, duhet t'u jepet zonave të lëshuara nga ushtria dhe nga fushat e tjera të prezantuara me ngjyrë bojëkafe. Shumica e pjesëve të qytetit janë ndërtuar në mënyrë të shpërndarë. Dendësia e këtyre zonave gjithashtu do të ketë vend për t'u përdorur për ndërtim më



parë se çfarëdo toke e çmuar bujqësore, që është kthyer në tokë ndërtimore pa planifikim.

Gishtat e gjelbër përmes qytetit

Parqet e reja, sheshet për shëtitje, si dhe lojërat dhe hapësirat e tjera të hapura publike janë caktuar në hapësirat ku nuk ka ndërtime në qytet. Ato janë kombinuar në korridore të gjelbëruara, të cilat depërtojnë nga lagjet e jashtme të qendrës së qytetit. Në lindje dhe në veri, hapësirat e gjelbëruara të definuara si pika fillestare, janë peizazhet e hapura. Në përfundim, është fillimi i "Rripit të Gjelbër të Ferizajt", kombinimi i veçorive rekreative përgjatë lumit Nerodime. Lugina e Nerodimes me bifurkacionin e saj formon njërin nga korridoret për gjelbërim.

Lumenjtë që kalojnë përmes Ferizajt janë ri-normalizuar dhe janë integruar në rrjetin e gjelbër.

Përmes trafikut jashtë qytetit

Ferizaj është i vendosur në udhëkryqin ndërmjet rrugëve të rëndësishme M2, ndërmjet Mitrovicës dhe Shkupit, dhe M25-3, ndërmjet Prizrenit dhe Gjilanit. Ky kryqëzim rrugësh për Ferizajn ka vlerë të shumëfishtë dhe i ka sjellë atij përfitime të konsiderueshme. Ndërkaq, rrugët e ngushta në qendër të qytetit janë të stërmbrushura nga trafiku.

Kapaciteti i disa rrugëve ekzistuese është ngritur dhe është kombinuar me rrugë të reja në një unazë komplete përreth qytetit.

Trenat e pasagjerëve në qendër të qytet – trenat e mallrave jashtë qytetit

Trenat që kalojnë përmes qendrës së qytetit i kanë efektet pozitive dhe negative. Stacioni qendror në qendër të qytetit dhe afër Stacionit të autobusëve, e përmirësojnë kualitetin e transportit publik. Linja hekurudhore ndërmjet pjesës verilindore dhe jug-perëndimore të qytetit, megjithatë paraqet zonë shumë të rrezikshme për kalimin e udhëtareve.

Për ta kufizuar trafikun përmes qytetit, është propozuar një linjë tjetër alternative në pjesën lindore të periferisë së qytetit. Kjo linjë është në planin afatgjatë dhe për të duhet të ruhet vetëm traseja. Në pjesën më të madhe, trafiku i mallrave, si edhe trafiqet e tjera të cilat nuk ndalen në Ferizaj, janë paraparë të zhvillohen në këtë linjë.



PLANI 9: MODELI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR NË QYTETIN E FERIZAJT



3.4 Struktura Urbane

Qendra e qytetit të Ferizajt gjendet përgjatë linjës hekurudhore. Zonat për përdorim të përzier i rrethojnë rrugët kryesore nga qendra e qytetit në periferi, si dhe linjën hekurudhore jashtë qendrës. Zonat banuese kryesisht janë të vendosura në mes. Shkollat, infrastrukturat e tjera për kujdesje shëndetësore dhe sociale janë të përfshira në zonat kryesore të banimit. Zonat industriale dhe tregtare janë të përqendruara në pjesën veri-lindore të qytetit, përgjatë rrugës magjistrale M2 dhe M25-3.

Sigurimi i tokës ndërtimore për të ardhmen, është shtjelluar në detaje në kapitullin vijues. Llojet e ndryshme të përdorimit të tokës janë paraparë si në vijim:

Qendra e qytetit

Qendra do të sigurojë hapësirë kryesisht për objekte qendrore, si për biznes dhe tregti, për administratë dhe kulturë. Qendra e qytetit është paraparë për përdorimet si në vijim:

1. Biznes, zyra dhe administratë,
2. Tregtia me pakicë, tregtia e furnizimit të ushqimeve, tregtia e akomodimit dhe argëtimit,
3. Përdorimet e tjera joshqetësuese komerciale,
4. Pajisjet për fenë, kulturën, pajisjet sociale, të kujdesit shëndetësorë, dhe të çështje sportive,
5. Parkingjet e automjeteve,
6. Përdorimet për banim.

Zonat për përdorim të përzier

Zonat për përdorim të përzier sigurojnë hapësirë kryesisht për çështje të banimit dhe për çështje komerciale, që nuk e pengojnë njëra tjetrën. Këto hapësira janë paraparë për:

1. Ndërtesat e banimit,
2. Ndërtesat për biznes dhe zyra,
3. Tregtinë me pakicë, furnizimin me ushqime, akomodimin dhe argëtimin,
4. Përdorimet e tjera joshqetësuese komerciale,
5. Ndërtesat për administratën, si dhe ato për fenë, kulturën, çështjet sociale, kujdesje shëndetësore dhe çështje sportive,
6. Ndërmarrjet kopshtare,
7. Pompat e karburantit,
8. Objekte për argëtim.



Zonat kryesisht për banim

Shumica e zonave të banimit sigurojnë hapësirë për banim. Janë paraparë përdorimet si në vijim:

1. Ndërtesat për banim,
2. Sigurimi i zonave të nevojshme për tregti me pakicë, të furnizimit me ushqime dhe për përdorimet komerciale joshqetësuese,
3. Pajisjet për fenë, kulturën, pajisjet sociale, ato të kujdesit shëndetësor, dhe të çështjeve sportive.

Përdorimet në vijim janë paraparë vetëm në raste të veçanta:

1. Tregtia e akomodimit,
2. Përdorimet e tjera joshqetësuese komerciale,
3. Ndërtesat për administratë,
4. Ndërmarrjet kopshtare,
5. Pompat e karburantit.

Zonat për përdorim nga komuniteti

Zonat për përdorim nga komuniteti sigurojnë hapësirë për objekte publike, siç janë shkollat, çerdhet e fëmijëve dhe qendrat e kujdesit shëndetësorë. Gjithashtu, janë paraparë edhe objekte të tjera publike.

Zonat komerciale/industriale

Zonat komerciale dhe industriale sigurojnë hapësirë për të gjitha llojet e çështjeve komerciale, kryesisht përdorime që nuk janë të lejuara në zonat e tjera. Hapësirat e paraparë për këto përdorime janë si në vijim:

1. Të gjitha llojet e ndërmarrjeve komerciale dhe industriale, ndërtesat e dyqaneve, depotë dhe ndërmarrjet publike,
2. Biznesi, zyra dhe administratë,
3. Pompat e karburantit,
4. Objekte sportive.

Përdorimet në vijim janë paraparë vetëm në raste të veçanta:

1. Objektet për fenë, kulturën, objektet sociale dhe të kujdesit shëndetësor,
2. Banimin për stafin mbikëqyrës, për menaxherët ose për pronarët e prodhimeve,
3. Objektet e ndërmarrjeve.



PLANI 10: NDARJA E ZONAVE URBANE



Zona në fshatra

Zonat në fshatra sigurojnë kryesisht hapësira për banim, objekte për bujqësi dhe pylltari, përdorime të tjera joshqetësuese komerciale, si dhe infrastrukturë publike dhe private të nevojshme për furnizimin e tyre.

Hapësirat e parapara për përdorime janë si në vijim:

1. Objekte për bujqësi dhe pylltari, si dhe për pjesë shtesë të shtëpive
2. Çështje të banimit,
3. Tregtia me pakicë, furnizimi me ushqime, akomodimi dhe argëtimi,
4. Përdorimet e tjera joshqetësuese komerciale,
5. Ndërtesat për administratën, si dhe ato për fenë, kulturën, çështjet sociale, përkujdesjen shëndetësore dhe çështjet sportive,
6. Ndërmarrjet kopshtare,
7. Pompat e karburantit.

Sigurimi i tokës ndërtimore

Në bazë të të dhënave komunale mbi popullsinë dhe banimin, PZHK e parasheh në detaje konceptin e sigurimit të tokës ndërtimore. Sipas PZHK-së, sigurimi i tokës në vijim duhet të përcaktohet (cf. Konkluzion detal në Planin e Zhvillimit të Komunës së Ferizajt), si në vijim:

3.4.1 Zonat banuese

Në bazë të këtyre rekomandimeve, është propozuar sigurimi i tokës ndërtimore për banim:

- Qyteti i Ferizajt do të sigurojë sasi shtesë toke ndërtimore prej 140 ha deri në vitin 2015 dhe 210 ha deri në vitin 2020.
- Për nevojat potenciale të banimit në qytetin e Ferizajt, pas vitit 2020, plani i cili është i gatshëm i përcakton edhe 15 ha të zonës së banimit individual, plus zona ushtarake në veri-perëndim të Ferizajt, si zonë potenciale për rizhvillim. Kjo zonë ka një sipërfaqe prej 25 ha.

3.4.2 Sigurimi i tokës për industri dhe biznes

PZHU gjithashtu do të sigurojë tokë për industri dhe për çështje komerciale.

Duke e marrë parasysh situatën specifike të ekonomisë në Ferizaj, llogaritjet e nevojave të sigurimit të tokës për industri dhe për çështje komerciale nuk janë të arsyeshme. Për zhvillimin e ardhshëm ekonomik të komunës është rekomanduar të sigurohet një furnizim strategjik.



Për etapën e parë zhvillimore të industrisë së ushqimit, të materialit ndërtimor dhe kompanive shpërndarëse, sigurimi prej 20 deri 30 ha i tokës ndërtimore është adekuat. Për nevojat afatgjate është rekomanduar një rezervë strategjike prej rreth 100 ha. Rekomandohet që sigurimi më i madh i tokës ndërtimore duhet të fokusohet në vetë qytetin e Ferizajt.

3.4.3 Sigurimi i tokës për përdorim të përzier dhe të përbashkët

Sigurimi i tokës për përdorim të përzier dhe të përbashkët, gjithashtu, përputhet me qasjen strategjike të sigurimit të tokës ndërtimore, të prezantuar me parë. Zonat për përdorim të përzier në Ferizaj zakonisht mund të gjenden përgjatë rrugëve kryesore urbane. Përgjatë rrugëve kryesore, edhe më tej do të ndërtohen dhe zhvillohen objekte komerciale dhe tregtare. Duhet të sigurohen sasi shtesë toke ndërtimore prej rreth 40 ha për një zonë për ndërtim të përzier për qytetin e Ferizajt. Nga kjo, përafërsisht 6 ha të kësaj zone duhet të përcaktohet për ndërtimin e objekteve të përbashkëta, kryesisht për objekte ndihmëse për shëndetësi.

3.4.4 Politikat e sigurimit gjeneral të tokës / zhvillimi hap pas hapi

Për të bërë përdorimin sa më të mirë të resurseve komunale, është rekomanduar t'i jepet prioritet ndërtimit të objekteve në toka të braktisura. Zhvillimi i fushave të gjelbra duhet të kuptohet si prioritet sekondar.

Duke e planifikuar politikën e shfrytëzimit të tokës për ndërtim për Ferizajn, sigurimi i tokës ndërtimore duhet të realizohet hap pas hapi. Nga kjo del se sigurimi i rekomanduar i tokës për ndërtim, nuk duhet të zhvillohet menjëherë. Është kërkuar që të sigurohet tokë ndërtimore, e llogaritur sipas nevojave të tanishme dhe atyre për të ardhmen.



Tab. 14 Sigurimi i tokës ndërtimore, i përcaktuar në PZHU

Kategoria e tokës ndërtimore	Sigurimi i tokës në ha	Vërejtje
	Qytet	
Zonat për banim	~140 ha (2015) ~210 ha (2020)	Një rezerve strategjike shtesë prej 15 ha plus 25 ha (zonat e konvertuara) është përcaktuar në plan.
Zonat për përdorim të përzier (afatgjatë)	40 ha	
Për përdorim të përbashkët (afatgjatë)	6	
Tokë për industri dhe çështje komerciale (afatgjatë)	100	Hapi i parë i zhvillimit në qytet: 20 to 30 ha



PLANI 11: PLANI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR I QYTETIT TË FERIZAJT





PLANI 12: KUFIRI URBAN



3.5 Mjedisi dhe peizazhi

Struktura e hapësirave të gjelbëruara të Ferizajt i përmbush kërkesat e banorëve për rekreacion. Zonat e hapura, të lidhura me njëra-tjetrën, janë gjithashtu të rëndësishme për klimën lokale, si dhe për florën dhe faunën. Shumica e parqeve, fushat e sportit, varrezat dhe hapësirat e tjera të hapura në qytet janë të lidhura me njëra-tjetrën dhe e formojnë një rrejt të gjelbër.

Sigurimi dhe përmirësimi i shesheve për lojëra, i fushave të sportit etj. parqeve të ndryshme të reja në zonat e afërta dhe në hapësirat e tjera të hapura publike është planifikuar në tokën e pandërtuar brenda zonës së banueshme ekzistuese. Ky planifikim mundëson kombinimin me njëra-tjetrën për t'i formuar hapësirat e gjelbra, duke depërtuar përmes qytetit.

Një nga akset kryesore gjelbëruese të Ferizajt është Lugina e Nerodimes. Ajo kalon nga thellësia e maleve për në qytet, duke përkrahur anën perëndimore të qendrës së tij. Një zonë e madhe përgjatë Lumit të Nerodimes është paraparë për park publik, ndërsa një pjesë e madhe e anës veriore të saj është paraparë si mal. Bifurkacioni, që ndodhet në këtë park, është propozuar si qendër për vizitorë.

Në pjesën perëndimore të qytetit gjendet një kodër e vogël me pamje të mrekullueshme. Për në këtë kodër është propozuar një park publik, me pikë vrotimi, si dhe një mal i vogël. Ai gjithashtu do të formojë pikën fillestare prej nga akset e gjelbra depërtojnë brenda në qytet.

Nerodimja dhe lumenjtë e tjerë që rrjedhin përmes qyteti, duhet mbrojtur nga ndotja. Zonat përreth lumit dhe rrjedhave, duhet të mbeten të lira nga ndërtimet dhe zonat përreth tyre duhet të mbrohen.





PLANI 13: KONCEPTI I PEISAZHIT NË QYTETIN E FERIZAJT



3.6 Trafiku dhe transporti

3.6.1 Rrjeti rrugor

Rrugët ekzistuese dhe ato të planifikuara përreth qytetit janë lidhur në një rrugë unazore. Të gjitha rrugët kryesore jashtë qytetit janë të lidhura në këtë unazë. Trafiku urban, me pikën fillestare dhe përfundimtare në periferi të Ferizajt, është mbajtur jashtë qytetit. Rruga unazore gjithashtu bashkon dhe klasifikon trafikun lokal nga njëri drejtim i qytetit në tjetrin.

Rruga unazore ka karakter të ndryshëm në pjesët e saj të ndryshme. Në asnjë pjesë të saj ajo nuk është autostradë, por ka më tepër karakterin e rrugës së gjerë të qytetit. Pjesa lindore, e cila kombinohet me dy rrugët kryesore M2 dhe M25-3, trafikun e ka më të ngarkuar.

Rruga anësore në pjesën veriore, një rrugë e re e M25-3, kalon përmes trasesë ekzistuese. Ajo do ta ketë karakterin e gjerë të rrugës së qytetit. Me rindërtimi i udhëkryqeve është përmirësuar kapaciteti i saj.

Detyra kryesore e rrugës anësore në jug dhe perëndim është që ta mbrojë trafikun, respektivisht që trafiku nga zonat banuese dhe fshatrat në pjesën perëndimore të qytetit, të mos kalojë pa nevojë përmes qendrës së tij. Këto pjesë të rrugës unazore e kanë karakterin e rrugës kryesore të qytetit. Rruga anësore në pjesën perëndimore, është transferuar disa herë për ta mbrojtur trafikun qendror.



Rrugët magjistrale kryesore lidhen nga rruga unazore me qendrën e qytetit. Ato sigurojnë qasje me rrugën unazore nga të gjitha pjesët e qytetit.

Gjithashtu, është definuar një unazë e brendshme rrugore, e cila do ta funksionalizonte trafikun në qytet.

Në skicat në vijim mund të shihen prerjet e mundshme të rrugëve të paraqitura edhe në Planin 11a.





Fig. 20: Prerjet e mundshme të rrugëve të qytetit






Prerja 3-3



Profili minimal




3.6.2 Rrjeti hekurudhor


Brenda qytetit janë paraparë dy linja hekurudhore (ekzistuese është vetëm njëra, kurse tjetra është alternative që mund të shfrytëzohet në perspektivë). Linja ekzistuese përmes qytetit është e rezervuar vetëm për pasagjer. Momentalisht, kjo linjë ekzistuese mund të përdoret edhe për transportin e mallrave. Si alternative e optimizimit dhe modernizimit të hekurudhës, është propozuar një linjë e re hekurudhore përmes zonës së planifikuar industriale dhe komerciale në lindje të qytetit. Kjo e siguron mundësinë e lidhjes së hekurudhës për ndërmarrjet industriale. Trafiku për mallra kryesisht është paraparë të zhvillohet në linjën e re hekurudhore, por gjithashtu edhe pasagjerët që nuk ndalen në Ferizaj mund ta përdorin këtë linjë. Kjo mund ta liroj qendrën e qytetit nga disa shqetësime që krijohen nga frekuenca e trenave. Hekurudhat kryqëzohen me rrjetin e rrugës kryesore në disa pika. Të gjitha këto udhëkryqe duhet të sigurohen me vendkalime në nivele të ndryshme, qoftë me urë ose tunel.

Në figurën në vazhdim, janë dhënë profilet e mundshme të hekurudhës brenda kufirit urban.


Fig. 21: Korridori i hekurudhës brenda kufirit urban




V.1.



V.2.



V.3.





Brenda kufirit urban mund te perdoren njeri nga 3 variantet e paraqitura me siper.

Profili ne variantin V.1. eshte i perbere nga hekurudha me gjeresi 18m dhe ne te dy anet nga rruget me gjeresi 11m. Ne V.2. eshte paraqitur profili i hekurudhes 18m me rruge prej 11m ne njeren ane, kurse ne anen tjeter gjelberim.

Ne variantin V.3. eshte paraqitur profili minimal i hekurudhes me gjeresi 18m dhe ne te dy anet e saj me gjelberim.

Duhet te tentohet qe rruga te realizohet te pakten ne njeren ane te hekurudhes (varianti V.2.).

Ne pjesen e zones se Mobilitetit (pjesa qendrore e qytetit), do te zhvillohet projekt i vecantë.


3.6.3 Transporti publik

Stacioni qendror i trenave është i vendosur në mes të qendrës së qytetit. Ai arrihet lehtë për shumicën e kërkesave dhe qëllimeve të rëndësishme të qytetarëve.

Transporti publik në qytet dhe në komunë realizohet me autobusë. Lidhja e mëtejme e udhëtarëve, nga autobusët lokalë dhe urbanë me ata rajonalë, mundësohet përmes stacionit qendror të autobusëve. Ky stacion është i vendosur afër atij hekurudhor dhe mundëson lidhjen ndërmjet trenave dhe autobusëve.

Në figurën e mëposhtme është paraqitur një skemë e mundshme e trafikut urban.

Fig. 22: Linjat e mundshme të transportit publik





PLANI 14: KONCEPTI I TRAFIKUT NË QYTETIN E FERIZAJT



3.7 Infrastruktura Teknike

3.7.1 Ujërat dhe kanalizimi

Në vitet e ardhshme do të rriten nevojat për ujë të pijshëm. Duke marrë parasysh faktin se rrjeti i furnizimit me ujë është i shkatërruar pjesërisht, është e qartë se është i nevojshëm përmirësimi i tij. Për t'i zvogëluar në minimum reduktimet e furnizimit me ujë, duhet të përkrahet përdorimi sa më efikas i tij.

Shtimi i nevojave për ujë, shkatërrimi i pjesshëm i rrjetit të kanalizimit dhe fakti se Ferizaj nuk ka ndonjë pajisje për trajtimin e ujërave të zeza, ka si imperativ riparimin e sistemit të menaxhimit të ujërave të zeza.

Me zgjerimin e sistemit të kanalizimit, do të jetë i nevojshëm një menaxhim më gjithëpërfshirës i ujit. Elementi thelbësorë i menaxhimit modern të ujit, është ndarja e ujit të shiut dhe e ujërave të zeza. Derisa ujërat e zeza duhet të mbledhen dhe të trajtohen brenda një sistemi të mbyllur, ujërat nga shiu duhet të trajtohen përafërsisht si në mbledhjen e ujërave natyrore. Kjo nënkupton mbrojtjen dhe filtrimin e ujërave të shiut brenda zonave banuese dhe komerciale. Mbrojtja dhe filtrimi i ujërave të shiut e zvogëlon shkarkimin e ujërave të zeza gjatë kohës së derdhjes së tyre dhe ndihmon reduktimin e investimeve të nevojshme. Këto masa janë më të nevojshme në zonat me banim të dendur, siç është qyteti i Ferizajt.

3.7.2 Energjia elektrike

Pozita e favorshme e Ferizajt në rrafshin e Fushë-Kosovës, me të gjitha arteriet kryesore që kalojnë përmes komunës, i ka siguruar atij furnizim relativisht të qëndrueshëm me energji elektrike. Megjithatë, edhe në këtë rajon ka reduktime të shpeshta të energjisë elektrike. Problemi kryesor për komunën është gjendja e sistemit të furnizimit me energji. Shumica e familjeve furnizohen nga linjat e gjata dhe disa prej tyre janë në gjendje të keqe. Përmirësimi i këtyre linjave duhet të ketë prioritet. Duhet të provohet mundësia për shfrytëzimin burimeve alternative të energjisë brenda komunës.

Me një infrastrukturë të vjetruar – rrjet të tensionit të ulët, sidomos nëpër disa pjesë rurale të komunës, është i pamundur furnizimi kualitativ me energji elektrike. Posaçërisht duhet investuar që rrjeti 10kV të shndërrohet në 20 kV si dhe të bëhet ndërrimi i trafostacioneve 10/04kV në 20/04kV të fuqive përkatëse për këto linja furnizuese:

- LP 10kV Prelez i Jerlive – i Muhaxherëve
- LP 10kV Betoni – Koshare
- LP 10kV Lloshkobare – Dremjak


Fig. 23: Rrjeti elektrik i Kosovës



Burimi: KEK-u

Fig. 24: Nënstacionet e reja

Nënstacionet e reja 110/20(10)kV në Kosovë



Burimi: KEK-u


TS e ri 110/20(10) kV

\$ TS_2002-2005

\$ TS_2006-2010

\$ TS_2011-2015

Fig. 25: Rëniet e tensionit



Burimi: KEK-u

Rëniet e tensionit (%)

2000 - # 0-5

2005 - # 5-10

2010 - # 10-15

2015 - # 15-30

Për furnizimin kualitativ dhe kuantitativ është e domosdoshme, pos kalimit nga sistemi 10/0,4kV në sistemin 20/0,4kV, (sistemi 20 cili rrit aftësitë bartëse dhe zvogëlon humbjet teknike), të arrihen këto objektiva:

1. Eliminimi i rreziqeve,
2. Zvogëlimi i humbjeve teknike,
3. Eliminimi i fyteve të ngushta.

Pikërisht për këtë, propozohet të ndërtohet një nënstacion i ri në lokacionin Bibaj, i tipit TS 110/10(20)kV me fuqi 1x 40 MVA, me kthina adekuate mbrojtëse dhe rregulluese dhe me mbi 20 dalje kabllore 20 kV, i cili do të mundësojë furnizim cilësorë me energji elektrike të Ferizajt.


3.7.3 Energjia për ngrohje

Duke pasur parasysh se parashikimi i nevojave për ngrohje qendrore për një lagje apo qytet, është një problem mjaft i ndërlikuar, për të cilin duhet njohur shumë parametra dhe të dhëna, në vijim do të japim një përshkrim shumë të shkurtër dhe me siguri të përafërt për një llogari aq serioze dhe gjithëpërfshirëse.

Për caktimin e saktë të shpenzimeve të energjisë për ngrohje, duhet t'u referohemi llogarive sipas DIN 4701 / 1E (08.95.), Udhëzime për llogaritje të nxehtësisë së nevojshme dhe VDI 2067/2 (12.93), Ngrohja në dhoma, për të cilët janë dhënë rezultatet ekzakte në varësi nga objekti.

Një llogari e përafërt mund të lexohet nga diagrami në vijim:

Fig. 26: Nxehtësia e nevojshme specifike mesatare maksimale për objektet e banimit dhe për objektet afariste për m^2 të sipërfaqes e cila shfrytëzohet.



Nga fig. 22 mund të lexojmë se:

Për objektet e vjetra, me madhësi 1.000 m^3 , është diku 110 W/m^2
Për objektet e vjetra, me madhësi 3.000 m^3 , është diku 90 W/m^2
Për objektet e vjetra, me madhësi 5.000 m^3 , është diku 80 W/m^2
Për objektet e vjetra, me madhësi 10.000 m^3 , është diku 75 W/m^2
Për objektet e vjetra, me madhësi 20.000 m^3 , është diku 70 W/m^2

Sipas urdhrit administrativ për kursimin e nxehtësisë W/SVO 1982:

Për objektet e reja, me madhësi 1.000 m³, është diku 55 W/m²


Për objektet e reja, me madhësi 3.000 m³, është diku 45 W/m²

Për objektet e reja, me madhësi 5.000 m³, është diku 40 W/m²

Për objektet e reja, me madhësi 10.000 m³, është diku 38 W/m²

Për objektet e reja, me madhësi 10.000 m³, është diku 35 W/m²

Fig. 27: Vlerat orientuese për nxehtësinë specifike të ngrohjes, në varësi nga vjetërsia dhe raporti A/V (sipërfaqja e jashtme përfshirëse ndaj vëllimit).




Për shtëpitë për disa familje dhe me nxehtësi specifike të nevojshme:

Për objektet e vjetra: 80 W/m² është 0.4

Për objektet e reja : 40 W/m² është 0.6

Fig. 28: Nxehhtësia e nevojshme specifike mesatare maksimale për objekte të fabrikave për m^3 të hapësirës



Për hapësirat me vëllim $1.000 m^3$ është diku $1.25 W/m^3 K$
Për hapësirat me vëllim $2.000 m^3$ është diku $1.00 W/m^3 K$
Për hapësirat me vëllim $5.000 m^3$ është diku $0.8 W/m^3 K$
Për hapësirat me vëllim $10.000 m^3$ është diku $0.6 W/m^3 K$

Llogaria për numër të banorëve

Për 98.000 banorë, duke llogaritur se për një banor nevojiten $12 m^2$ sipërfaqe, nga numri i përgjithshëm i banorëve, diku 48.000 banorë jetojnë në objekte e vjetra,

Atëherë $48.000 \text{ banorë} \times 8 m^2 = 384.000 m^2$

Por, nëse marrim se 50.000 banorë do të jetojnë në objekte e reja, atëherë:

$50.000 \text{ banorë} \times 12 m^2 = 600.000 m^2$

$384.000 m^2 \times 80 W/m^2 = 30.720.000 W$ apo $30.720 kW$ apo $30,7 MW$


$600.000 m^2 \times 40 W/m^2 = 24.000.000 W$ apo $24.000 kW$ apo $24 MW$

Pra, sipas kësaj llogarie të përafërt për ngrohje të 98.000 banorëve të qytetit të Ferizajt nevojiten rreth $54 MW$ energji nxehësie për ngrohje.

Për përcaktimin e saktë të kapaciteteve për ngrohje dhe të sasisë së energjisë së nevojshme, duhet të trajtohen me saktësi edhe këta faktorë:

- _ Sipërfaqja e saktë e objekteve ekzistuese,
- _ Lloji i objekteve ekzistuese,
- _ Madhësia e objekteve ekzistuese,
- _ Mundësia e ngrohjes së objekteve ekzistuese,
- _ Planifikimi i kriterëve termike për objektet e reja që duhet ndërtuar dhe,
- _ Lloji i objekteve të reja të cilat ndërtohen.

Fig. 29: Rrjeti primar dhe sekondar i ngrohjes së qytetit





PLANI 15: INFRASTRUKTURA TEKNIKE – ELEKTRIKA



PLANI 16: INFRASTRUKTURA TEKNIKE – UJËSJELLËSI



PLANI 17: INFRASTRUKTURA TEKNIKE - NGROHJA





3.8 Infrastruktura Sociale

3.8.1 Përkujdesja shëndetësore

Përkujdesja shëndetësore në qytet është e realizuar përmes disa qendrash të kujdesit të tillë. Meqenëse shtimi i popullsisë është domethënës në vitet e fundit dhe do të vazhdojë të rritet, atëherë do të shtohet edhe nevoja për kujdesin shëndetësor. Në vitet e ardhshme, ka nevojë të zgjerohet qendra e kujdesit shëndetësor "Qendra II", ndërkaq në qytet të ndërtohet edhe një qendër e re.

Spitali rajonal ekzistues ka nevojë të zgjerohet. Për këtë janë ekzaminuar disa lokacione dhe variante të ndryshme:

1. Zgjerimi i lokacionit aktual

Zgjerimi i spitalit ekzistues është alternativë më e mirë, mirëpo përderisa parcela është tërësisht e zënë, nuk ka mundësi për zgjerim të mëtejshëm.

2. Baza e KFOR-it përgjatë rrugës M2.

Lokacioni është pranë rrugës M2 dhe arrihet lehtë nga shumica e pjesëve në rajon, por qasja nga qyteti është e vështirë. Për ta përdorur zonën tanimë të ndërtuar, duhet të ketë përputhshmëri me konkluzionet që janë përshkruar në "Modelin Hapësinor Zhvillimor". (cf. Plani 6), edhe pse është shumë e pasigurt se kur kjo zonë do t'i kthehet komunës për përdorim nga civilët. Vlen të ceket se kjo zonë, megjithatë, është më pak e përshtatshme për shfrytëzim të tillë.

3. Pjesa veriore, mbi kazernat e qytetit

Kjo zonë arrihet lehtë nga qyteti dhe nga shumë pjesë të rajonit. Lokacioni në majë të kodrës, në mes të parkut, është i përshtatshëm për spital. Në të ardhmen kjo mund të jetë një mundësi për zgjerimin e spitalit drejt perëndimit. Sikurse edhe alternativa 2, kjo mund të realizohet vetëm nëse është në harmoni me politikën mbi përdorimin e tokës, të përcaktuar në Planin e Zhvillimit Hapësinor.

4. Lokacioni në mes M2 dhe linjës së planifikuar hekurudhore për mallra

Kjo zonë ka qasje të mirë nga M2, por është e shkëputur nga qyteti. Zbatimi i projektit është i lehtë, sepse komuna është pronare e tokës. Lokacioni ndërmjet hekurudhës dhe rrugëve, megjithatë, nuk është ideal



për spital dhe ndërtimi i tij në tokë bujqësore të vlefshme është kundër politikës së shfrytëzimit të tokës bujqësore.

5. Lokacioni në fshatin Varosh

Ky lokacion, me mundësi për zgjerim në të ardhmen, është i përshtatshëm për spital, sepse aty arrihet lehtë nga qyteti. Këtë e ka mundësuar ndërtimi i rrugës së parë anësore në pjesën veriore nga M2. Lokacioni brenda zonës së ndërtuar, gjithashtu, është në pajtueshmëri me Modelin Hapësinor Zhvillimor.


6. Lokacioni në rrugën për Manastir

Lokacioni është lehtë i arritshëm nga qyteti, posaçërisht me ndërtimin e rrugës anësore në pjesën veri-jugore nga rajoni. Lokacioni në pjesën e qytetit është i përshtatshëm për spital. Lokacioni brenda zonës së ndërtuar gjithashtu është në harmoni me Projektin Hapësinor Zhvillimor.

Konkluzion: Alternativa 3 rekomandohet.



Fig. 30: Alternativat e lokacionit të spitalit





3.11 Trashëgimia kulturore dhe natyrore

3.11.1 Mbrojtja e substancave historike të ndërtimit

Mbrojtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore të Ferizajt duhet bazuar në vetëdijen e publikut për vlerat dhe rëndësinë e këtyre objekteve, për identitetin e komunitetit vendor dhe si pika për tërheqjen e vizitorëve. Njohuritë mbi rëndësinë historike të monumenteve duhet të përhapen në mënyrë sa më të gjerë, ndërkaq ngritja e vlerës së trashëgimisë kulturore duhet të jetë e bazuar në njohuritë për të.

Mbrojtja e monumenteve historike në rend të parë do të thotë ruajtja fizike e tyre. Për këtë arsye monumentet historike duhet të jenë në shfrytëzim. Në këtë mënyrë në vazhdimësi do të sigurohet mirëmbajtja dhe kujdesi për to. Ka raste kur për këto objekte edhe nuk mund të gjendet shfrytëzimi adekuat. Për këtë, riparimi i tyre kërkon mjete relativisht të mëdha. Prandaj, për t'u ruajtur objektet e tilla, duhet siguruar donacione dhe subvencionime përkatëse. Në të kundërtën, pronaret i zëvendësojnë objektet e tilla me ndërtime moderne.

Mungesa e informimit për rëndësinë historike të këtyre objekteve mund të jetë edhe shkak i rrënimit të tyre. Që të mos ndodhin rrënime të tilla, pronarëve të objekteve të tilla, me vlera historike dhe kulturore, duhet t'u sigurohen informata e këshilla të ekspertëve. Ndihtesë shtesë mund t'u ofrohet edhe një program për trajnime profesionale, me qëllim të aftësimit të punëtorëve të rinj për teknologjinë e ndërtimit për të cilën nuk kanë zotësi të mjaftueshme.

3.11.2 Objektivat e planifikuara

Objektet e vetme dhe rrethinat e tyre

Për planifikimin urban, mbrojtja e monumenteve historike do të thotë ruajtja dhe kultivimi i mjedisit përreth dhe ruajtja e objekteve duke i mbetur besnik origjinalitetit të tyre. Monumentet historike në Ferizaj, siç janë xhamitë, tyrbet, kishat dhe kullat, ndonëse janë në gjendje shqetësuese, ato janë të integruara në strukturën e qytetit dhe janë të vendosura afër ndërtesave të tjera që kanë funksione të ndryshme. Ndërtimi i objekteve të reja pranë objekteve me vlera historike dhe kulturore nuk guxon të bëhet duke ua humbur pamjen atyre, por duhet të jenë në harmoni me to si për nga forma, ashtu edhe për nga madhësia e tyre. Duhet të miratohen Kufizime dhe rregulla specifike për t'i ndaluar ndërtimet joadekuate në afërsi të monumenteve historike. Objektet e reja duhet t'i adaptohen mjedisit përreth objekteve të tilla.



Peizazhi dhe pikat e referimit

Monumentet natyrore, si dhe ato trashëgimore gjithashtu janë pjesë e peizazhit, ndërsa disa prej tyre kanë qenë pika referimi (sepse duken nga distanca të largëta). Rasti i njëjtë është, p.sh. , bifurkacioni i Nerodimes.

Në planin hapësinor duhet dhënë vend meritore zhvillimit të elementeve të peizazhit për aktivitet në natyrë, duke i mirëmbajtur dhe rregulluar ato. Objektet për turizëm dhe rekreacion duhet të jenë larg ndërtimeve, në distancë adekuate, që të mos dëmtohet pamja dhe peizazhi natyror i tyre. Pamjet e bukura natyrore përreth qytetit janë një nga komponentet që tërheqin vëmendjen e vizitorëve dhe ndihmojnë zhvillimin e turizmit.

3.12 Fazat e zhvillimit

Struktura urbane e Ferizajt e bën të mundshëm zhvillimin e tij në disa faza. Zhvillimi urban do të marrë qytetin ekzistues, si pikë fillestare, e pastaj e vazhdon ndërtimin e infrastrukturës së re të tij.

Në fazën e parë, rruga ekzistuese në pjesën veriore të qytetit është përmirësuar dhe është lakuar në rrugën anësore në pjesën veriore. Zonat komerciale përgjatë kësaj rruge dhe M2 janë shpeshtuar.

Në Luginën e Nerodimes është paraparë ndërtimi i parkut, si dhe korridoret e gjelbra në pjesën lindore të Ferizajt. Zonat banuese dhe të përziera përreth parqeve dhe korridoreve të gjelbra janë shpeshtuar dhe janë plotësuar zonat e mëdha të pandërtuara. Nëse kazeremat në pjesën perëndimore i dorëzohen komunës, atëherë në atë zonë parashihet të ndërtohet një zonë banuese.

Sigurimi i korridoreve për rrugët e ardhshme dhe hekurudhat është pjesë me rëndësi e fazës së parë të zbatimit të PZHU-së

Në fazën e dytë është parapa zgjerimi i një pjese të re të rrugës M2.

Në pjesën jugore të qytetit është paraparë ndërtimi i rrugëve anësore, si dhe linja për Nerodime, në pjesën perëndimore të tij. Në pjesën jugore janë paraparë korridore të gjelbra, ndërsa zonat banuese në jug dhe në perëndim janë dendësuar.

Në fazën e tretë janë paraparë të ndërtohen dy pjesë më shumë të rrugës anësore në pjesën perëndimore të saj, dhe dy korridore të gjelbra. Ndërtimet në zonat përreth shpeshtohen. Në fazën e fundit parashihet të



ndërtohen: korridori i fundit i gjelbër dhe zonat e humbura të rrugës anësore perëndimore.

Ndërtimi i linjës së hekurudhës për mallra (opsionale) është i pavarur nga zhvillimet e tjera në qytet. Zona industriale ndërmjet hekurudhës dhe M2, gjithashtu është e pavarur nga ndërtimet e tjera dhe duhet të zhvillohet sipas kërkesave aktuale të zonave të tilla.



PLANI 18: FAZAT E ZHVILLIMIT NË QYTETIN E FERIZAJT



4 STRATEGJITE DHE VEPRIMET PER IMPLEMENTIM

Plani i Zhvillimit Urban e drejton dhe kontrollon zhvillimin e Ferizajt për 10 vitet e ardhshme. Funkzioni i tij më i rëndësishëm është të përcaktojë strukturën e vendbanimit, të peizazhit dhe të bëjë sigurimin e infrastrukturës për periudhën kohore deri në vitin 2015. Por PZHU e luan një rol gjithashtu të rëndësishëm edhe për kohën pas vitit 2015. Zonat e ndërtimeve, të objektet ndihmëse të infrastrukturës që do të ndërtohen pas vitit 2015 janë të realizueshme, nëse pjesët dhe korridoret për to janë definuar në PZHU të sotëm.

4.1 STRATEGJITË PËR ZBATIM DHE PLANET E VEPRIMIT TË SHOQËRUARA ME KONCEPTET HAPËSINORE OSE PARIMET

Instrumentet e rëndësishme për implementim

PLANET RREGULLUESE URBANE

Në lidhje me implementimin e projekteve të vendbanimeve – projekteve kyçe, është i nevojshëm mbulimi i zonës urbane me plane rregulluese (cf. Neni 15 Ligji për Planifikimin Hapësinor). Planet Rregulluese Urbane, “i përcaktojnë kushtet për rregullimin e hapësirave, si dhe rregullat për lokacionin e ndërtesave në ngastrat urbane”. Përmes themelimit të bazës ligjore për ndërtimin e ndërtesave, ato e vendosin kornizën për investime private. Si rrjedhim, Planet Rregulluese Urbane janë si mjete kyçe për implementimin e zonave të përcaktuara ndërtimore.

Definicionet udhëzuese për planet rregulluese – Parametrat urbanë

- Definicioni për “Etazh të Plotë”
“Etazh i Plotë ” është etazhi, përdhesi me lartësi jo më pak se 1.4 m mbi sipërfaqen e tokës dhe i cili ka në maksimum 2/3 e sipërfaqes së dyshemesë së etazhit nën të dhe nuk kalon lartësinë e pastër prej maksimalisht 2.3 m. Sipërfaqja e dyshemesë së etazhit që nuk është etazh i plotë nuk do të konsiderohet ISD.
- Definicioni i indeksit të shfrytëzueshmërisë së ngastrës (ISHN).
Indeksi i shfrytëzueshmërisë së ngastrës përcakton raportin në mes të ngastrës dhe ndërtimit që bëhet në përdhes. Vlera numerike e ISHN është 1, nëse e tërë ngastra është e mbuluar me ndërtim.
- Definicioni i indeksit për sipërfaqe të dyshemesë (ISD).
Indeksi i sipërfaqes së dyshemesë përcakton sa sipërfaqe të dyshemesë së ndërtuar lejohet për 1m² të ngastrës. Sipërfaqja e tërësishme e dyshemesë kalkulohet me gabaritin e etazheve të plota (bodrumi nuk konsiderohet në ISD).



PLANI 19: DENDËSIA DHE ETAZHITETI



PROJEKTET KYÇE

Projektet e propozuara kyçe janë të rëndësishme për zhvillimin e ardhshëm të komunës së Ferizajt. Ato janë ndarë në projekte për vendbanim, peizazh, trafik dhe për infrastrukturë teknike. Projekteve të sipërpërmendura nuk u është dhënë prioritet.

VENDBANIMET

Rizhvillimi i zonave të ushtrisë


Zona e mëparshme e ushtrisë, e cilat momentalisht është në shfrytëzim të TMK-së, është e vendosur në një kodër afër Luginës së Nerodimes, me pamje nga qytetit. Lokacioni është shumë i përshtatshëm për banim dhe për çështje të tjera civile. Nëse kjo zonë do të vihet në dispozicion të komunës, do të mund të zhvillohet një distrikt i ri atraktiv.

Plani rregullues / rizhvillimi i qendrës së qytetit

Për ta krijuar një qendër atraktive të qytetit, të papenguar nga trafiku, duhet hartuar një plan rregullues për qendrën e tij. Një aks me objekte religjioze dhe kulturore, si pikë fillestare, dhe sheshi i saj në mes mund të zhvillohen në qendër të qytetit. Hekurudha e kombinuar dhe stacioni i autobusëve, me mundësi të kryqëzimit të binarëve, mund të ndërtohen në sheshin qendror.



Fig. 31: Skica për rihvillimin e qendrës së qytetit



Zona komerciale përgjatë rrugës magjistrale M2

Lokacioni i Ferizajt në rrugën magjistrale M2 është një nga pasuritë kryesore të qytetit. Edhe zona komerciale përgjatë rrugës është një nga zhvillimet më të rëndësishme ekonomike për momentin. Ndërtimi i pakontrolluar aktual, megjithatë është drejtuar në një përdorim të paefektshëm të tokës dhe po e bllokon zgjerimin e nevojshëm të rrugës.

Për ta siguruar zhvillimin e ardhshëm ekonomik në qytet, pa e penguar trafikun në rrugën M2, ndërtimet në këtë zonë duhet të rregullohen me planin rregullues.

Vendbanimet Joformale (VBJF)

VBJF duhet të formalizohen. Forma e formalizimit të tyre është dhënë në Udhëzuesin për formalizimin e VJ të MMPH-së.

Preferohet që komuna të bëjë profilizimin e të gjitha VBJF në qytet dhe krijimin e një baze të të dhënave për qytetin. Komuna duhet të përgatisë profilin e gjendjes ekzistuese të vendbanimeve joformale në territorin e tyre. Kjo do t'u shërbente për të përcaktuar prioritetet e rregullimit të vendbanimeve joformale, kurse donatorëve të mundshëm do t'u ofronte informata të nevojshme për nevojën e përkrahjes financiare, humane dhe teknike për rregullimin e tyre.




Shërbimet e kadastrit dhe të pronës duhet të sigurojnë planet gjeodezike dhe shënimet pronësore, në mënyrë që saktësia e informatave të mos paraqesë problem për planifikim.

Çështja e pronës: Nevojitet një angazhim intensiv i Komunës për të përcaktuar të drejtat pronësore. Të gjitha dokumentet e nevojshme pronësore duhet të mblidhen dhe të verifikohet vlefshmëria e tyre. Çështjet e pazgjidhura pronësore duhet të zgjidhen në mënyrë që të krijohet baza ligjore për fillimin e procesit të planifikimit.

Procesi i planifikimit - Rregullimi i vendbanimeve joformale duhet të realizohet përmes një procesi gjithëpërfshirës, në mënyrë që pjesëmarrësit të kenë mundësi të artikulojnë kërkesat e tyre dhe marrja e vendimeve të jetë transparente. Për këtë qëllim duhet të organizohen banorët e vendbanimeve të tilla, që të jenë të gatshëm të kyçen në proces të formalizimit, përmes të zgjedhurve të komunitetit apo pjesëmarrjes së të gjithëve drejtpërsëdrejti.

Kostoja dhe kohëzgjatja e formalizimit dhe rregullimit të vendbanimeve joformale do duhej të jetë komponentë e obligueshme e strategjisë afatmesme dhe afatgjate e rregullimit të vendbanimeve joformale në qytet.

Fig. 32: Vendbanimet e identifikuara joformale



PEIZAZHI DHE MJEDISI

Parku i qytetit dhe pylli i qytetit


Qyteti i Ferizajt ka mungesë të hapësirave për rekreacion. Parku i planifikuar dhe pyjet në afërsi do t'i përmbushin kërkesat për rekreacion të qytetarëve. Parku gjithashtu do të ndihmojë në mbrojtjen e bifurkacionit dhe do të jetë pjesa e parë e zonës rekreative në Luginën e Nerodimes, e përcaktuar në Planin e Zhvillimit të Komunës.

Rigjallërimi i sistemit të lumit

Afër lumit të Nerodimes, përmes periferisë së Ferizajt rrjedhin rrëqe të ndryshme të vogla. Ujërat e zeza shkarkohen direkt në lumë dhe shumica e ujit është e ndotur. Pjesë të lumenjve dhe të rrëqeve janë të mbuluara dhe përmes gypave nëntokësorë.

Lumenjtë dhe luginat duhet të pastrohen dhe rigjallërohen. Uji është një element i rëndësishëm për qytetin dhe mund të shfrytëzohet për të krijuar pamje të bukura urbane.

Fig. 33: Profili i mundshëm i rregullimit të lumit



TRAFIKU DHE TRANSPORTI

Rizhvillimi i rrugës anësore në pjesën veriperëndimore

Për ta mbajtur trafikun në qytet, jashtë qendrës së tij, duhet të përmirësohet standardi i rrugës që e lidh rrugën M2 dhe M25-3. Kapaciteti i udhëkryqeve duhet të rritet.

Rruga anësore në pjesën lindore

Kapaciteti ekzistues i rrugës M2 në pjesën lindore të qyteti, si dhe mundësia e zgjerimit të tij janë të kufizuara për shkak të zhvillimeve komerciale përgjatë rrugës. Për ta përmirësuar kapacitetin e kësaj rruge të rëndësishme dhe për ta siguruar zhvillimin komercial në qytet, është propozuar zgjerimi i kësaj rruge, edhe pse kompetencat për këtë rrugë i ka Ministria e Transportit. Rruga përgjatë zonës ndërmjet Ferizajt dhe fshatrave Bibaj dhe Talinoc i Madh duhet të kontrollohet me kujdes, pasi që ajo mund të jetë lidhja e Ferizajt me autostradën e propozuar në nivel qendror.



Rruga anësore në juglindje

Për ta liruar qendrën e qytetit nga trafiku dhe për t'i përmirësuar lidhjet me pjesën perëndimore të Ferizajt, është propozuar një rrugë anësore në pjesën perëndimore të qytetit. Ndërtimi i kësaj rruge anësore mund të bëhet në një të ardhme të afërt. Për ta siguruar ndërtimin e ardhshëm të rrugës anësore, një korridor duhet të mbahet i lirë nga ndërtimet.

Sistemi i trafikut në qendër të qytetit

Me standardin e lartë të rrugëve në brendinë e qytetit, duhet të rritet kapaciteti i rrugëve dhe disa nga problemet e trafikut mund të zgjidhen. Sistemi i rrugëve një-drejtimesh duhet të rishikohet. Kur të jenë ndërtuar rrugët anësore përreth qytetit, dhe të jetë rritur dendësia e trafikut në to, mund të rishikohet zona e këmbësorëve në qendër.

Lëvizshmëria e qendrës

Stacionet për hekurudhë dhe autobusë duhet të kombinohen në një qendër mobiliteti të lëvizshme, në një qendër për transport publik në qytet dhe në komunë. Në lidhje me qendrën e lëvizshme duhet të sigurohen parkingjet e shumta për automobila dhe biçikleta. Për ta bërë qendrën e qytetit të lëvizshme, të arritshme nga të gjitha pjesët e tij, dhe për ta zvogëluar efektin e barrierave të hekurudhës, duhet të ndërtohet një urë ose një tunel në kombinim me qendrën.

Korridori për linjën hekurudhore të mallrave

Për ta zvogëluar trafikun hekurudhor përmes brendisë së qytetit dhe për ta përmirësuar lidhjen për zonat industriale, në pjesën lindore të qytetit, paralel me rrugën M2, është propozuar një linjë hekurudhore për mallra. Kjo hekurudhë nuk do të ndërtohet brenda një të ardhme të afërt. Për ta siguruar mundësinë e realizimit të projektit në të ardhmen, korridori përgjatë rrugës së planifikuar duhet të mbahet i lirë nga ndërtimet.

Unaza e brendshme e qytetit

Për një efikasitet më të madh të trafikut dhe lëvizshmërisë duhet të definohet dhe të sigurohet një profil më i gjerë i rrugës për realizimin e Unazës së brendshme. Kjo unazë do ta funksionalizonte edhe qendrën e mobilitetit.



INFRASTRUKTURA TEKNIKE

Sistemet e ndara për sistemin e ujërave të shiut dhe ujërave të zeza.

Në vitet e ardhshme do të rritet sasia e ujërave të zeza dhe sistemi për to duhet të riparohet. Çështja themelore e menaxhimit modern të ujërave është ndarja e mbledhjes së urave të shiut dhe ujërave të zeza. Ujërat e zeza duhet të mbledhen dhe të trajtohen në njërin nga impiantet e ujërave të zeza, të përcaktuar në Planin e Zhvillimit të Komunës. Ujërat e shiut duhet të trajtohen për afërsisht me ciklin e ujërave natyrore. Kjo përfshin ruajtjen dhe infiltrimin e ujërave të shiut brenda zonave banuese dhe komerciale. Ruajtja dhe infiltrimi i ujërave të shiut e redukton sasinë totale të ujërave të shiut dhe ndihmon në reduktimin e investimeve të nevojshme.





PLANI 20: PROJEKTET KYÇE – QYTETI



4.2 VLERËSIMET E STRATEGJIVE, BAZUAR NË KRITERET E PËRCAKTUARA ME PARIME, POLITIKA DHE LIGJE

Monitorimi dhe rishikimi

Gjilani, si edhe shumë komuna të tjera në Kosovë, e ka përvojën e zhvillimit dinamik socio-ekonomik. Si rrjedhojë, nevojat për tokë ndërtimore dhe furnizim të infrastrukturës mund të ndryshojnë në mënyrë të papritur. Për këtë arsye, është e nevojshme që të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme zhvillimi i komunës, nëse është e nevojshme, edhe të rishikohet përmbajtja e PZHU-së.

4.3 AFATET KOHORE, IMPLIKIMET FINANCIARE, KORNIZA INSTITUCIONALE

Hapat e përshtatshëm të zhvillimit

Projektet e treguara kyçe janë projekte me prioritet. Ato duhet të zbatohen sa më shpejtë që të jetë e mundur, sipas kapaciteteve financiare të komunës. Për shkak të ndryshimeve politike dhe ekonomike të pritura në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme, kapacitet e investimeve të komunës mbeten të pasigurta. Duke qenë në dijeni për këtë fakt, është e nevojshëm që të adoptohet një qasje hap pas hapi, e cila e bën përdorimin në maksimum të fondeve që janë në dispozicion për vitin vijues buxhetor.

Pasi që kapacitet e investimeve në Komunën e Ferizajt aktualisht janë të limituara, faza e parë e zhvillimit i përfshin projektet që mund të zbatohen pa investime të mëdha. Investimet e mëdha janë të nevojshme në fazat e mëvonshme, që i mundësojnë komunës për të grumbulluar fonde të nevojshme për realizimin e tyre.

Duke marrë parasysh burimet e pakta financiare, administrata e komunës duhet të kërkojë fonde shtesë nga programet kombëtare ose ndërkombëtare. Në këtë mënyrë komuna mund ta përshpejtojë procesin e arritjes së qëllimeve të saj të zhvillimit në kohë sa më të shkurtër.

Bashkëpunimi – instrument kyç për implementim

Në implementimin e PZHU-së, i cili është i gatshëm, është e rekomandueshme që, gjithashtu, të merren përfitime nga partneritetet publike-private. Kompanitë private mund të luajnë rol të rëndësishëm në modelet e financimit dhe të ofrojnë njohuri të specializuar.

Si shtesë është rekomanduar që të vlerësohen partneritetet strategjike me komunat fqinje ose me autoritetet e tjera publike (partneritet publik-publik), veçanërisht për ngritjen e shërbimeve publike dhe të pajisjeve të infrastrukturës.



Përfundimisht, komuna duhet t'i fillojë përpjekjet për t'i futur qytetarët e saj në proceset e planifikimeve. Veprimi i tillë do të përfshihej në studimin e realizueshmërisë së Planeve Rregulluese Urbane.

Tab. 15: Plani i veprimit për prioritetin – Hartimi i planeve përkatëse

Aktiviteti	Afati kohor	Implikimet financiare	Pjesëmarrësit	Vërejtje
Rizhvillimi i hapësirës me shfrytëzim ushtarak	1 vit	30.000 €	Drejtoria e Urbanizmit Kompani private	Zhvendosje
Plani rregullues për qendrën e qytetit	3 muaj	20.000 €	Drejtoria e Urbanizmit Kompani private	Rizhvillim
Plani rregullues për hapësirën me shfrytëzim industrial/komercial M2	6 muaj	50.000 €	Drejtoria e Urbanizmit Kompani private	
Planet rregulluese për vendbanimet joformale	1 vit	40.000 €	Drejtoria e Urbanizmit Kompani private	
Plani i Qendrës Spitalore	4 muaj	20.000 €	Drejtoria e Urbanizmit Kompani private	



Tab. 16: Plani i veprimit për prioritetin – Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore (Peizazhi dhe mjedisi)

Aktiviteti	Afati kohor	Implikimet financiare	Pjesëmarrësit	Vërejtje
Parku i qytetit dhe pylli i qytetit	1 vit	20.000 €	Drejtoria e Urbanizmit Kompani private	
Rigjallërimi i sistemit të lumit	2 vite	40.000 €	Drejtoria e Urbanizmit Kompani private	

Tab. 17: Plani i veprimit për prioritetin – Infrastruktura teknike

Aktiviteti	Afati kohor	Implikimet financiare	Pjesëmarrësit	Vërejtje
Sistemet e ndara për të reshurat atmosferike dhe kanalizim	2 vite	30.000 €	Kompani të specializuara private	

Tab. 18: Plani i veprimit për prioritetin – Trafiku dhe transporti

Aktiviteti	Afati kohor	Implikimet financiare	Pjesëmarrësit	Vërejtje
Rregullimi i rrugës përreth në pjesën veriperëndimore	1 vit	30.000 €	Kuvendi Komunal	Rizhvillim
Korridor / ndërtimi i rrugës përreth në pjesën lindore	1 vit	30.000 €	Ministria përkatëse	
Korridor / ndërtimi i rrugës përreth në pjesën jugperëndimore	1 vit	30.000 €	Ministria përkatëse	
Sistemi i trafikut në qendër të qytetit	2 muaj	10.000 €	Kuvendi Komunal	
Qendra e mobilitetit	1 vit	€	Kompani e specifikuar në zhvillim	
Unaza e brendshme	1 vit	40.000 €	Kompani e specifikuar në zhvillim	



5 DISPOZITAT PER ZBATIM

5.1 UDHËZIME MBI ÇËSHTJET E INTERPRETIMIT TË PLANIT TË ZHVILLIMIT URBAN GJATË HARTIMIT TË PLANEVE RREGULLUESE DHE PLANEVE TË TJERA

Komuna mund të fillojë me zbatimin e PZHU-së menjëherë pas aprovimit të tij. Një numër i elementeve të përfshira me plan duhet të sqarohen me plane rregulluese. PZHU nuk i ka definuar në tërësi përkufizimet, rregullat e ndërtimit, parametrat urbanë. Mu për këtë një numër i madh i aspekteve të ndryshme duhet të specifikohen më hollësisht me plane rregulluese. Për çdo zonë urbane duhet të hartohen plane rregulluese. Të gjitha hulumtimet e nevojshme, si: studimet mjedisore, studimet në zona të veçanta arkeologjike, si dhe studimet rreth rregullimit të trafikut janë të nevojshme dhe duhet zbatuar.

Përveç rolit udhëzues për zhvillimin e zonës urbane, PZHU definojnë kushtet e zhvillimit të pjesëve të qytetit – planeve rregulluese për lagjet dhe blloqet urbane. Planet rregulluese nuk duhet të jenë në konflikt me dispozitat e Planit të Zhvillimit të Komunës.

Dispozitat:

- PZHU duhet të jetë i bazuar në Planin Hapësinor të Kosovës dhe vendimet për zhvillimet me rëndësi në nivel të Kosovës duhet të respektohen në tërësi.
- PZHU duhet të jetë i bazuar në PZHK dhe vendimet për zhvillimet me rëndësi në nivelin komunal duhet të respektohen në tërësi.
- PZHU do të jetë plan bazë për çfarëdo plani rregullues që do të hartohet për zonat urbane. Planet rregulluese nuk duhet të cenojnë dispozitat e PZHU-së.
- Nëse ndonjë pjesë e planeve rregulluese urbane nuk është në harmoni me PZHU-në, duhet bërë rishikimi adekuat dhe miratimi në Asambleenë Komunale.



5.2 KUSHTE TE PËRCAKTUARA NGA QEVERIA LOKALE MBI ÇËSHTJE TE RËNDËSISHME PER ZHVILLIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E TOKËS NE ZONA URBANE

5.2.1 Kushtet për përcaktimin dhe përkufizimin e sipërfaqeve publike dhe të atyre me destinime të tjera

Hapësirë publike do të duhej të definohej bregu përgjatë lumit, i cili do të duhej të zbulohet.

Në çdo vendbanim ekzistues, me theks në vendbanime joformale, nevoja dhe mundësia e vendosjes së objekteve publike, sikurse janë fushëlojat, zonat e gjelbëruara, tregjet, hapësirat sportive dhe hapësira për parkim, do të mbështeten me plane rregulluese. Në këto vendbanime, ku hartimi i PRrU është prioritet, ky vlerësim do të jetë pjesë e procesit të hartimit të këtyre planeve.

Në zonat e reja të planifikuara për zhvillimin e banimit, kushti kryesor për planifikim do të jetë rezervimi i hapësirës publike.

5.2.2 Kushtet për rregullimin e hapësirës për objekte me rëndësi për komunën

Ndërtimi do të jetë i lejuar vetëm në zonat e destinuar për ndërtim, të përcaktuara me PZHU.

- Zhvillimi në Ferizaj të rregullohet me Plane Rregulluese Urbane
- Infrastruktura publike do të ofrohet vetëm në zonat e destinuar për ndërtim. Në zonat për të cilat nuk janë miratuar Planet Rregulluese Urbane, duhet zbatuar hulumtimin për kërkesat, mundësitë dhe ofrimin e infrastrukturës.
- Zhvillimet në hapësirën e lirë duhet bazuar në rregullat mjedisore për mbrojtjen e natyrës. Në mungesë të planit rregullues urban, komuna duhet të nxjerrë udhëzimet përkatëse të karakterit obligues.
- Në zonat ku zhvillimi është i lejuar, kushtet dhe lokacionin duhet ta përcaktojnë me sa vijon:
 - a. Forma dhe madhësia e zonës së zhvillimit;
 - b. Mënyra e shfrytëzimit apo përdorimi i autorizuar për ngastrën tokësore;
 - c. Rregullat e ndërtimit dhe distanca në mes të ndërtesave në ngastër;
 - d. Rregullat për kyçje të ndërtesës në rrjetin e infrastrukturës;
 - e. Masat për mbrojtjen mjedisore dhe mbrojtjen e tërësive të trashëgimisë natyrore dhe kulturore.



- f. Përgatitja e lokacionit, si: largimi i ndërtesave dhe rehabilitimi i dheut (tokës), hulumtimet gjeomekanike të dheut.

5.2.3 Kushtet për vendosjen e objekteve të veprimtarive ekonomike

Komuna do të alokojë tokë të mjaftueshme që të përkrahë zhvillimin e biznesit, i cili është i bazuar në shfrytëzimin e fuqisë punëtore vendore.

Komuna do të përkrahë themelimin e Këshillit Komunal për Zhvillim për ofrimin e hapësirës për zhvillim ekonomik, për lokacion të biznesit dhe për menaxhim.

Këshilli Komunal për Zhvillim

Një parakusht tjetër për zbatimin e suksesshëm të këtij plani është formimi i Këshillit Komunal, i cili do të udhëheqë një numër të projekteve zhvillimore. Zbatimin mund ta bëjnë përmes dhënies së tokës në shfrytëzim, me ndërtimin e rrugëve dhe të infrastrukturës tjetër dhe me krijimin e kushteve më të mira për shitjen e parcelave individëve privatë dhe biznesit.

Ky këshill, gjithashtu, do ta bënte ndërlidhjen planeve dhe programeve zhvillimore evropiane dhe të qeverisë qendrore, me qëllim të thithjes së investimeve dhe donacioneve të ndryshme të dedikuara për zhvillim në nivele të ndryshme organizative.

Gjithashtu, Këshilli do ta organizonte informimin dhe këshillimin e investuesve privatë gjatë promovimit të partneritetit privat/shoqëror.

Aktivitetet ekonomike-tregtare dhe ato të industrisë së lehtë joshqetësuese deri në 1500m² do të lejohen edhe në zonat banuese-mikse në pjesën urbane.

Zonat komerciale/industriale

Zonat komerciale dhe industriale sigurojnë hapësirë për të gjitha llojet e çështjeve komerciale, kryesisht për përdorimet që nuk janë të lejuara në zonat e tjera, si:

1. Të gjitha llojet e ndërmarrjeve komerciale dhe industriale, ndërtesat e dyqaneve, depot dhe ndërmarrjet publike,
2. Biznes, zyra dhe administratë,
3. Pompat e karburantit,
4. Pajisjet sportive.



Përdorimet në vijim janë paraparë vetëm në raste të veçanta:

1. Objekte për fenë, kulturën, pajisjet sociale dhe të kujdesit shëndetësor,
2. Banimin për stafin mbikëqyrës, menaxherët ose pronarët e prodhimeve
3. Objektet e ndërmarrjeve.

5.2.4 Kushtet për vendosjen e objekteve të veprimtarive publike

Për vendosjen e objekteve për veprimtari publike duhet të bëhen:

- Themelimi i shërbimeve të reja dhe përmirësimi i shërbimeve ekzistuese publike për qytetin e Ferizajt do të jenë të përqendruara në zonën urbane.
- Plani i Zhvillimi Urban duhet të sigurojë tokë rezervë për kërkesa të veçanta (banimi për të moshuarit, institucionet për persona me aftësi të kufizuara, jetimore etj.), dhe për zgjerimin e zonave të aktivitetit publik në përputhje me funksionin e vendbanimit.
- Komuna duhet të sigurojë hapësirë për shkolla të reja dhe për institucione parashkollore. Ato duhet rregulluar me breza mbrojtës dhe të jenë të arritshme nga transporti publik.
- Komuna mund të sigurojë një ngastër të përbashkët për ndërtimin e një objekti me destinim për: edukim, kulturë, shëndetësi dhe për shërbimet sociale, për qendra të komunitetit.
- Zonat e destinuar për sporte dhe rekreacion duhet të jenë të furnizuara me shtigje, me infrastrukturë dhe gjelbërim. Në kuadër të këtyre zonave do të lejohet vetëm ndërtimi i objekteve të hapura dhe të mbyllura sportive, hapësira për parkim, restorante të vogla dhe dyqane që shërbejnë për pajisje sportive rekreative.

5.2.5 Kushtet dhe mënyra e ndërtimit të objekteve të banimit

Dendësimi në vendbanimet ekzistuese, pas përcaktimit të hapësirës për fushëloja, për hapësira publike dhe parkuese, duhet të stimulohet. Në këto zona, ku hartimi i PRrU është prioritet, një vlerësim i mundësive për dendësim do të përfshihet në procesin e hartimit të këtyre planeve.

Shumica e zonave të banimit sigurojnë kryesisht hapësirë për banim. Në këto zona janë paraparë përdorimet si në vijim:

1. Ndërtesat për banim,



2. Furnizimi i zonave të nevojshme për tregti me pakicë, për furnizimit me ushqime dhe për përdorimet komerciale joshqetësuese,
3. Objektet për fenë, kulturën, pajisjet sociale të kujdesit shëndetësor dhe të çështje sportive,

Shfrytëzimet apo përdorimet si në vijim janë paraparë vetëm në raste të veçanta:

1. Tregtia e akomodimit ,
2. Përdorimet e tjera joshqetësuese komerciale,
3. Ndërtesat për administratë,
4. Ndërmarrjet kopshtare,
5. Pompat e karburantit.

5.2.6 Kushtet për përcaktimin e rrjetit të sipërfaqeve të korridoreve apo traseve telekomunikuese dhe të rrjetit të infrastrukturës urbane

- Gjatë definimit të zonave të ndërtimit, duhet të dëshmohet se është shmangur kostoja e lartë për ndërtim dhe mirëmbajtje. Ndërtimi duhet t'i respektojë rregulloret për ndërtim të qëndrueshëm – orientimi, kushtet klimatike etj.
- Koncepti detal i mobilitetit, përfshirë edhe transportin publik, trafikun për këmbësorë dhe trafikun për çiklistë, duhet të elaborohet më tutje me plane detale dhe me plane rregulluese.
- Problemet teknike lidhur me sigurinë e rrugëve duhet të shmangen dhe të lehtësohen me masa të përshtatshme.
- Qasjet direkte në rrugët kryesore nuk do të lejohen.
- Të gjitha rrugët duhet të dimensionohen në mënyrë që të lejojnë rrjedhë të sigurt të komunikacionit për të gjitha automjetet, në çfarëdo kushtesh atmosferike. Duhet bërë përpjekje që të gjitha korridoret e rrugëve të ruhen me gjerësi minimale 11 m (profilin 3-3). Shtigjet e këmbësorëve duhet të respektojnë rregulloret ekzistuese. Shtigjet duhet të jenë të gjera më së paku 2.0 m'. Aty ku ka barriera fizike, shtigjet mund të ngushtohen.
- Të gjitha udhëkryqet duhet të sigurojnë pamje në të gjitha drejtimet.
- Shtigjet për çiklistë të një drejtimi duhet të jenë 0,9m' të gjëra.
- Në zonat për parkim që shërbejnë për transportin publik, shtegu i ndaljeve të autobusëve duhet të jetë 2.0m' i gjerë.
- Standardet për parkim do të përcaktohen me rregullore të dala nga planet e veçanta rregulluese.



5.2.7 Kushtet për rregullimin e zonave dhe të tërësive me vlerë të veçantë

Me plane hapësinore për zona të veçanta do të rregullohen masat për mbrojtjen e peizazheve, vlerave natyrore dhe tërësive kulturo-historike.

- Duhet bërë përzgjedhjen e elementeve të trashëgimisë kulturore, të cilat duhet mbrojtur dhe për to duhet miratuar rregullore përkatëse.
- Nuk do të lejohet asnjë ndërtim në zonat të cilat në PZHU janë të përcaktuara si zona të gjelbërimit.
- Nuk do të lejohet prerja e drunjve përderisa nuk do të mbillen fidanët e rinj si zëvendësim për ta. Në zona të caktuara, ku ekziston rreziku nga erozioni, do të ndalohej prerja e drunjve.

5.2.8 Mënyra e trajtimit të hedhurinave (përpunimi, deponimi dhe bartja)

Po të ndalohej ndotja e mjedisit nga hedhja e mbeturinave në vende ilegale (vendosja ilegale dhe e paautorizuar e mbeturinave), nëse grumbullimi i mbeturinave bëhet përmes një organizimi të mirë të tyre, mjedisi do të ruhet dhe një proces i tillë i grumbullimit të mbeturinave do të zgjerohet në të gjitha pjesët e komunës. Kjo do të ndikojë, gjithashtu, në ngritjen e vetëdijesimit të popullsisë në lidhje me rrezikun për jetesë nga hedhja e mbeturinave dhe do ta inkurajojë kontrollin shoqëror.

Momentalisht, mbeturinat janë grumbulluar në pjesën më të madhe të Kosovës Jugore dhe janë transportuar në deponinë rajonale në Gjilan, ku ato ruhen pa asnjë trajtim të mëtutjeshëm. Në të ardhmen, kur të rregullohet menaxhimi i mbeturinave sipas rregulloreve të BE-së, mbeturinat do të digjen dhe vetëm hiri do të depozitohet. Në tërë Kosovën do të jenë të nevojshme vetëm disa deponi të tilla për djegien e mbeturinave, të cilat duhet të ndërtohen në kombinim me deponitë e sotme rajonale.

Prioriteti i parë për menaxhimin e mbeturinave ka si imperativ formimin e shërbimeve për grumbullimin e mbeturinave, të cilat duhet të zgjerohen në tërë komunën dhe të pastrohen pjesët e depozitimit ilegal me mbeturina. Ndërsa, i prioriteti i dytë është që pajisjet dhe mënyrat e deponimeve ekzistuese të adoptohen me standardet e BE.

5.2.9 Masat për pengimin e ndikimeve të dëmshme në mjedis

Masat që duhet ndërmarrë për pengimin e ndotjes së mjedisit janë:

- Strategjitë për menaxhimin e mbeturinave duhet të kontrollohen gjithmonë nga komuna, në mënyrë që të shmangen ndikimet në mjedis.
- Projektet rregulluese në shkallë prej 5 hektarëve, duhet të dëshmojnë që nuk shkaktojnë ndikime negative në mjedis.



- Gjatë dhënies së lejeve për planifikim për objektet zhvillimore ekonomike, nëse është e nevojshme, në pajtim me rregullat mjedisore, të sigurohen masat parandaluese për ndikimet negative në mjedis, si ndotja e ajrit, zhurma, vibrimet - luhatjet, rrezatimi, ndotja e ujit dhe ndikimet nga mbeturinat e ngurta. Vlerësimi i ndikimeve në mjedis është i nevojshëm për objektet me përmbajtje industriale-prodhuese.

5.2.10 Masat për parandalimin e ndikimit negativ social

- Trajtimi i vendbanimeve joformale,
- Zgjidhja e problemeve të ndërtimeve pa leje,
- Sigurimi social dhe shëndetësor.

5.2.11 Masat për zbatimin e planit

5.2.12.a Detyrimi për hartimin e planeve detale rregulluese

Plani i Zhvillimit Urban duhet të revidohet çdo 5 vite, ndërsa rishikimi i tij duhet të bëhet çdo 2 vite.

Ndonëse hartimi i PRrU duhet të mbulojë tërë territorin urban, është e qartë se prioritet duhet t'i jepet për ato zona ku problemet hapësinore janë të asaj natyre që kërkojnë të reagohet me shpejtësi.

Posaçërisht për zonat si në vijim:

- Për zona të cilat konsiderohen vendbanime joformale, në të cilat janë bërë ndërtime me status të paqartë,
- Zonat të cilat me ndërtimet e veta nuk janë në pajtim me PGJU-në (i cili është ende në fuqi dhe vetëm pjesërisht i aplikueshëm), mirëpo të cilat nuk janë në konflikt me PZHU-në,
- Aty ku ridizajnimi dhe rikonstruimi i hapësirës publike kërkon zgjidhje të shpejtë.

5.2.12.b Masat për rregullimin dhe mbrojtjen e tokave

- Nuk duhet të rriten ndërtesat ekzistuese në zonat e gjelbra.
- Problemet specifike në lidhje me vendbanimet joformale do të vlerësohen dhe do të propozohen zgjidhje sipas direktivave IPH dhe DPH. Prandaj, duhet të krijohet një bazë e të dhënave me informata detale për çdo ndërtesë.
- Rrënimi i ndërtesave mund të konsiderohet i nevojshëm në ato raste ku ndërtimet ilegale nuk mund të legalizohen sipas Ligjit mbi Ndërtimet Ilegale.



- Komuna do të ofrojë një lokacion për ndërtimin e shtëpive të reja për njerëzit që duhen t'i lëshojnë shtëpitë e tyre në rast të rrënimave. Gjatë zbatimit të planit, nëse kërkohet, ndërtesat e ndërtuara legale mund të largohen pas shpronësimit apo marrëveshjes me pronarin. Në këtë rast komuna duhet të ofrojë kompensim të mirëfilltë.

5.3 DISPOZITAT LIDHUR ME KONSULTIMIN, BASHKËPUNIMIN DHE PJESËMARRJEN

Përmirësimi i pjesëmarrjes, përfshirjes dhe vetëdijesimit
Jetësimi dhe zbatimi i PZHU dhe PRrU-ve është i mundshëm vetëm atëherë kur komuna krijon përkrahje dhe besim të qytetarëve për këto aktivitete, besim i cili do të arrihet me kontakte të drejtpërdrejta dhe fushata mediale me qëllim të vetëdijesimit të qytetarëve.

Centralizimi i informatave hapësinore
Shënimet dhe informatat duhet të centralizohen në një sistem të GIS-it.

Lejet e ndërtimit
Lejet e ndërtimit duhet të qartësohen si procedura dhe të përmirësohen. Baza e të dhënave dhe sistemi i GIS-it duhet t'i asistojnë kësaj procedure.

Monitorimi dhe rishikimi

Ferizaj, si edhe shumë komuna të tjera në Kosovë, e ka përvojën e zhvillimit dinamik socio-ekonomik. Si rrjedhojë, nevojat për tokë ndërtimore dhe furnizim të infrastrukturës mund të ndryshojnë papritmas. Për këtë arsye, është e nevojshme të monitorohet vazhdimisht zhvillimi i komunës, nëse kërkohet, të rishikohet përmbajtja e PZHU-së së paku njëherë në 2 vite. Rishikimi i tërësishëm i planit bëhet pas pesë vitesh.

5.4 DISPOZITAT MBI RENDIN KRONOLOGJIK APO ETAPAT E ZBATIMIT

Buxheti i shpenzimeve komunale bazuar në PZHU
Planifikimi i investimeve komunale, posaçërisht i atyre me komponentë hapësinore (përfshirë aktivitetet e planifikimit, punët publike, shpërndarjen e shërbimeve publike, banimin dhe ndërtimin tjetër), do të realizohet në përputhje me veprimet e theksuara në të dy planet PZHK dhe PZHU. Tre muaj pas miratimit të të dy planeve (PZHK dhe PZHU), Asambleja Komunale do të miratojë planin buxhetor me të cilin do ceket qartë se si do të financohet zbatimi i të dy planeve për se paku tri vitet e para. Ky plan shtesë i buxhetit do të definojë, mes tjerash, si do të hartohen PRrU-të, si do



të zbatohen hulumtimet e domosdoshme dhe si do të financohet hartimi i dokumenteve politike zhvillimore, të përcaktuara me planet zhvillimore.

Sigurimi i përputhshmërisë me dokumentet ekzistuese politike

Tre muaj pas miratimit të të dy planeve (PZHK dhe PZHU), komuna duhet të rishikojë politikat sektoriale, në mënyrë që ato të jenë në harmoni me dispozitat e PZHK dhe PZHU.

5.5 ELEMENTET DHE UDHËZIMET PËR HULUMTIM TË MËTUTJESHËM

Planet dhe politikat që duhet hartuar:

1. Plani i politikave mjedisore, në veçanti, mbrojtja e ujërave, e pyjeve dhe e tokës bujqësore,
2. Plani i infrastrukturës teknike,
3. Mobiliteti,
4. Hulumtimi i energjisë për ngrohje,
5. Studimi i fizibilitetit të kalimit nën tokë i hekurudhës nëpër qytet,
6. Zonat arkeologjike,
7. Studimi i mundësisë për furnizim të qëndrueshëm me ujë të pijes.



Referencat:

Raportet sektoriale

- Drejtoria e Administratës
- Drejtoria e Urbanizmit, Pronës, Kadastrit, Gjeodezisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit
- Drejtoria e Arsimit
- Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Buxhetit
- Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit
- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
- Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
- Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
- Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës
- Drejtoria e Inspeksionit

Këshilli i Ekspertëve, i formuar nga Komuna e Ferizajt

Raportet e Grupeve punuese

- Demografia dhe Çështjet Sociale
- Zhvillimi Ekonomik
- Mjedi dhe Shfrytëzimi i Tokës
- Infrastruktura

European Commission and International Management Group (EU/IMG):

Damage Assessment Kosovo. Assessment of Damaged Housing and Local / village Infrastructure in Kosovo. July 1999

European Commission Damage Assessment Kosovo / International Management Group (EU/IMG):

Building Assessment. Municipality: Ferizaj / Prishtine. IMG Kosovo, April 2000

Federal Republic of Yugoslavia (FRY) / Federal Statistical Office (FSO) /

Savezna Republika Jugoslavija / Savezni Zavod za Statistiku:
Popis '91 Stanownischtwo. Belgrad 1993

Government of Kosovo:

The Kosovo General Government 2003 Budget. Prishtina 2003

Government of Kosovo:

The new Kosovo Government. 2002 Budget. Prishtina 2002

International Monetary Fund:

Kosovo. Institutions and Policies for Reconstruction and Growth. Prepared by Dimitri G. Demekas, Johannes Herderschee, Davina F. Jacobs, 2002

International Organisation for Migration / IOM:

Kosovo. Demographic, socio-economic and reproductive health survey. Basic Results. May 2000

Ministry of Environment and Spatial Planning / Department of Spatial Planning:

Report on present situation in urban management and planning in municipalities of Kosovo. Prepared by: Municipalities, Road Directorate, Kosovo Cadastral Agency, Urban Institutions, Kosovo Statistical Office and Institute for the Protection of Monuments, 2002



- Ministry of Environment and Spatial Planning (MESP) / Ministria e Mjedisit dhe Planifikim Hapësitor (MMPH):
Kosovo State of the Environment / Raport Mbi gjendjen ambientale në Kosovë
April / Prill 2003
- Ministry of Environment and Spatial Planning / Department of Housing and Construction
/ Reconstruction Section:
Kosovo Profile. Kosovo Spatial Development. Working document. Prishtina June
2004
- Ministry of Environment and Spatial Planning / Institute for Spatial Planning:
Report on present situation in urban management and planning in municipalities
of Kosovo. Prepared by: Municipalities, Road Directorate, Kosovo Cadastral
Agency, Urban Institutions, Kosovo Statistical Office and Institute for the
Protection of Monuments, 2002
- Ministry of Health, Provisional Self-Government of Kosovo:
Demographic Transition and Health Insurance in Kosovo. Report prepared by
Manoj Mohanan, Harvard School of Public Health Boston MA; Prishtina 2003
- National Board of Housing, Building and Planning, Sweden; Ministry for Regional
Development of the Czech Republic, editors:
Housing Statistics in the European Union 2004
- Organization for Security and Co-Operation in Europe (osce) and UNHCR:
Assessment of the Situation of Ethnic Minorities in Kosovo (October 2000 to
February 2001) OSCE Mission Factsheet March 2001
- Organization for Security and Co-Operation in Europe (osce) and UNHCR:
Ninth Assessment of the Situation of Ethnic Minorities in Kosovo (Period covering
September 2001 to April 2002) 27 May 2002,
http://www.osce.org/documents/mik/2002/05/1110_en.pdf Prishtina 2002
- Organization for Security and Co-Operation in Europe (osce):
Municipal Profile Ferizaj / Đakovica. February 2005
- RIINVEST:
Post-War Reconstruction of Kosova. Strategy and Policies. Prishtina, March 2000
- RIINVEST:
Labour Market and Unemployment in Kosova. Prishtina, January 2003
- Simpson, David; and Bajram Maxhuni:
Kosovo Health Profile. Supported by DFID, UNICEF and Open Society Institute,
June 2003
- Statistical Office of Kosovo (SOK):
Kosovo and its Population. A brief description. 5th Version, June.2003
- Statistical Office of Kosovo (SOK):
Kosovo Demographic and Health Survey 2003. Preliminary results. Draft chapters,
http://www.sok-kosovo.org/publications/dhs_2003.htm; April 2004.
- Statistical Office of Kosovo (SOK):
Kosovo Labour Force Survey 2001. Methodological report. August 2002



Statistical Office of Kosovo (SOK):

Labour Market Statistics 2004. Series 5: Social Statistics. Prishtina 2005

Statistical Office of Kosovo (SOK):

Vital statistics of Kosovo 2002 - 2003. Bulletin Number 3. Prishtina 2004 /
Statistikat Vitale të Kosovës për Vitin 2004. Buletini Numër 4. Prishtinë 2004

Statistical Office of Kosovo (SOK); United Nations Population Fund (UNFPA) and
International Organization for Migrations (IOM):

Demographic, social, economic situation and reproductive health in Kosovo
following the 1999 conflict. Results of a household survey November 1999 –
February 2000. Report prepared by Chantal Blayo, Christophe Bergouignan,
Marine Llopart, Nicodème Okobo and Nancy Stiegler, Institute of Demographic
Studies of the University Montesquieu – Bordeaux IV (IEDUB), France, January 2001

United Nations Development Programme (UNDP):

The Kosovo Mosaic: Perceptions of local government and public services in
Kosovo; results of the "Local Authorities and Public Services Survey"; study
performed by Index Kosova and BBSS Gallup International; Prishtina 2003;

United Nations Interim Administration Mission in Kosovo (UNMIK): Energy sector. Technical
assistance project (ESTAP) Kosovo. World Bank Grant No. TF-027791 Module A
Electricity Demand (Draft Report: V3b). Supported by: CESI, EIW, Ramboll, RE; pp.
22 ff. Demographic Analysis; Prishtina, April 2002

United Nations Interim Administration Mission in Kosovo (UNMIK):

Energy Sector. Technical assistance project / ESTAP World Bank Grant No. TF-
027791. Supported by CESI, EIW, Ramboll, RE; Executive Summary. Final Report;
pp. 14 ff.: Demographic Development; [http://www.ks-
gov.net/mem/pdf/estap1/Executive_Summary.pdf](http://www.ks-
gov.net/mem/pdf/estap1/Executive_Summary.pdf); Prishtina, September 2002

United Nations Interim Administration Mission in Kosovo (UNMIK):

Fact Sheet Kosovo, 2002

United Nations, Development Programme (UNDP):

Human Development Report Kosovo 2004. The Rise of the Citizen: Challenges
and Choices. Core team of writers: Mytaher Haskuka, Leon Malazogu, Nita Luci,
Ilir Dugolli; Prishtina 2004

World Bank:

Kosovo, Poverty Assessment. (In two volumes) Volume I: Main report; Volume 2;
Based on Living Standard Measurement Survey / LSMS 2001; December 20, 2001

World Bank:

Kosovo, Labor Market Study: Policy Challenges of Formal and Informal
Employment. Human Development Unit Europe and Central Asia Region. June
2003

Ministry of Environment and Spatial Planning:

The Vision, Goals and Principles of Spatial Development in Kosovo 2005 – 2015;
Prishtina May 2005

Doli, Flamur:

Arkitektura tradicionale popullore e Kosovës. Traditional Popular Architecture of
Kosova. Prishtina 2001



Drançolli, Fejaz:

Kulla Shqiptare. Prishtinë 2001

Drançolli, Fejaz:

Rrenimi I kullës shqiptare / Destruction of Albanian Kulla. Prishtinë 2004

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës / Kosova Institute for Cultural Monuments Protection:

Monumentet e Kosovës / Kosova Monuments. Prishtinë 2004

United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization:

Cultural Heritage in South-East Europe: Kosovo. Venice 2003

<http://portal.unesco.org/en/ev.php>

Omçikus, Marko / Institute of the Protection of Monuments of the Republic of Serbia:

Cultural heritage of Kosova and Metohija. Belgrade 2001